



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 33

Tiranë – E martë, 10 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 14.1.2015	Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore..... 1469
Udhëzim i ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme nr. 10, datë 25.2.2015	Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës..... 1473
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 26.2.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2013-725, datë 30.05.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 1529
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 255, datë 30.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 32, datë 22.01.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2012-1258 (155), datë 30.05.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna në bazë të procedimit penal nr. 457/1997..... 1536
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 26.2.2015	Me objekti shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”..... 1547
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Koti..... 1559
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ismet Kacabumi..... 1559

**VENDIM****Nr. 24, datë 14.1.2015****PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
DHE MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT E
ORGANIZIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË BARNAVE DHE
PAJISJEVE MJEKËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 105/2014, datë 31.7.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, dhe të ligjit nr. 89/2014, datë 17.7.2014, “Për pajisjet mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave bëhet Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (këtu më poshtë e quajtur Agjencia), sipas strukturës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia është një institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, e specializuar për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmako – vigjilencën dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore.

3. Agjencia ka këto përgjegjësi:

a) Zbaton të gjitha detyrimet ligjore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për vendosjen në treg, eksportin, tregtimin dhe përdorimin e barnave, të barnave homeopatike, si dhe të pajisjeve mjekësore;

b) Ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e detyrimeve që lidhen me farmako – vigjilencën;

c) Miraton, sipas rregullave të parashikuara në ligj, formatin e publicitetit për barnat;

ç) Bashkëpunon me institucione analoge jashtë vendit për çështje të ndryshme të fushës farmaceutike dhe të pajisjeve mjekësore;

d) Lidh, me autorizimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë, marrëveshje reciprociteti me institucione homologe të vendeve të tjera;

dh) Propozon, pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore, me qëllim plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës;

e) Harton projektbuxhetin dhe e paraqet atë pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë për miratim;

ë) Kryen procesin e regjistrimit dhe të inspektimit, bazuar në standardet e parashikuara për pajisjet mjekësore;

f) Zhvillon procesin e inspektimit në përputhje me aktet ligjore dhe ato nënligjore.

4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen nga dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Mënyra dhe procedurat e punësimit, lëvizjet dhe transferimi i stafit të Agjencisë miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

6. Agjencia drejtohet nga drejtori i Agjencisë, i cili emërohet dhe lirohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas kritereve dhe procedurave përkatëse.

7. Drejtori i Agjencisë ka këto përgjegjësi kryesore:

a) Drejton dhe bashkërendon detyrat e punonjësve, me qëllim përmbushjen me sukses të rolit të Agjencisë;

b) Administron fondet buxhetore dhe fondet e tjera, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi, për funksionimin normal të Agjencisë;

c) Miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Agjencisë;

ç) Bashkëpunon ngushtë me institucione të ndryshme dhe organizata që veprojnë në fushën farmaceutike dhe të pajisjeve mjekësore, brenda dhe jashtë vendit;

d) Përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tjerët;

dh) Propozon për miratimin, nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, përshkrimet e punës për të gjithë punonjësit e Agjencisë.


8. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



STRUKTURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE





skema 2

ORGANIKA E AGJENCISË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE

Pozicioni	Numri
I DREJTORIA	
DREJTOR	1
ZËVENDËSDREJTOR EKONOMIK (Ekonomist)	1
ZËVENDËSDREJTOR TEKNIK (Farmacist/Mjek)	1
II SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE	
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (Jurist)	1
SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN	1
ARKIVIST	1
PROTOKOLLIST	1
NËPUNËS INFORMACIONI	1
III SEKTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE	
SHEF SEKTORI	1
SPECIALIST (Jurist)	2
IV SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	
SHEF SEKTORI	1
EKONOMIST I LARTË	3
MAGAZINIER	1
SHOFER	3
SANITARE	3
PUNONJËS MIRËMBAJTJE	1
V SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT	
SHEF SEKTORI	1
IT/FARMACIST/MJEK	5



VI. LABORATORI I KONTROLLIT	
SHEF SEKTORI	1
ANALIST	14
LABORANT	4
VII. SEKTORI SHPËRNDARJES SË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE	
SHEF SEKTORI	1
INSPEKTOR	4
SPECIALIST	3
VIII. SEKTORI I INSPEKTIMIT	
SHEF SEKTORI	1
INSPEKTOR	20
IX. SEKTORI I AUTORIZIMIT PËR TREGTIM DHE I ÇËSHTJEVE RREGULLATORE	
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST	9
MJEK	2
X SEKTORI I PAJISJEVE MJEKËSORE	
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK/INXHINIER	4
XI SEKTORI I FARMAKOVIGJILENCËS	
SHEF SEKTORI	1
FARMACIST/MJEK	4
NUMRI I PËRGJITHSHËM	100



UDHËZIM

Nr. 10, datë 25.2.2015

**PËR MËNYRAT, FORMAT E
BASHKËPUNIMIT DHE PROCEDURAT
E NDËRHYRJES NË NDIHMË TË
FËMIJËVE NË RREZIK PËR
INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT
KRYESORE PËRGJEGJËSE PËR
MBROJTJEN E FËMIJËS**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35, të ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, të pikës 2 të vendimit nr. 266, datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, si edhe vendimit nr. 265, datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Punëve të Brendshme

UDHËZOJNË:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i detyrave, përgjegjësi dhe procedurat standarde për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

2. Ky udhëzim përmban procedurat që duhet të ndiqen për të ndihmuar fëmijët të cilët kanë nevojë të mbrohen nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi. Udhëzimi u drejtohet njësisve për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe të gjithë institucioneve dhe organizatave publike apo private të cilat punojnë me fëmijët në rrezik, dhe që kanë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre.

Udhëzimi synon të njehsojë rregullat dhe procedurat në punën për mbrojtjen e fëmijëve, të cilat duhet të njihen, ndiqen dhe zbatohen nga të gjitha institucionet e interesuara.

3. Udhëzime shtesë, për trajtime të rasteve të veçanta si p.sh. lidhur me fëmijët në situatë

rruge, fëmijët e trafikuar etj., mund të ofrohen nga institucione të tjera përgjegjëse, për të plotësuar këtë udhëzim.

4. Kur një situatë nuk është e përkufizuar në udhëzim, ose rrethanat janë jashtë procedurave të përmendura, atëherë rasti duhet të trajtohet brenda frymës së udhëzimit. Kjo do të thotë që, për aq sa është e mundur, rasti duhet të menaxhohet në përputhje me udhëzimin dhe me këshillimin e ofruar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) dhe/ose Shërbimi Social Shtetëror.

5. Të gjitha institucionet dhe strukturat përgjegjëse kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Udhëzimi është në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe thekson faktin që familja është mjedisi më i mirë ku duhet të rriten fëmijët dhe familja ka përgjegjësinë për t'i rritur dhe mbrojtur ata. Në këtë udhëzim prindërit dhe fëmija vlerësohen si aktorët dhe partnerët më të rëndësishëm për të përmirësuar situatën. Megjithatë, atëherë kur vërtetohet se familja nuk e mbron fëmijën apo në rastin më të keq, është abuzuesi i fëmijës, strukturat shtetërore do të kenë përgjegjësinë për të ndërhyrë edhe në familje.

6. Parimet mbi të cilat është mbështetur udhëzimi:

- Interesi më i lartë i fëmijës – Të gjitha vendimet që do të merren duhet të kenë si konsideratë kryesore interesin më të lartë të fëmijës.

- Konfidencialiteti – I gjithë informacioni i ofruar do të përdoret vetëm për të përcaktuar nevojat e fëmijës dhe për ta mbrojtur atë nga dëmtimi. Duhet ndërmarrë masa për të mbrojtur privatësinë dhe identitetin e fëmijës; për më tepër të dhënat për çdo fëmijë duhet të mbahen e ruhen në një vend të sigurt.

- Respektimi dhe promovimi i të drejtës së fëmijës për mbrojtje, përkujdesje dhe për t'u dëgjuar – Çdo fëmijë do të trajtohet me respekt, dhe në përshtatje me zhvillimin e tij/saj individual, si dhe me nevojat dhe të drejtat për mbrojtje. Fëmija që është në gjendje të formojë pikëpamjet e tij/saj, ka të drejtë t'i shprehë ato lirisht për të gjitha çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me të. Fëmija dhe familja kanë të drejtë për pjesëmarrje në çdo hap të procesit të mbrojtjes.



- Mundësi ose trajtim i barabartë – Të gjithë fëmijët do të marrin të njëjtin nivel shërbimesh ose ndihmë dhe nuk do të diskriminohen si rezultat i statusit që ata kanë, etnisë, gjinisë, besimit fetar, moshës, vendndodhjes ose aftësisë.

- Partneriteti dhe bashkëpunimi – Mbrojtja e fëmijës dhe promovimi i mirëqenies së tyre është një përgjegjësi e përbashkët dhe duhet të përfshijë të gjitha strukturat dhe shërbimet, fëmijët dhe familjen e tyre gjatë procesit të vendimmarrjes.

- Sigurimi i pavarësisë, integrimi social dhe pjesëmarrjes në jetën komunitare – Planet për fëmijët duhet të promovojnë aftësinë e familjes për t'u kujdesur në mënyrën e duhur, për të zhvilluar pavarësinë e tij/saj dhe për të inkurajuar integrimin social dhe pjesëmarrjen në komunitet.

- Respektimin e përgjegjësive, të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.

7. Udhëzimi është i ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë përmban rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe aktorëve kryesorë lidhur me mbrojtjen e fëmijës dhe Pjesa e dytë e cila përmban udhëzime teknike të rëndësishme në lidhje me procedurat e ndërhyrjes në mbrojtje të fëmijëve në rrezik.

8. Institucionet dhe strukturat kryesore, sipas rolit dhe rëndësisë në bashkërendimin e punës për mbrojtjen e fëmijës janë:

a) njësitë e mbrojtjes së fëmijëve/punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve;

b) strukturat e Policisë së Shtetit;

c) drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

d) drejtoritë rajonale të Arsimit/ Zyrat Arsimore dhe Shkollat;

e) drejtoritë e shëndetit (specialistët e shëndetit, mjeku i familjes);

f) komiteti drejtues në qark;

g) njësitë e të Drejtave të Fëmijëve në Qark;

h) bashkitë/komunat;

i) ofruesit e shërbimeve për fëmijë, publikë dhe privatë;

j) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

II. PËRKUFIZIME

Abuzimi i fëmijës - “Abuzimi apo keqtrajtimi i fëmijëve përfshin të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin

seksual, lënien pas dore apo trajtimin neglizhues, shfrytëzimin e fëmijës për qëllime përfitimi apo çdo lloj tjetër që shkakton dëmim aktual apo të mundshëm të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi apo pushteti.” (OBSH, 1999)

Abuzimi fizik - Çdo tentativë ose çdo dëmim fizik apo plagosje e fëmijës, të cilat nuk janë aksidentale dhe që synojnë të shkaktojnë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto. Në abuzimin fizik përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja/shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

Abuzimi emocional (ndonjëherë i quajtur abuzim psikologjik) - Veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.

Abuzimi seksual - Çdo veprim ose aktivitet seksual për përfitim ose kënaqësi seksuale të abuzuesit – pavarësisht nëse fëmija pranon ose jo. Abuzim seksual mund të jetë “me kontakt” siç është përdhunimi ose “pa kontakt” si për shembull detyrimi ose inkurajimi i një fëmije për të parë apo për të qenë pjesë e komunikimeve apo materialeve me përmbajtje pornografike.

Bullizimi – është një formë sjelljeje agresive proaktive i një fëmije ose i një grupi fëmijësh kundrejt fëmijëve të tjerë, sjellje e cila përsëritet në mënyrë të vazhdueshme – zakonisht ndaj dikujt që shpesh shihet si më i dobëti ose që ka më pak fuqi/forcë.

Diskriminimi - është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Dhunë ndaj fëmijëve - është përdorimi i



qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër fëmijës a grupit të fëmijëve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim.

Fëmijë - është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç. Në rastin kur moshja e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ligji nr. 1034, datë 4.11.2010, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” derisa moshja e tij të jetë përcaktuar plotësisht.

Fëmijë në rrezik - është fëmija, të cilit i mohohen ose i cenohen të drejtat dhe mbrojtja e parashikuar në ligjin nr. 10347 datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe në legjisllacionin në fuqi.

Interesi më i lartë i fëmijës – një parim i cili përshkon si Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, 1989, ashtu edhe një sërë ligjesh të legjisllacionit të brendshëm, dhe kërkon që vendimet e marra, të cilat kanë të bëjnë me fëmijën, të jenë në përputhje me sigurimin që mirëqenia e fëmijës të jetë si konsideratë kryesore.

Mbrojtje e fëmijës - është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikatat e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjinitale dhe martesat e fëmijëve.

Konfidencialiteti – praktika e mbajtjes dhe jo e përhapjes, ose përdorimit të informacionit të marrë për çdo qëllim tjetër, përveç atij për të cilin është marrë. Dokumentet dhe informacioni personal duhet të trajtohen me kujdesin më të madh dhe nuk duhet të lejohen, që të lexohen apo shikohen nga punonjës të tjerë të cilët nuk janë të autorizuar ose nuk është e nevojshme të informohen.

Menaxhimi i rastit - Një metodë/sistem i standardizuar i përdorur për të siguruar se rastet e fëmijëve në rrezik trajtohen në mënyrë kompetente, në afatet kohore të përcaktuara dhe standardet e shërbimit janë përmbushur.

Neglizhimi - është një mungesë kronike dhe

serioze e kujdesit dhe vëmendjes, me ose pa qëllim, nga prindërit/kujdestarët ndaj nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim, që sjell dëmtim fizik dhe/apo emocional të fëmijës.

Ndëshkim trupor - është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto, nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, të afërmit ose çdo person tjetër ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Në ndëshkimin trupor përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja/shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

Përfitues - një person që mund të jetë fëmijë apo i rritur që ka të drejtë të marrë (përfitojë) diçka, p.sh. një shërbim apo ndihmë financiare.

Plan individual për mbrojtjen e fëmijës - një plan me veprime të përcaktuara në takimin e Grupit Teknik Multidisiplinar, lidhur me menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik.

Raste emergjente - fëmijë në situatë emergjente konsiderohet, fëmija i cili nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose plagoset rëndë, apo të jetë pre e keqtrajtimit të konsideruara veprë penale sipas Kodit Penal.

Rrezik i ulët - fëmija është disi i sigurt dhe ka aftësi për të mbrojtur vetveten. Fëmija nuk është plagosur, ose është plagosur shumë lehtë në pjesë të trupit të cilat nuk prekin pjesët jetësore, si p.sh. gjunjët, duart etj. Plagosja mund të ketë ndodhur një herë të vetme dhe nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm te fëmija. Fëmija mund të ndjekë si zakonisht shkollën, dhe mezi pret të shkojë në shtëpi në fund të ditës. Prindi/Kujdestari ka gatishmërinë dhe kapacitetin të përkujdeset për fëmijën dhe dëshiron të mësojë praktika pozitive prindërimi.

Rrezik i mesëm - fëmija është i vogël, ka aftësi të kufizuara vetëmbrojtëse (për shembull mund të ketë një vonesë në zhvillim) ose mund të ketë nevojë për përkujdesjen e një të rrituri. Fëmija është plagosur pak (në zona të rëndësishme të trupit), dhe prindi/kujdestari njihet për ndëshkime dhe disiplinë strikte. Fëmija mbetet vazhdimisht mbrapa në mësim dhe



mund të ketë vështirësi në sjellje. Prindi/Kujdestari kanë vështirësi për të kontrolluar sjelljen e tij (për shembull, për shkak të çrregullimeve emocionale), dhe mund të shfaqin pikëpamje dhe mendime të paqën-drueshme lidhur me dëshirën e tyre për të ndryshuar stilin e prindërimit. Abuzimi seksual pa kontakt mund të klasifikohet si rrezik i mesëm.

Rrezik i lartë - fëmija nuk është në gjendje të kujdeset për veten e tij, ose për arsye të ndryshme mund të ketë kapacitete të ulëta për t'u kujdesur për veten. Abuzuesi ka plagosur fëmijën në pjesë jetësore të trupit duke përfshirë kokën, qafën dhe organet riprodhuese. Sjellja e abuzuesit bën që fëmija të kërkojë rregullisht ndihmën mjekësore ose të kërkojë shtrimin në spital. Abuzuesi nuk ka dëshirë të ndryshojë stilin e tij/të saj edukativ që mund të ketë lidhje edhe me drogën, alkoolin ose sëmundje psikologjike dhe/ose nuk mund të garantojë që do të ketë ndryshim në sjelljen e tij/saj, pavarësisht premtimit për një ndryshim të tillë. Abuzuesi njihet si një person që dëmton fëmijën. Fëmija është i frikësuar nga prindi/kujdestari i tij dhe për këtë arsye mund të largohet nga shtëpia. Fëmija mund të ketë probleme serioze në sjellje, për shkak të arsyeve familjare, ose nuk mund të jetë në gjendje të ndjekë shkollën. Abuzuesi ka kontakt të rregullt me fëmijën dhe nuk ka persona të tjerë në familje të cilët mund të luajnë rolin e kujdestarit kryesor. Të gjitha abuzimet seksuale me kontakte fizike klasifikohen si raste me rrezik të lartë.

Rrezik i menjëhershëm - Fëmija nuk ka aftësinë që të kujdeset për veten në mënyrë të pavarur dhe nuk ka aftësi vetëmbrojtëse. Fëmija është tërësisht nën kujdestarinë e abuzuesit dhe nuk ka ndonjë kujdestar tjetër. Abuzuesi njihet si një dhunues ose abuzues seksual ose ka shprehur synimin për ta dëmtuar fëmijën më tej. Është e sigurt që kthimi në shtëpi do të bëjë që fëmija të plagoset përsëri. Fëmija nuk ka dëshirë të kthehet në shtëpi ose mund të jetojë jashtë shtëpisë ose pa mbikëqyrjen e të rriturve (siç është rasti i fëmijëve që jetojnë në rrugë). Në zbatim të vendimit nr. 265 datë 12.4.2012, të Këshillit të Ministrave rastet në rrezik të menjëhershëm konsiderohen “raste emergjente”.

Shërbime për mbrojtjen e fëmijëve - lloje të mbështetjes/ndihmës që i ofrohen fëmijës dhe

familjes së tij/të saj për të reaguar ose për të ulur abuzimin ndaj fëmijës.

Shfrytëzim fëmije - Kur njëra palë përfiton, ose financiarisht ose në çdo formë tjetër nga përdorimi i fëmijëve. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në shfrytëzimin seksual, prostitucionin, punë ose shërbime të detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.

Takimi i Mbrojtjes së Fëmijës/Takimi i Grupit Teknik Multidisiplinar. Një takim ku profesionistët e institucioneve lokale, qendrave publike dhe jopublike, OJF-ve, fëmija dhe anëtarët e familjes mbledhen për të menaxhuar dhe për t'i dhënë rrugëzgjidhje, situatës në të cilën ndodhet një fëmijë i caktuar, derisa ky fëmijë të mos jetë në rrezik.

Të drejtat e fëmijës – Të drejtat e njeriut janë standardet bazë për të cilat njerëzit kanë nevojë për të jetuar një jetë dinjitoze. Fëmijët janë subjekt të drejtash dhe i gëzojnë ato, dhe për shkak të nevojave të tyre unike kanë të drejtë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë. Personat përgjegjës kanë për detyrë të garantojnë realizimin e tyre. Këto të drejta përkufizohen shprehimisht në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës 1989, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në 1992, si edhe në ligjin 10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Trafikim i fëmijëve - është çdo veprim ose transaksion, me anë të të cilit fëmija rekrutohet, transportohet, transferohet, fshihet ose merret me anë të kërcënimit apo përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, nga një person a grup personash, me anë të shpërblimit ose me qëllim të përfitimit material apo çdo lloj fitimi tjetër, për qëllime të shfrytëzimit seksual, transferimin e organeve të një fëmije, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Përfaqësues ligjor - është kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

Prind - është personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.


Pjesëmarrje – e drejta e fëmijës e parashikuar në legjislacionin përkatës, ku fëmijët kanë të drejtë që dëshirat, ndjenjat dhe mendimet e tyre të dëgjohen dhe të marrin pjesë në vendime që kanë ndikim mbi jetën e tyre.

Vlerësim - Procesi nëpërmjet të cilit mbledhet informacioni mbi fëmijën, familjen e tij/saj dhe rrethanat e tyre si për shembull mbi arsimimin e tij/saj, shëndetin, kushtet e jetesës dhe mjedisin dhe mbi të cilin bëhen analiza për të parë nëse fëmija ka nevojë për mbrojtje, është në rrezik të çdo lloj forme dëmtimi ose nëse ka nevojë për ndihmë për të plotësuar nevojat e tij/të saj të zhvillimit.

III. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Mbrojtja e fëmijës sigurohet përmes një rrjeti elementësh dhe aktorësh të lidhur me njëri-tjetrin.

Rrjetet Mbrojtëse për qark Fëmijës



Familjet kanë përgjegjësinë ligjore të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t'i mbajnë ata të sigurt. Për më tepër mund të ketë mekanizma joformalë pranë familjeve dhe komuniteteve për të mbrojtur dhe mbajtur të sigurt fëmijët.

Në rastet kur familja nuk e përmbush dot këtë rol, atëherë ndërhyjnë shteti. Sipas ligjit nr. 10347 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e fëmijëve është e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) e cila duhet të krijohet në çdo bashki/komunë. Megjithatë ligji shprehet se të gjithë aktorët dhe

palët e interesuara kanë një detyrim ligjor për të mbrojtur fëmijët dhe në përgjithësi për të mbështetur punën e NJMF-së. Kjo do të thotë se të gjitha strukturat dhe institucionet publike dhe jo publike, duhet t'u përgjigjen situatave abuzuese qofshin ato ekzistuese ose të dyshuara. Në praktikë kjo do të thotë se të gjithë aktorët duhet:

1. Të referojnë rastet pranë NJMF-së kur ka shqetësime lidhur me një fëmijë.
2. Të mbështesin NJMF-në për të mbrojtur fëmijën përmes ofrimit të shërbimeve.
3. Të mbështesin mbrojtjen e NJMF-së duke marrë pjesë në takimet për shqyrtimin e rasteve dhe planifikimin e ndërhyrjeve.

Rekomandohet që secila strukturë ose institucion të identifikojë pika fokale/kontakti për mbrojtjen e fëmijës në mënyrë që komunikimi dhe koordinimi në situata të mbrojtjes së fëmijës të jetë sa më i thjeshtë.

Përgjegjësitë dhe rolet kryesore të institucioneve dhe strukturave kryesore lidhur me mbrojtjen e fëmijës janë përmbledhur këtu.

3.1 Njësiti e mbrojtjes së fëmijëve/punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Identifikimin e fëmijëve në rrezik nëpërmjet informacioneve të siguruar nga vetë NJMF, marrjes së referimeve nga institucionet e tjera, organizata, anëtarët e komunitetit, publiku, vetë fëmija/ët dhe media.

- Menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, SHSSH dhe aktorë të tjerë të nevojshëm, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

- Ndërmarrjen e vlerësimit fillestar për të gjitha rastet fëmijëve të referuar në Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës.

- Organizimin e vlerësimeve të thella e të plota për fëmijët e referuar.

- Koordinimin dhe lehtësimin e takimit të Grupit Teknik Multidisiplinar për të diskutuar për çdo fëmijë të konsideruar në rrezik.

- Zhvillimin dhe shqyrtimin e planeve individuale të fëmijëve në rrezik dhe monitorimin e zbatimit derisa rasti të mbyllet.

- Denoncimin në polici të rasteve të abuzimit të ndodhur apo supozuar, në mënyrë që të mbrohen fëmijët.

- Organizimin e punës së drejtpërdrejtë me



fëmijët dhe familjet (përfshirë këshillimin dhe mbështetjen).

- Të veprojë si menaxher rasti dhe të jetë përgjegjës për implementimin dhe monitorimin e Planit Individual të Mbrojtjes dhe të Përkujdesit; edhe në rastet kur fëmija është në një institucion rezidencial ose në çfarëdo lloj strehimi të përkohshëm.

- Mbajtjen e të dhënave të sakta dhe faktike për të gjithë rastet e menaxhuara dhe referuara të fëmijëve pranë Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve;

- Ofrimin e të dhënave për procese të tjera, përfshirë hartimin e raporteve mbi situatën e fëmijëve në zonën gjeografike të mbuluar; hartëzimin e situatës së fëmijëve, ofruesit e shërbimeve dhe nevojat e fëmijëve brenda zonës gjeografike ku ata punojnë; dhe promovimin aktiv të të drejtave të fëmijës përmes aktiviteteve dhe fushatave publike sensibilizuese.

- Paraqet periodikisht pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar si edhe informacione për situatën e mbrojtjes së fëmijëve në territorin e bashkisë/komunës.

3.2 Strukturat e Policisë së Shtetit

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimi në kohë tek NJMF.

- Marrja në mbrojtje e fëmijëve në rrezik të menjëhershëm (në situatë emergjente) dhe referimin e tyre pranë NJMF-së, Shërbimit Social Rajonal edhe kur këto raste identifikohen jashtë orarit zyrtar të punës.

- Plotësimi i kërkesëpadisë për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes kur fëmijët janë në rrezik të lartë ose të menjëhershëm në bashkëpunim me NJMF-në.

- Fillimin e hetimeve në rastet kur ka indicje ose të dhëna për vepra penale të kryera ndaj fëmijëve.

- Marrjen pjesë në takimet e Grupit Teknik Multidisiplinar dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.

- Mbështetjen e NJMF-së kur është e nevojshme, gjatë vizitave në familje, gjatë identifikimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve që janë në rrezik të lartë ose të menjëhershëm.

- Mbështetjen dhe bashkëpunimin me NJMF-në për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese me qëllim parandalimin e dhunës dhe/ose abuzimit ndaj fëmijëve.

3.3 Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë pranë NJMF-së.

- Ofrimin e përkujdesjes alternative për fëmijët të cilët nuk mund / nuk jetojnë me familjet e tyre.

- Pjesëmarrje në takimet e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.

- Lehtësimin dhe koordinimin ndërmjet NJMF-së dhe institucioneve të përkujdesit për të siguruar pranimin në kohë të fëmijëve, pa vonesa, kur fëmija është në rrezik të menjëhershëm.

- Bashkëpunimin me administratorët shoqëror në bashki/komuna për ofrimin e shërbimeve për fuqizimin e familjes.

- Identifikimin dhe menaxhimin e rasteve emergjente të fëmijëve në bashkëpunim me policinë, NJMF dhe aktorë të tjerë të nevojshëm, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

3.4 Drejtoritë rajonale të arsimit/ zyrat arsimore dhe shkollat

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë pranë NJMF-së. Rastet e fëmijëve në rrezik, përmes supervizorit të njesisë së shërbimit psiko-social/koordinatorit të psikologëve shkollorë referohen pranë NJMF-së bashkisë apo komunës¹.

- Lehtësimin dhe mbështetjen për ndjekjen e shkollës nga fëmijët të cilët janë identifikuar si vulnerabël ndaj abuzimit.

- Marrjen pjesë në takimet e grupit teknik multidisiplinar dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.

- Parandalimin dhe edukimin e fëmijëve për të shmangur situatat e rrezikshme.

- Sigurohen që stafi pedagogjik apo personat e

¹ Ministria e Arsimit dhe Sportit, manuali “Mbrojtja e fëmijëve në shkollë”, 2009



punësuar në institucionet arsimore të jenë “persona të sigurt” për të punuar me fëmijët.

3.5 Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe personeli i kujdesit shëndetësor

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje kur paraqiten pranë Qendrave Shëndetësore dhe referimin në kohë pranë NJMF-së.

- Trajtimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar apo dhunuar sipas protokollit të tajtimit dhe referimin e menjëhershëm të rastit pranë policisë dhe NJMF-së.

- Përpilimin e raporteve mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të fëmijës së abuzuar apo të supozuar si të abuzuar.

- Lehtësimin dhe ofrimin e ndihmës mjekësore, duke përfshirë kontrollet dhe analizat e zhvillimit të fëmijës.

- Pjesëmarrje në takimet e Grupit Teknik Multidisiplinar, mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.

- Mbështetjen dhe bashkëpunimin me NJMF-në për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme informuese me qëllim parandalimin e dhunës dhe/ose abuzimit ndaj fëmijëve.

3.6 Ofruesit e shërbimeve për fëmijë, Publikë dhe Privatë

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Referimin pranë NJMF-së kur një fëmijë është abuzuar apo supozohet se është abuzuar dhe ka nevojë për mbrojtje.

- Pjesëmarrjen në takimet e Grupit Teknik Multidisiplinar dhe mbështetjen për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të përkujdesit të hartuara për fëmijën.

- Ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet në përputhje me planin individual të mbrojtjes së fëmijës të miratuar.

- Të mbajë lidhje të rregullta me NJMF-në lidhur me zbatimin e planit, dhe për çdo situatë problematike.

- Lehtësimin e kontakteve ndërmjet fëmijës dhe familjes.

3.7 Komiteti drejtues në qark

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Monitoron zbatimin e të drejtave të fëmijëve në qark, duke përfshirë edhe zbatimin e të drejtës për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna, abuzimi

- Miraton marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet

institucioneve shtetërore në qark apo personave juridikë privatë për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët në rrezik.

- Mblidhet e diskuton problematikën e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik rregullisht, jo më pak se 2 herë në vit.

- Për menaxhimin e rasteve të veçanta fëmijëve në rrezik, komiteti drejtues vepron si një komitet koordinues *ad hoc* dhe anëtarët e nevojshëm mblidhen sipas rastit.

- Mbështet menaxhimin e rasteve të veçanta të fëmijëve në rrezik, të paraqitura nga NJDF brenda afateve kohore të përcaktuara në VKM nr. 265 datë 12.4.2012.

- Miraton planin e ndërhyrjes për rastet e veçanta të fëmijëve në rrezik.

- Paraqet propozime për masa dhe strategji rajonale konkrete për mbështetjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe politikave në mbrojtje të fëmijëve në nivel qarku dhe ua kalon ato institucioneve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

3.8 Njësitë e të Drejtave të Fëmijëve (NJDF) në qark

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Mbledhjen e informacionit nga institucionet përgjegjëse vendore për monitorimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve në qark.

- Menaxhimin e rasteve të veçanta të fëmijëve në rrezik, që nuk mund të zgjidhen nga NJMF-ja në nivel bashkie/komune. Në këto raste, NJDF-ja ndjek procedurat për menaxhimin e rasteve të përcaktuara në këtë Protokoll.

- I kërkon kryetarit të Këshillit të Qarkut thirrjen e mbledhjes së Komitetit Drejtues për mbështetje në menaxhimin e rasteve të veçanta të fëmijëve në rrezik, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për rastin. Për rastet emergjente mbledhja thirret brenda 2 ditëve (48 orëve).

- Bashkëpunimin me një nga NJMF brenda qarkut për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik në ato bashki/komuna ku nuk ka NJMF. Në këtë kuadër propozon dhe diskuton në mbledhjen e Komitetit Drejtues në qark, planin individual të mbrojtjes së fëmijës në rrezik. Në këto raste, NJDF ndjek procedurat për menaxhimin e rasteve të përcaktuara në këtë Protokoll.

- Mbajtjen e të dhënave për fëmijët, për planin e ndërhyrjes dhe bashkë me NJMF në bashki/komunë ndjek ecurinë e rastit.



- Nxitjen e ngritjes së NJMF-ve të reja brenda qarkut.

- Raportimin pranë ASHMDF çdo 6 muaj.

3.9 Bashkitë/komunat

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Ngritjen e NJMF duke punësuar të paktën një punonjës social, i cili është i aftë të zbatojë detyrat që ka një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve.

- Sigurimin e mbështetjes së punës së NJMF-së duke lehtësuar komunikimin edhe brenda strukturave të bashkisë.

- Alokimin e buxheteve të mjaftueshme në mënyrë që NJMF të funksionojë në mënyrë efikase duke përfshirë ofrimin e hapësirës dhe burimeve të përshtatshme në zyrë.

- Ofrimin e një hapësire të veçantë për PMF në mënyrë që takimet me familjet dhe profesionistët e tjerë të organizohen në mënyrë konfidenciale dhe që të dhënat të jenë të sigurta.

- Mundësimin e punonjësve të NJMF që të marrin pjesë në trajnime dhe aktivitete.

- Sigurimin që mbështetja e duhur teknike t'i ofrohet NJMF-së.

- Promovimin e statusit dhe rolit të PMF brenda dhe jashtë strukturës së bashkisë/komunës.

- Sigurimin që punës së PMF për mbrojtjen e fëmijëve, t'i jepet prioritet dhe jo ta devijojnë atë nga detyrat që nuk kanë lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.

- Mundësimin e PMF të kryejë vizita në familje, dhe takime me institucione apo aktorë të tjerë nëse është e nevojshme.

- Sigurimin e pjesëmarrjes së administratorëve socialë në takimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.

- Ofrimin e shërbimeve për fuqizimin e familjes.

- Ofrimin e shërbimeve alternative për fëmijët si: shërbimi i kujdestarisë etj.

3.10 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Përgjegjësitë përfshijnë:

- Monitorimin e situatës për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik në nivel kombëtar dhe punën e të gjithë mekanizmave institucionale përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik.

- Hartimin e udhëzimeve metodologjike për mbrojtjen e fëmijëve.

- Mbështetjen me udhëzime teknike kryesisht të NJMF-së dhe NJDF-së, por jo vetëm, lidhur me menaxhimin e rasteve dhe procedurave që duhet të ndiqen.

- Koordinimin me institucionet në nivel qendror për menaxhimin e rasteve të vështira të deleguara nga NJMF, të cilat nuk kanë marrë zgjidhje në nivel vendor.

- Vendosjen e sanksioneve individëve apo institucioneve të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre, nuk realizojnë mbrojtjen e fëmijës nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi.


IV. PROCEDURAT PËR NDËRHYRJEN NË NDIHMË TË FËMIJËVE NË RREZIK

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës lidhen si me parandalimin e abuzimit dhe keqtrajtimit të fëmijës ashtu edhe me përgjigjen ndaj situatave të abuzimit kur ato ndodhin.

Aneksi 1 përmban udhëzime teknike të detajuara në lidhje me llojet e shfaqjes së abuzimit, shkaqet, shenjat dhe simptomat e abuzimit, përfshirë dhe shenja që mund të shkëmbehen për keqtrajtme.

Mbrojtja e fëmijëve është njëkohësisht si proaktive dhe reaguese, përfaqëse e cila njihet ndryshe dhe me termin vazhdueshmëria e përkujdesjes. Në kontekstin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës, të cilave u referohet ky udhëzues, mbrojtja e fëmijës nuk ka të bëjë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, por në mënyrë specifike i referohet atyre të drejtave të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe veprime të tjera, të cilat dëmtojnë mbijetesën dhe zhvillimin e tyre.

Për një shërbim të balancuar dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijës, i cili përbëhet nga elementë proaktivë dhe reagues vihet theksi te parandalimi dhe ndërhyrjet e hershme / mbështetja e familjes, të cilat janë të nevojshme kur fëmija ka qenë ose është në një rrezik për abuzim. Kjo seri ndërhyrjesh si proaktive, parandaluese, shërbime reaguese, shpeshherë përkufizohet si vazhdueshmëri e përkujdesjes.



Në terma të përgjithshëm me rritjen e intensitetit të rrezikut ndaj fëmijës rritet gjithashtu edhe niveli i ndërhyrjes.

- Niveli parësor - UNIVERSAL - Për të gjithë fëmijët dhe familjet brenda popullatës / zonës.

- Niveli dytësor – TË TARGETUARA - Për fëmijët dhe familjet nga grupe të identifikuar të cilat mund të jenë të prekshme ndaj abuzimit ose me nevoja më specifike.

- Niveli tretësor - INDIVIDUAL - Plane individuale, ndërhyrje të hartuara për secilin fëmijë të abuzuar apo në rrezik.

1. Menaxhimi i rastit

Procesi i menaxhimit të rastit shpreh në mënyrë të detajuar hapat që duhet të ndërmerren pas identifikimit të një rasti në mënyrë që të sigurohemi se fëmija merr shërbimet dhe mbështetjen e duhur. Të gjitha rastet ndjekin të njëjtat hapa bazë, megjithëse detajet do të jenë të ndryshme gjatë çdo faze.

Procesi i menaxhimit të rastit ka këto faza:

1. Identifikimi/referimi.
2. Vlerësimi fillestar.
3. Vlerësimi i plotë (gjithëpërfshirës).
4. Planifikimi i mbrojtjes dhe përkujdesit.
5. Zbatimi, monitorimi dhe ndjekja e planit.
6. Mbyllja e rastit.

Hapi i parë i procesit të menaxhimit të rastit është identifikimi i rastit, i cili mund të vijë si pasojë e një incidenti që mund të ndodhë dhe që raportohet ose për shkak të rritjes së shqetësimit lidhur me mirëqenien e një fëmije nga aktorë (si p.sh. shkolla), të cilët janë duke bashkëpunuar vazhdimisht me fëmijën.

Institucionet dhe /ose ofruesit e shërbimeve të cilët identifikojnë rastin, e referojnë atë te

NJMF, duke plotësuar formularin e referimit për mbrojtjen e fëmijës (aneksi 2). Nëse nuk është e mundur që të përmbushet i gjithë informacioni i kërkuar në formular, duhet të paraqiten sa më shumë detaje që të jetë e mundur. Referimet te NJMF bëhen brenda 24 orëve nga identifikimi i rastit, ose në ditën pasardhëse të punës.

Në rastin kur fëmija është në rrezik të menjëhershëm (situatë emergjente) fillimisht duhet të kontaktohet policia dhe menjëherë më pas kontaktohet NJMF ose strukturat e Shërbimit Social Shtetëror, me qëllim për të garantuar sigurinë e fëmijës duke e marrë atë në mbrojtje të menjëhershme, si edhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme sipas rastit: strehim, ushqim, kujdes shëndetësor, etj. Kur nuk ka NJMF në zonë, rasti duhet të referohet te Njësia për të Drejtat e Fëmijëve në qark.

Në këto raste punonjësit, që do të marrin në mbrojtje fëmijët në rrezik të menjëhershëm (situatë emergjente), duhet të plotësojnë dhe firmosin procesverbalin “Për marrjen në mbrojtje të fëmijës në rrezik të menjëhershëm”, i cili është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi (bashkëlidhur).

3. Vlerësimi fillestar

Faza e dytë e procesit është vlerësimi fillestar, i cili është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut bazuar në informacionin e disponueshëm. NJMF është përgjegjësjë kryesore për vlerësimin fillestar e cila mund të kontaktojë institucione apo organizma të tjera në mënyrë që të merret një vendim më i përshtatshëm. Vlerësimi fillestar duhet të përmbyllet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe maksimalisht brenda 48 orëve si dhe të vlerësojë:

- Sigurinë e fëmijës dhe nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër;

- ofrimin e shërbimeve të domosdoshme për t'u ofruar me urgjencë në bazë të nevojave të rastit, (p.sh. trajtim mjekësor, ushqim, strehim etj.);

- nëse është e nevojshme të ndërmerren veprime të tjera, për të vlerësuar nëse rasti është referim i përshtatshëm.

Në momentin e vlerësimit fillestar, një rast mund të merret në konsideratë edhe sikur të mos ketë më nevojë për veprime të mëtejshme sepse referimi i bërë nuk lidhet drejtpërdrejtë me një



shqetësim për mbrojtjen e fëmijës. Këto raste duhen referuar drejtpërdrejtë pranë institucioneve përgjegjëse.

Një element kyç i cili duhet marrë parasysh gjatë fazës së referimit dhe vlerësimit fillestar është ai i sigurisë së fëmijës. Nëse vlerësohet se nuk është e sigurt që fëmija të qëndrojë në shtëpi gjatë një periudhe afatshkurtër ose në qoftë se nuk ka shtëpi, atëherë NJMF, SHSSH, OJF dhe policia duhet të punojnë së bashku për të gjetur një vend të përshtatshëm ku të qëndrojë fëmija.

Rasti mund të ketë nevojë për urdhër mbrojtjeje, në zbatim të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”. Megjithatë kur shikohet që nuk ka baza të mjaftueshme për urdhër mbrojtjeje, ose kur për marrjen e urdhrit nevojitet kohë dhe kur punonjësit janë përsëri të shqetësuar për sigurinë e fëmijës, atëherë ata duhet të negociojnë me prindërit në mënyrë që fëmija të qëndrojë diku tjetër (p.sh. te kushërinjtë ose te një mik/komshi) deri sa të përfundojë vlerësimi i plotë. Do të ishte e preferueshme, ose duhet të shtrohet si alternativë, që personi i dyshuar për abuzim ndaj fëmijës të largohet nga shtëpia.

Kur ka dyshim se mund të ketë ndodhur një vepër penale, duhet të njoftohet policia dhe të kërkohet mbështetje ligjore për të siguruar se mbledhja e informacionit, ku përfshihen deklaratat dhe dëshmitë, është marrë në përputhje me procedurat e duhura ligjore.

Pas vlerësimit fillestar, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës shpjegon në dokumentacion nëse do të ofrohet mbështetje e mëtejshme ose nëse rasti është mbyllur në këtë fazë.

4. Vlerësimi i plotë

Ky është një hap i rëndësishëm gjatë procesit të menaxhimit të rastit dhe duhet të përmbushet me kujdes pasi përbën bazën për hartimin e Planit të Mbrojtjes dhe Përkujdesit Individual për Fëmijën. Vlerësimi i plotë përqendrohet kryesisht te nevojat e fëmijës (dhe të familjes së tyre) dhe te siguria e tyre².

Vlerësimi i plotë identifikon:

- Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë;

- nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre;

- pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e fëmijës, familjes, nëse është e nevojshme edhe të familjes së gjerë.

Vlerësimi i plotë duhet të përfundojë brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar, dhe përqendrohet kryesisht te nevojat e fëmijës, familjes dhe te siguria e tyre.

Aneksi 3 - Kryerja e procesit të vlerësimit përmban informacion të detajuar mbi procesin e vlerësimit, fazat dhe dimensionet e tij, si dhe etapat e zhvillimit të fëmijës, përmban udhëzime të detajuara mbi fazat e procesit të vlerësimit. Për vlerësimin e plotë, plotësohet formulari i vlerësimit dhe analiza e rrezikut (aneksi 4) dhe një kopje duhet të ndahet me Grupin Teknik Multidisiplinar. Aneksat 4 “c” dhe 4 “d” paraqesin disa metoda të tjera të thjeshta që përfshijnë fëmijën dhe familjen për procesin e vlerësimit.

Duhet të bëhet të paktën një vizitë në shtëpi si pjesë e procesit të vlerësimit. Formulari për vizitat në shtëpi dhe vëzhgime (aneksi 5) duhet të përdoret për të mbajtur shënim detaje të ndryshme gjatë vizitës në shtëpi/vëzhgimeve në familje dhe një kopje duhet të mbahet në dosjen e fëmijës. Udhëzimet mbi intervistimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre janë dhënë në aneksin 6.

Për të realizuar vizitën e parë në familje, ose nëse fëmija/familja nuk mund të vijë pranë NJMF-së, për arsye sigurie mund të organizohet një vizitë e përbashkët e PMF-së me një anëtar tjetër të Grupit Teknik Multidisiplinar. Në rastet kur ka problematika të lidhura me sigurinë dhe tregues për praninë e dhunës, në vizitat në familje duhet të përfshihet edhe policia.

5. Planifikimi i Përkujdesit dhe i Mbrojtjes

Pasi është përfunduar vlerësimi, duhet të hartohet një plan përkujdesi dhe mbrojtjeje i cili përmban hapat që duhet të ndërmerren nga aktorët e ndryshëm, për të përmbushur nevojat e fëmijës dhe për të ulur nivelet e rrezikut.

Plani Individual për Mbrojtjen e Fëmijës hartohet brenda 5 ditëve pune pasi ka përfunduar vlerësimi i plotë. Ky plan adreson nevojat e fëmijës dhe familjes, përcakton shërbimet e nevojshme, ofruesit e këtyre shërbimeve si dhe afatet kohore se kur do të ofrohen shërbimet.

² Për një informacion të detajuar mbi referojnë aneksit 3



Për rastet me rrezik të ulët, ky plan bëhet nga NJMF ose një grup i vogël personash, të cilët hartojnë planin dhe më pas koordinohen me agjencitë dhe aktorët e tjerë.

Kur rreziku në të cilin ndodhet fëmija është në nivelin e mesëm, të lartë, të menjëhershëm, ose kur rasti ka rrezik të ulët por është kompleks, plani duhet të miratohet gjatë takimit të Grupit Teknik Multidisiplinar.

Qëllimi i takimit të Grupit Teknik Multidisiplinar³ gjatë të cilit do të hartohet Plani Individual i Mbrojtjes dhe Përkujdesit, është përcaktimi i hapave që duhet të ndërmerren, nga kush dhe kur për të:

- identifikuar dhe përcaktuar nivelin e rrezikut;
- siguruar që fëmija është i sigurt, apo faktorët e rrezikut janë ulur;
- promovuar interesat më të larta dhe plotësimin e nevojave të fëmijës;
- ofruar mbështetje për familjen në mënyrë që ata të kujdesen në mënyrën e duhur dhe të mbrojnë fëmijën.

Formulari i shqyrtimit të progresit / planit individual të mbrojtjes së fëmijës (aneksi 7) duhet të përpilohet gjatë takimit përmes identifikimit të nevojave të fëmijës dhe mënyrave për t'i përmbushur ato. Aty gjithashtu do të përfshihen hapat që duhen ndërmarrë për të zvogëluar rrezikun. Kur hartohet plani është e rëndësishme të vlerësohen mirë alternativat e ndryshme pasi një përzgjedhje e cila mund të përmbushë një nevojë ose që mund të reduktojë një rrezik mund të ketë si pasojë shkaktimin e dëmit të mëtejshëm/krijimin e problemeve të reja.

Një kopje e Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës duhet të mbahet në dosjen individuale të fëmijës. Në rastin kur ka më shumë se një fëmijë në familje duhet të hartohet një plan individual për secilin fëmijë, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre individuale.

Fëmijët dhe anëtarët e familjes e dinë mjaft mirë cila është situata në familjen e tyre dhe çdo

³ Për më shumë detaje mbi përmbajtjen dhe funksionimin e Grupit Teknik Multidisiplinar të shikohet VKM nr. 265, datë 12.4.2012 "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij"

plan që mund të ndërmerret pa miratimin e tyre, mund të dështojë. Prandaj konsiderohet si një praktikë e mire që fëmija dhe prindërit/kujdestarët të jenë të pranishëm në takimin për Mbrojtjen e Fëmijës në mënyrë që ata të marrin pjesë në procesin e planifikimit. Familjet dhe fëmijët mund të kenë nevojë për mbështetje dhe asistencë gjatë takimeve të tilla në mënyrë që ata të kenë mundësi të shprehin tërësisht mendimet e tyre.

Në rastet kur shqyrtohet zhvendosja e fëmijës nga familja, fillimisht duhet të vlerësohet strehimi tek anëtarët e tjerë të familjes, komunitetit dhe si alternative e fundit duhet të konsiderohet vendosja e tij në një strehëz apo institucion rezidencial. Në këtë rast, përpara se fëmija të kthehet në shtëpi, duhet të ndërmerret një vlerësim për të gjykuar sesi është reduktuar rreziku në familje dhe a është e përshtatshme për fëmijën të kthehet në shtëpi.

6. Zbatimi, monitorimi dhe ndjekja

NJMF monitoron zbatimin e Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës nga të gjithë aktorët. NJMF bën vizita të rregullta në familje, për të vlerësuar ecurinë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes së Fëmijës. Rishqyrtimi formal i planit bëhet 6 javë pas hartimit të planit të parë dhe pastaj çdo 3 muaj, por mund të bëhet edhe më shpesh nëse është e nevojshme dhe nëse janë dakord anëtarët e Grupit Teknik Multidisiplinar.

Në takimet shqyrtuese të organizuara nga NJMF thirren të marrin pjesë, ata anëtarë të Grupit Teknik Multidisiplinar, të cilët ofrojnë shërbime sipas planit dhe që kanë njohuri mbi rastin. Për rastet me rrezikshmëri të lartë, të gjithë anëtarët e Grupit Teknik Multidisiplinar mbledhen dhe shqyrtojnë ecurinë e rastit, të paktën çdo gjashtë muaj.

Në takimet shqyrtuese analizohen veprimet dhe masat e ndërmarra për të vlerësuar nëse ato po zbatohen sipas planit, nëse janë akoma të nevojshme dhe nëse kanë nevojë për përshtatje në përputhje me nevojat në ndryshim të fëmijës dhe familjes. Në takimet shqyrtuese vlerësohet niveli aktual i rrezikut dhe rishikimi i Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës nëse është e nevojshme.

Formulari i Shqyrtimit të Progresit/Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës (aneksi 7) përditësohet pas çdo takimi shqyrtues. NJMF dokumenton mbledhjet shqyrtuese në dosjet përkatëse.



7. Mbyllja e rastit

Rasti mbyllet kur:

- fëmija është mbi 18 vjeç;
- ndërhyrjet e ndërmarra e kanë reduktuar nivelin e rrezikut, në rrezik të ulët ose mungesë rreziku;
- fëmija nuk gjendet më në atë situatë dhe kur nuk paraqiten rrethana që fëmija të kthehet në atë situatë rreziku përpara se të mbushë 18 vjeç;
- fëmija vdes;
- fëmija transferohet në një zonë tjetër dhe rasti transferohet për ndjekje te një NJMF tjetër.

Rastet me rrezik të ulët mbyllen nga NJMF vetëm pasi është rënë dakord me eprorin dhe profesionistët që janë duke ofruar shërbime për fëmijën.

Për rastet me rrezik të mesëm, të lartë dhe të menjëhershëm, vendimi për mbylljen e rastit do të merret në takimin e Grupit Teknik Multidisiplinar. Plotësohet formulari për mbylljen e rastit (aneksi 8).

8. Mbajtja dhe raportimi i të dhënave

NJMF mbajnë dy lloj të dhënash:

- Të dhëna individuale – informacion rreth rastit dhe menaxhimit të tij. Qëllimi i këtij informacioni është të ndihmojë punonjësit në zbatimin dhe monitorimin e planeve që të mbështesin fëmijën dhe familjet e tyre. Kjo dosje do të ofrojë informacion të rëndësishëm në qoftë se rasti duhet të shqyrtohet (p.sh. nëse fëmija vdes) ose nëse merret një vendim nga gjykata në të ardhmen se kur duhet të ofrohet një përmbledhje e punës së bërë në familje. Gjithashtu shërben, nëse fëmija në një periudhë të mëvonshme, kërkon “historinë” mbi atë që i ka ndodhur.

- Të dhëna statistikore në lidhje me numrin dhe llojin e rasteve të menaxhuara nga NJMF, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në fuqi, në mënyrë që bashkitë/komunat, NJDF, ASHMDF dhe SHSSH të kenë mundësi të monitorojnë zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës. Këto të dhëna do të ndihmojnë në identifikimin e tendencave lidhur me mirëqenien e fëmijës dhe për të ndihmuar në hartimin e evidencave për të advokuar për shërbime dhe fonde.

- Kërkesat e raportimit dhe mbledhjes së të dhënave statistikore janë të përcaktuara në aktet nënligjore dhe anekset.

Kur NJMF zgjidh shpejt një rast me rrezik të

ulët dhe kur nuk ka rrethana për kontakte të mëtejshme me fëmijën dhe familjen, atëherë nuk është e nevojshme që të krijohet një dosje individuale për fëmijën, por puna e bërë duhet të paraqitet te formulari i referimit për mbrojtjen e fëmijës (aneks 2). Të gjitha kontaktet e NJMF me familjen duhet të regjistrohen.

Për të gjitha rastet në rrezik të mesëm, të lartë, të menjëhershëm, ose kur do të ketë kontakte të vazhdueshme me familjen për më shumë se vetëm disa ditë, krijohet dosja individuale e fëmijës.

Dosja individuale e fëmijës ka një numër individual dhe përmban:

- Fletët e informacionit bazë – aneks 9 – (e cila duhet të përditësohet rregullisht dhe të mbahet në fillim të dosjes për t’iu referuar më me lehtësi);

- formulari i referimit për mbrojtjen e fëmijës - aneks 2;

- formulari i vlerësimit – aneks 4 (“a”, “b”, “c”, “d”);

- formulari i shqyrtimit të progresit / planit individual të mbrojtjes së fëmijës – aneks 7;

- formulari “Fletë të ditarit” - aneks 10 - që japin në mënyrë të detajuar datat dhe orët e të gjitha kontakteve me familjen/fëmijën ose me anëtarët e Grupit Teknik Multidisiplinar përfshirë përmbledhjet e diskutimeve, takimeve dhe vizitave në shtëpi;

- informacione të tjera të rëndësishme – si p.sh. certifikata e lindjes, vendimet gjyqësore etj.;

- formulari i mbylljes së rastit – aneks 8.

Të dhënat mbahen në *hard copy* dhe në version elektronik. Të dhënat ruhen në një mjedis të sigurt të aksesueshëm vetëm nga NJMF. I gjithë informacioni i mbledhur nëpërmjet vlerësimit ose bisedave telefonike apo dhe në intervistat ballë për ballë, duhet të regjistrohet sa më shpejt që të jetë e mundur pasi në këtë mënyrë sigurohet saktësia e informacionit

Të gjithë formularët e plotësuar me dorë duhet të plotësohen me stilolaps dhe jo me laps.

Konfidencialiteti

NJMF, për shkak të rolit dhe funksionit dhe me qëllim menaxhimit të rastit, nuk mban sekret informacionin e marrë nga fëmija apo anëtarë të familjes, por regjistron këtë informacion në dosjet e tyre dhe ta përdorin për veprimet që do të ndërmarrin për zgjidhjen e rastit të fëmijës në



nevojë, duke ruajtur konfidencialitetin dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Fëmijët, kujdestarët dhe familjet përgjegjëse informohen për ndarjen e informacionit dhe i kërkohet të nënshkruajnë formularin e miratimit për ndarjen e informacionit (aneks 11) kur kjo është e mundur dhe nuk bie ndesh me interesin më të lartë të fëmijës. Kur një familje ose fëmijë nuk jep aprovimin për ndarjen e informacionit, por kjo gjykohet si e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës, atëherë informacioni duhet ndarë edhe pa marrë miratimin e tyre.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve nuk duhet t'i premtojë fëmijës apo anëtarit të familjes se informacioni do të mbahet sekret. Fëmija duhet të njohë kufijtë dhe rolin e PMF dhe të kuptojë se i vetëm, Punonjësi, nuk mund ta mbrojë atë ose të ndryshojë situatën abuzuese në të cilën mund të ndodhet fëmija. Asnjë agjencie nuk i vjen në ndihmë premtimi që ta mbajë informacionin “të fshehtë”. Gjithsesi duhet përmendur që informacioni do të ndahet vetëm kur do të jetë e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës dhe pasi të jetë informuar fëmija dhe familja.

IV. TË TJERA

1. Bashkëlidhur këtij udhëzimi janë anekset me udhëzimet teknike dhe formularët.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
Erion Veliaj

MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

MINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Saimir Tahiri



ANEKSET

ANEKS 1 - UDHËZIME TEKNIKE PER PROCESIN E MENAXHIMIT TE RASTIT

Tabela 1 ofron një listë gjithë përfshirëse të llojeve të ndryshme të sjelljeve ndaj fëmijëve për secilën kategori të abuzimit. Një veprim, ose mungesë veprimi, konsiderohet të jetë abuziv kur krijon, ose ka mundësi të krijojë dëmtim serioz të shëndetit dhe të zhvillimit të fëmijës. Megjithatë, lidhur me abuzimin seksual, për shkak të ndikimit afatgjatëmbi fëmijën, të gjithë veprimet konsiderohen *automatikisht* si abuzive edhe në ato raste kur fëmija nuk duket se është dëmtuar.

Identifikohen edhe forma të tjera abuzimi si p.sh. shfrytëzimi dhe trafikimi. Megjithatë, këto kategori janë shfaqje të ndërthurura të katër kategorive të përmendura më sipër. Lidhur me dëmtimin që i shkaktohet fëmijës, të gjithë keqtrajtimet mund të konsiderohen si rezultat i një ose disa kombinimeve të llojeve të ndryshme të abuzimeve.

Shfaqjet e Abuzimit

Tabela 1: Llojet e Shfaqjes se Abuzimit	
<p><i>Fizike</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrahja • Tortura • Shkundja/shtytja me forcë • Goditja me shpullë • Pickimi • gjerria • Kafshimi • Qortimi i rreptë • Rënia me grusht • Goditja e një fëmije me një objekt; • Vendosja e fëmijës në një pozicion të papërshtatshëm ose në një mjedis për një periudhë të gjatë kohore • Përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim • Detyrimi me forcë për të kryer një veprim • Të detyrosh një fëmijë të punojë në kushte të vështira pune ose të papërshtatshme për moshën e fëmijës për një periudhë të gjatë kohore • Dhunë në grup • Ceremoni të dëmshme me rastin e hyrjes në një shoqëri të re (në grupet e vëllazërimit etj.) • <i>Bullizmi (mund të jetë edhe emocional)</i> 	<p><i>Emocionale</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Izolimi ose përjashtimi • Stigmatizimi • Dështimi për ofrimin e mjedisit mbështetës • Kujdestari/kujdestarja kryesore nuk i përgjigjet nevojave emocionale të fëmijës • Poshtërim • Ngacmimi përmes internetit dhe bullizmi • Sharje, bërtitje, grindje dhe mbase dhe mallkim të fëmijës në mënyrë të tepruar, që e kalon masën • Bërja e komenteve që shpreh diskriminim dhe poshtërim të fëmijës • Ngacmim i vazhdueshëm (si p.sh. i drejtohen me emra që e mërzhisin fëmijën ose e tallin) • Përhapja e thashethemeve (mosruajtja e konfidencialitetit) • Kërcënim



<p>Neglizhimi</p> <ul style="list-style-type: none"> Mungesë e përkujdesjes pavarësisht burimeve të disponueshme Mungese mbikëqyrjeje dhe mbrojtjeje të fëmijës nga dëmtimet 	
<p style="text-align: center;">Seksuale</p> <p>Përfshirja e fëmijës në një aktivitet seksual të cilin ai/ajo nuk e kupton mirë, nuk është në gjendje të ofrojë aprovim të mbështetur në informacion, ose nuk është i përgatitur nga ana zhvillimore, si për shembull:</p>	
<p>Kontakti</p> <ul style="list-style-type: none"> Puthur ose mbajtur në një mënyrë seksuale Prekur ose përkëdhelur në zonat gjenitale Detyruar të prekë zonat gjenitale të një personi tjetër Detyruar të bëjë seks oral Marrëdhënie vaginale ose anale Penetrim vaginal ose anal me objekte ose gisht Inçest Seks me kafshët 	<p>Pa kontakt</p> <ul style="list-style-type: none"> Telefonata/komente të pahijshme në kompjuter ose përmes shënime me shkrim Seks virtual Joshje seksuale përmes internetit Vojerizëm/ Kënaqësia seksuale përmes të parit Ekspozuar ose fotografuar për pornografi Pyetje ose komente të bezdisura seksuale I detyruar për t'u masturbuar vetë ose të shohë të tjerët të masturbohen Ekspozim i turpshëm

Shenjat dhe Simptomat e Abuzimit

Zakonisht fëmijët nuk flasin menjëherë lidhur me abuzimin që mund t'iu ketë ndodhur – sidomos ata që janë shumë të vegjël, që kanë vështirësi në komunikim ose ata të cilëve nuk ju dëgjohen mendimet (ose që nuk ju besohet).

Të gjithë të rriturit duhet të jenë vigjilent për të dalluar shenja dhe simptoma të cilat mund të tregojnë se fëmija ka pësuar abuzim. Në këtë fazë, nuk është e rëndësishme që të ketë “evidenca” që diçka po ndodh por duhet të rritet interesi për të bërë një referim, të rastit.

Tabela 2 paraqet një listë të treguesve ose shenjave të një abuzimi të mundshëm, që mund të shfaqen tek një fëmijë. Është e rëndësishme që të kuptohet se, vetëm këto tregues jo domosdoshmërisht “provojnë” që një fëmijë është abuzuar, por kur ato vërehen, rasti duhet të referohet pranë NJMF-së, i/e cila duhet të ndërmarrë vlerësime të mëtejshme për tu siguruar nëse ka apo jo një shkak real për t'u shqetësuar. Me qëllim lehtësimin e identifikimit të treguesve të abuzimit, në Tabelën 3, paraqiten shenja të cilat mund të keqkuptohen si të shkaktuara nga abuzimi por në realitet kanë arsye të tjera si psh shëndetsore.

Tabela 2: Shenjat dhe Simptomat e Abuzimit të Mundshëm		
Abuzimi Fizik:		
Indikatorët Fizik	Indikatorët e Sjelljes	Sjellja/Qëndrimi i Prindit/Kujdestarit



<p>Mavijosje ose shenja të pashpjegueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në fytyrë, buzë, gojë Në kraharor, shpinë, vithe, kofshë, krahët e sipërm Të moshave, ngjyrave dhe fazave të ndryshme të shërimit Të grupuara bashkë, që formojnë forma specifike, që reflektojnë formularin e objektit të përdorur (kablo elektrike, rrip, gishta) Në pjesë të trupit të cilat nuk mavijosen kollaj; vihen re pasi një fëmijë nuk është parë ose pas fundjavës ose pushimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> Fëmija mendon se e meriton të ndëshkohet I kujdesshëm dhe vigjilent në mjedisin me të rriturit Nervoz kur qajnë fëmijë të tjerë Ekstreme sjelljeje Agresiv ose i tërhequr I frikësuar nga prindërit e tij/saj Ka frikë të shkojë në shtëpi Raporton dëmtim nga prindërit e tij/saj Vështrim i zbrazët ose i ngrirë Qëndron pa lëvizur dhe nuk shikon vërdallë rreth e rrotull (për foshnjat) Përgjigjet me fjalë me një rrokje Sjellje e papërshtatshme për zhvillimin ose të hershme për moshën. Sjellje manipuluese për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve Krijon vetëm marrëdhënie sipërfaqësore Kërkon dashuri nga çdokush pa marrë parasysh rrethanat Vetë vlerësim të ulët. 	<ul style="list-style-type: none"> Duket i pashqetësuar për plagët e fëmijës Ofron shpjegime të rreme se si u shkaktuan plagët Tenton të fshehë plagët Ai/ajo druhet në dhënien e informacionit për plagët e fëmijës Përdor një disiplinë të ashpër për sjelljen jo të mirë të fëmijës dhe jo në përputhje me moshën dhe të kuptuarin e fëmijës Ka pritshmëri jo realiste për fëmijën Ka një perceptim negativ apo të gabuar për fëmijët; i mendon fëmijët si “monstra” ose sikur gjithçka e bëjnë gabim
<p>Djegje të pashpjegueshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> Djegje nga cigare, sidomos në gjuhë, pëllëmbë, krahë, këmbë, kurriz ose vithe Djegje që ngjajnë me formularin e objekteve, p.sh. elemente elektrike, llamba, hekura, zjarre elektrike; Djegje nga litari në krahë, këmbë, qafë ose kraharor Djegje të infektuara ose me fluska uji që nuk janë trajtuar nga ana mjekësore Shenja përvëlimi me fluska uji dhe të djegura nga uji i nxehtë. 		<ul style="list-style-type: none"> Ai / ajo ka probleme të rënda mendore që nuk mund të kontrollohen Nuk është i qëndrueshëm emocionalisht dhe është impulsiv/e. Abuzon me alkoolin dhe me substanca të tjera Rrëfen se vetë ai/ajo është abuzuar në fëmijëri.
<p>Fraktura, kocka të thyera ose ndrydhje të pashpjegueshme në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Në hundë, fytyrë, kokë, kyçe, krahë, trup apo këmbë Fraktura të vjetra dhe të reja tek një fëmijë në të njëjtën kohë Shumë fraktura ose ndrydhje Bebe që nuk lëvizin dot prej frakturave. 		

<p>Gërvishtje ose çjerrje të pashpjegueshme përreth ose në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Gojës, buzëve, syve, veshëve, qafës ose trupit; Organet gjenitale Shumë gërvishtje ose çjerrje të moshave të ndryshme dhe fazave të ndryshme të shërimit. 		
<p>Plagë të pashpjegueshme abdominale që përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Fryrje Të vjella Gjak në jashtëqitje ose urinë Brishtësi 		
Abuzimi Seksual		
Indikatorët Fizik	Indikatorët e Sjelljes	Sjellja/Qëndrimi i Prindit/Kujdestarit



<ul style="list-style-type: none"> • Vështirësi në ecje ose në qëndrimin ndenjur pa lëvizur • Shtatzënia • Masturbim • Dhembje gjatë urinimit ose jashtëqitjes • Mavijosje, gjakosje ose gërvishje në organet gjinitale, në vagjinë ose në pjesën anale • Infeksione orale tek fëmijët • Sëmundje seksualisht të transmetueshme te fëmijët dhe adoleshentët • Funksimi i dobët i muskulit të sfinkterit • Lojëra me tendenca seksuale • Nuk frenon sjelljen seksuale me të rriturit • Urinin dhe ndot shtratin edhe pse fëmija e ka fituar kontrollin e këtyre funksioneve të trupit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tërheqje ose afrimetet i tepruar me të rriturit dhe/ose të panjohurit • Sjellje dhe njohuri të papërshtatshme seksuale • Marrëdhënie të varfra me bashkëmoshatarët • Sjellje e përsëritur fajtores • Largohe shpesh nga shtëpia e tij/saj ose institucioni • Dëmton veten • Abuzon me alkoolin ose drogën • Ndryshim dramatik në ecurinë në shkollë, nota mbetëse, mungesa të pajustificuara • I dëshpëruar • Tentativë vetëvrasjeje • Çrregullime të rënda në gjumë, përfshirë: ëndrra të këqija, makthe, pagjumësi • Çrregullime me të ngrënit, bulimi, anoreksi • Seksualisht aktiv në moshë të hershme • Vetë vlerësim të ulët • Mungesë besimi tek të tjerët • Masturbim në vende të papërshtatshme dhe në publik • Raporton se ai/ajo është ngacmuar seksualisht nga kujdestari i tij/saj; • Kufij të paqartë midis sjelljes së përshtatshme të një fëmije dhe/ose të një të rrituri. 	<ul style="list-style-type: none"> • Xhelozia për kujdesin që burri/gruaja i kushtojnë një fëmije në familje • Prindi/kujdestari/i rrituri i jep vazhdimisht dhurata një fëmije në familje • Partneri ka një sëmundje kronike • Prindi/kujdestari/i rrituri vuan nga abuzimi me alkoolin ose me substanca narkotike • Prindi/kujdestari/i rrituri nuk pranon përgjegjësinë për abuzimin e fëmijës; fajëson fëmijën dhe e lidh atë [abuzimin] me sjelljen e fëmijës • Prindi/kujdestari/i rrituri e vesh fëmijën në mënyrë të papërshtatshme • Prindi/kujdestari/ i rrituri ka kontroll të dobët ose të kufizuar mbi impulset e dëshirave të tij/saj. • Probleme martesore • Është i ftohtë dhe refuzues ndaj fëmijës; nuk i jep dashuri dhe dhembshuri fëmijës përveçse kur e abuzon seksualisht atë • Kontrollon shumë lëvizjet e fëmijës, mundësinë e tij/saj për të folur me të tjerët ose për të ndenjur me shokë • Mohon sjelljet dhe ndenjat e papërshtatshme seksuale për fëmijën • Aftësi shprehëse të kufizuara • Ka marrëdhënie të varfra me bashkëmoshatarët • Familja është e izoluar dhe nuk integrohet me komshinjtë ose komunitetin • Kufijtë midis të rriturve dhe fëmijëve janë të paqartë dhe shpesh nuk respektohen • Vetë vlerësim të ulët • Prindi/kujdestari/i rrituri është abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë së tij/saj.
Abuzimi Psikologjik/Emocional		
Indikatorët Fizik	Indikatorët e Sjelljes	Sjellja/Qëndrimi i Prindit/Kujdestarit



<ul style="list-style-type: none"> • Prapambetje ose vonesë në zhvillimin fizik • Dështimi jo-organik për zhvillim • Pamundësi për t'u rritur • Sjellje hiperaktive, mospërqendrim • I tërhequr, në ankth, i izoluar • Nuk të sheh në sy • Pamje të ngrirë ose pa shprehje në fytyrë • Mungesë emocionale ose emocione të përziera • Pengohet me këmbët e veta • I bën naze ushqimit • Kërkon vëmendje nga të gjithë • Ka nevojë për aprovim të vazhdueshëm • Pickon lëkurën e vet derisa ajo acarohet ose gjakoset • Ndot ose lag shtratin • Makthe 	<ul style="list-style-type: none"> • Shqetësime gjumi • Shqetësime me ngrënien • Frikë e pazakontë dhe ankthe. • Fëmija nuk e ndryshon apo zbut shprehjen e tij/saj të fytyrës • Tepër i bindur ose i nënshtruar • Agresiv • I ngjitur ose nuk lejon fëmijët e tjerë që t'i afrohen • I mbyllur në vetvete • Mendon se të tjerët nuk e pëlqejnë/duan atë • Bën komente negative mbi veten dhe sjelljen e tij/saj ("Asnjëherë nuk bëj ndonjë gjë si duhet") • Ka vështirësi që ta përshkruaj veten në një mënyrë pozitive • Ka nevojë që të pajtohet me dëshirat e prindërve dhe merr lëvdata ose prindërit e njohin [sjelljen e mirë] • Sjellje dhe përgjigje shoqërore të papërshtatshme • Mungesë besimi • Beson se ai/ajo duhet të dënohet • Tenton të vrasë veten apo ka pasur mendime për vetëvrasje 	<ul style="list-style-type: none"> • Fajëson/tallet dhe nënvlerëson fëmijën • Është i ftohtë dhe refuzues dhe nuk i jep fëmijës dashuri ose ngrohtësi • Nuk shfaq sjellje ose qëndrime pozitive ndaj fëmijës • Jep përshkrime ose shpjegime negative për sjelljen e fëmijës • I trajton fëmijët në familje në mënyrë të pabarabartë • Nuk interesohet për problemet e fëmijëve ose i minimizon ato • Ka varësi nga alkooli ose substancat • Është neglizhuar ose keqtrajtuar në fëmijëri • Prindi / adulti pranon se ata nuk dinë sesi të tregojnë dashuri pozitive ndaj fëmijës • Prindi/kujdestari/i rrituri nuk është në gjendje të krijojë marrëdhënie të gjata • Prindërit/ të rriturit janë në një marrëdhënie abuzive • Familja vuan nga dhuna në familje • Nuk është i aftë t'u përgjigjet nevojave të fëmijës ose t'u përgjigjet atyre në mënyrë të vazhdueshme ose të përshtatshme • Prindi/kujdestari/i rrituri vendos nevoja/dëshirat e tij/saj mbi ato të fëmijës • Jep përgjigje të ashpra dhe/ose të dëmshme për kërkesat/pyetjet e fëmijës • Kërcënon dhe tremb fëmijën • Kërcënon fëmijën se do ta largojë atë ose e kërcënon me ndëshkime të ashpra • Është i pandërgjegjshëm për nevojat bazë të fëmijës dhe e shikon fëmijën si të aftë për t' i përballuar vetë nevojat • Percepton fëmijën si mëkatar, problematik, të poshtër, manipulues • Beson se fëmija është përgjegjës për reagimet negative të prindit/kujdestarit/të rriturit • Impulsiv, i paaftë, për të qenë i qëndrueshëm në përgjigjen e tij/saj ndaj fëmijës • Ka vetë vlerësim të ulët, i
		<p>mungon besimi në aftësitë e tij/saj për t'u kujdesur për fëmijën</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor hedhjen e përgjegjësisë dhe fajëson fëmijën për problemet e tij/saj • Ndjehet jashtë kontrollit, nuk ka rrjete mbështetje ose aftësi përballuese



Neglizhimi		
Indikatorët Fizik	Indikatorët e Sjelljes	Sjellja/Qëndrimi i Prindit\Kujdestarit
<ul style="list-style-type: none"> Nën peshë, ose i shkurtër për moshën e tij/saj dhe fazën e zhvillimit Nuk rritet siç duhet në rritje I keq ushqyer ose gjithmonë i uritur Higjienë e dobët ose mungesë e higjienës ditore, i pistë, vjen erë I veshur në mënyrë të papërshtatshme për motin, kushtet e shtëpisë apo aktivitetin Mungesë rrobash, këpucësh, xhupi Mungesë kujdesi mjekësor dhe ilaçesh nëse kërkohet Mungesë mbikëqyrjeje gjatë lojërave afër zjarrit të hapur, sobës me dru apo ujit, etj Fëmija nuk shkon në shkollë Fëmija nuk është i vaksinuar Mungesë kufijsh, rregullash shoqërore apo rutinash ditore I folur i vonuar Mungesë lojërash dhe nxitjesh Braktisje Punë të rëndë, punon në fushë ose në rrugë. 	<ul style="list-style-type: none"> Vjedh ose lyp për ushqim Shpesh e zë gjumi në shkollë Frekuentim i kufizuar apo i dobët i shkollë; vjen vonë dhe ikën shpejt Gjithmonë i lodhur Duket gjithmonë i trishtuar i vetmuar ose i mërzitur Vështirësi për të bërë dhe mbajtur shokë Heziton për të folur për familjen ose për të marrë shokë në shtëpi Probleme me sjelljen Kërkon shoqëri ose lëvdata nga të rriturit Probleme me ligjin Abuzon me droga ose me alkoolin Paaftësi për të mësuar Nevojë të papërshtatshme për vëmendje, shumë i ngjitur dhe preket shpejt Merr përsipër përgjegjësitë e të rriturve Mërmërit, rënkon ose këndon Gjendet në rrugë Sorollatet nëpër shkollë ose qendra të tjera Ka menduar ose tentuar vetëvrasje Sjellje regresive, të tilla si thithje gishti, ndotje dhe lagje shtrati. 	<ul style="list-style-type: none"> Prindi/kujdestari/i rrituri shfaq mospëlqim dhe mungesë emocionesh Përshkruan një jetë të rrëmujshme në shtëpi Prindi/kujdestari/i rrituri ka një sëmundje ose paaftësi kronike Prindi/kujdestari/i rrituri vuan nga depresioni ose kanë tentuar vetëvrasje Tregon nivel të ulët motivimi për të ndryshuar gjërat në shtëpi ose në jetën e tij/saj Prindi/kujdestari/ i rrituri tregon pak mirëkuptim për nevojat e fëmijës ose si ai/ajo t'i përmbushin ato Vendos ndjenjat dhe nevojat e tij/saj përpara atyre të fëmijës Prindi/kujdestari/i rrituri ka pasur një fëmijëri të parregullt ose është neglizhuar në fëmijëri Vuan nga sëmundje mendore ose paaftësi mendore Abuzon me alkoolin ose drogën Prindi/kujdestari/i rrituri është i papunë dhe nuk ka burime zyrtare të ardhurash për të mbështetur kujdesin për fëmijën.

Tabela 3: Shenja të shkëmbyera për keqtrajtime

Situata/shkaku	Indikator fizik
Njolla mongoloide (Mongolian Spots)	Shenja të dukshme në kurriz dhe në të ndenjura
Shenja postmortem	Shenja ngjyre mavi në zonat më të dala të trupit (si kurrizi, të ndenjurat, kaviliet)



<i>pre-dispozita të daljes lehtë të shenjave</i>	
Emofilia	Zona të ndryshme të trupit me enë gjaku të çara/prishura në faza të ndryshme shërimi
Mungese e vitaminës K	Hemorragji të brendshme ose nën lëkurë
Leucemia	Zona me enë gjaku të prishura, shenja shembjesh, vdekje të fëmijës.
Sëmundja Henoch-Schonlein	Njolla në ngjyrë të purpurt në zona të ndryshme të trupit si fytyrë, sy, krahë e këmbë.
Koagulim intravaskular i shpërndarë, meningjit	Shenja të shumfishta, vdekje të fëmijës.
Eriteme multiform	Shenja e njolla me ngjyrë të purpurt në zona të ndryshme të trupit
Sindroma Ehlers-Danlos	Shenja, plagë të hapura në kokë, gjunjë, bryll apo në mjekër
<i>Djegje e shenja të ngjashme me djegiet</i>	
Epidermoliz me flucka	Veshika/flucka në zonat nën sforzo
Impetigine	Veshika të ngjashme me djegiet nga cigaria
Diegie nga karrigia e posaçme për fëmijë që vendoset në makinë	Shenja djegie të grades së parë e të dytë në kurriz, qafë dhe/ose ekstremitete
Ngrrirja	Djegje lineare në zonat e lagështa si faqe, mjekër, buzë dhe pjesa ku mbarojnë së mbuluarit dorezat dhe çorapet
Pandjeshmëri e lindur ndaj dhimbjes	Shenja të shumta prerjeje, shenja përplasjeje, djegie të fundit apo të hershme.
Tumor apo neurizëm i trurit	Sindroma e " Shkundjes" së foshnjës
Osteogenezë imperfekte	Fraktura të shumfishta të pashpjegueshme
Ipogamaglobulinemia ose Fibroza cistike	Pamjaftueshmëri në rritje
Flokë si rrypa emostatike	Fryrje dhe skuqje të gishtave të këmbës o të penisit
<i>Alterime gjenetike</i>	
Ç'rregullim mitokondrial, iperplasi e lindur e gjendrave surrenale tek meshkujt, diabet i fshehur	Me shume raste të sindromës së vdekjes foshnjore të papritur, dehidratim i rëndë, rritje e pamjaftueshme
Sifilis e lindur	Fraktura .



Mungesë e hekurit	Anormalitete të shumëllojshme kockore
Mungesë të vitaminave C ose D	Fraktura, mutacione të tesutit kockor
Sëmundja e CAFFEY	Fryrje të gjymtyrëve inferior
Fraktura të fëmijëve që nisin të ecin	Fraktura të kavigjës tek fëmijet që nisin të bëjnë hapat e para
Fraktura nga ushtrimi pasiv	Fraktura nga stresi të eshtrave të gjata të ndeshura në të sëmurët me paralizë cerebrale kur i janë nështruar terapisë fizike
<i>Plagë të vetshkaktuara</i>	
Sindroma Cordelia De Lange, sindroma Lesch-Nyhan, fëmijë që përplasnin kokën	Plagë të ndryshme në lëkurë, kafshime, djegie dhe shenja

SHKAQET E ABUZIMIT NDAJ FËMIJËVE

Abuzimi ndaj fëmijës ekziston në të gjitha shoqëritë. Bazat ose arsytet se përse ai vazhdon të shfaqet, janë të ndërlikuar dhe lidhen me një numër faktorësh. Shkaqet e abuzimit ndaj fëmijës mund të vijnë nga katër nivele të ndryshme, por të ndërlidhur me njëri-tjetrin¹ :

a) Niveli Individual

Përvojat traumatike gjatë fëmijërisë ose vështirësitë në jetën e tyre si të rritur (për shembull probleme me drogën, abuzimin me alkoolin, varfërinë ose sëmundjet) mund të kenë ndikim tek aftësitë e prindit për të përmbushur nevojat e fëmijëve dhe për të respektuar të drejtat e tyre. Fëmijët me aftësi të kufizuara, janë më vulnerabel ndaj abuzimit. Fëmijë të tjerë si për shembull ata që janë abuzuar tashmë-pjesërisht si rezultat i shfrytëzimit –kanë shumë gjasa të abuzohen përsëri pasi ata në mënyrë të pashmangshme mund ta vendosin veten e tyre në një situatë rreziku (ata mund të jenë më pak të ndjeshëm ose e shohin këtë eksperiencë si të ishte “normale”). Moshja e fëmijës përbën gjithashtu një faktor kritik pasi fëmijët e vegjël varen më tepër nga të rriturit për të përmbushur nevojat e tyre.

Për fëmijët me aftësi të kufizuara treguesit e abuzimit mund të maskohen ose të ngatërrohen me aftësitë e tyre të kufizuara. Për më tepër fëmijët me aftësi të kufizuara janë më pak në gjendje të kërkojnë ndihmë ose për t'i thënë dikujt se çfarë po u ndodh atyre. Nivelet e përkujdesjes të cilat janë të përshtatshme për fëmijët që nuk kanë aftësi të kufizuara, mund të jenë të rrezikshme për një fëmijë me aftësi të kufizuara – për shembull nëse prindi/kujdestari nuk ushqen një fëmijë i cili nuk mund të ushqejë veten, do të rezultojë në vdekjen e tij/saj të pashmangshme. Stresi i shtuar për përkujdesjen që duhet t'i ofrohet një fëmijë me aftësi të kufizuara gjatë një periudhe afatgjatë, mund të çojë drejt abuzimit nga prindi/kujdestarët.

b) Niveli Familjar

Shumë aspekte të ndërveprimeve familjare, konfliktet dhe tensionet mund të çojnë në abuzimin e fëmijëve. Nivelet e larta të stresit, abuzimi me substancat, dhuna familjare dhe problemet e shëndetit mendor janë shembuj të faktorëve të stresit, të cilët mund të rrisin rrezikun e abuzimit nëse nuk ekzistojnë faktorë mbrojtës për të

¹ Përshtatur nga Raporti i Konsultimit për Parandalimin e Abuzimit të Fëmijëve, OBSH 1999



neutralizuar rrezikun dhe për të nxitur ndërveprimet pozitive familjare. Rolet e ngurta gjinore janë faktorë që ndikojnë në dhunën ndaj grave dhe fëmijëve.

c) Niveli Komunitar & Shoqëror

Përsëri mendësitë e ngurta dhe të shprehura gjerësisht mbi rolet gjinore mund të ndikojnë në abuzimin e fëmijëve. Gjithashtu shkas mund të jenë edhe qasjet apo mendësitë e pranishme brenda komunitetit, për shembull trajtimi i fëmijës si një “pronë” e prindërve të tyre, dhe jo si një individ.

Përdorimi i gjerë i ndëshkimit të ashpër fizik dhe nivelet e larta të dhunës të pranura në komunitet, janë të lidhura me nivelet më të larta të abuzimit. Varfëria, prania e armëve dhe e konflikteve, i vendosin fëmijët përballë rreziqeve të mëdha.

Faktorët kulturorë- si për shembull praktikatat dhe sjellje të caktuara të pranura tashmë për modelin e rritjes së fëmijës dhe qëndrimet për rolet gjinore – luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e rrezikut për abuzim dhe duhet të kuptohen qartë nga ana e profesionistëve.

Kjo nuk bëhet për të minimizuar nivelin e shqetësimeve apo për të justifikuar e falur abuzimin si një fenomen, por më tepër për të kuptuar mjedisin në të cilin ndodh. Kuptimi i këtij konteksti ndihmon për të siguruar nëse ndihma e ofruar ndaj fëmijëve është ajo e duhura.

Përmbledhje e faktorëve që ndikojnë abuzimin ndaj fëmijës

- ✓ izolimi shoqëror i familjes;
- ✓ mungesa e njohjes së nevojave të zhvillimit të fëmijës;
- ✓ aftësitë e kufizuara fizike ose mendore të fëmijës;
- ✓ prindër me të kaluar abuzuese;
- ✓ mungesë kohezioni ose mosfunksionim i marrëdhënieve brenda familjes;
- ✓ abuzimi me drogën/alkoolin nga prindi/ërit, kujdestari/ët;
- ✓ prindër të rinj me mbështetje të pakët;
- ✓ prind/kujdestar i vetëm me mbështetje të pakët;
- ✓ lidhje e dobët midis prindërve dhe fëmijës;
- ✓ pikëpamjet negative për fëmijën, fajësimi pa vend;
- ✓ nivel i lartë i stresit tek të rriturit;
- ✓ sëmundjet e shëndetit mendor tek prindërit, përfshirë depresionin;
- ✓ nivelet e larta të dhunës në komunitet;
- ✓ varfëria dhe situata të tjera të pafavorshme socio-ekonomike, si papunësia.



ANEKSI 2 – Formulari i Referimit për Mbrojtjen e Fëmijës

Për t'u përdorur kur bëhet një referim dhe duhet të plotësohet nga institucioni ose ofruesi i shërbimit i cili merr referimin, në lidhje me personin i cili bën referimin.

FORMULARI I REFERIMIT PËR MBROJTJEN E FËMIJËS		
Emri / Identiteti i Fëmijës:	Data e Lindjes:	Gjinia:
Emri & Adresa e Kujdestarit Parësor:	Vendndodhja e Fëmijës / Aty ku po Rri Fëmija:	
Shkolla:	Shërbime të Tjera në Kontakt me Fëmijën (p.sh. shëndetësia etj.)	
Të dhëna mbi Fëmijë të tjerë në Shtëpi:		
Historik i Shkurtër i Familjes (nëse dihet):		
Arsyet për Referim / Shqetësimi:		
Puna e Bërë / Shërbimet e Ofruara gjatë 7 Ditëve të Fundit:		
Emri & Detajet e Kontaktit të Personit që bën Referimin:	Emri & Detajet e Kontaktit të Personit që merr Referimin:	Data kur është bërë Referimi:

**PROCESVERBAL****PËR MARRJEN NË MBROJTJE TË FËMIJËS NË RREZIK TË MENJËHERSHËM**

Në _____, me datë _____, ne _____
(emër/mbiemër), punonjës policie pranë _____ (struktura), dhe
_____ (emër/mbiemër), punonjës _____ (funksioni)
pranë _____ (emërtimi i strukturës), në zbatim të Pikave 10 dhe 11,
kreu II, të VKM Nr. 265, “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit
të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve
në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”, dhe Udhëzimit Nr. _____, datë
_____.2015, “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në
ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për
mbrojtjen e fëmijës”, plotësojmë këtë procesverbal për konstatimin dhe marrjen në
mbrojtje të menjëhershme të fëmijës : _____, i biri/e bija e
_____ dhe _____ lindur më _____, në _____,
banues në adresën _____,
mbajtës i dokumentit identifikues (nëse ka) _____.

Më poshtë duhet të bëhet një përshkrim i shkurtër i situatës në të cilën është konstatuar fëmija, arsyet/shkaqet që çojnë në nevojën për marrje në mbrojtje të menjëhershme si dhe vendin ku do të akomodohej fëmija i marrë në mbrojtje.

Punonjësi i Policisë
(emër/ mbiemër/ firmë)

Punonjësi i NJMF/SHSSH
(emër/ mbiemër/ firmë)



ANEKS 3 - Kryerja e Procesit të Vlerësimit

Vlerësim i plotë hedh bazat për Planin Individual për Mbrojtjen e Fëmijës. Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi ndryshon nga hetimi i cili mund të ndërmerret nga policia lidhur me ndjekjen penale të abuzuesit. Vlerësimi përqendrohet kryesisht mbi nevojat e fëmijës, të familjes dhe mbi sigurinë e tyre.

Brenda vlerësimit plotë, mund të ndërmerren edhe vlerësime specifike – p.sh. një vlerësim mjekësor i veçantë për të identifikuar një çështje shëndetësore ose një vlerësim mbi zhvillimin e fëmijës, i cili mund të ndërmerret nga një psikolog.

Përpara se të nisë vlerësimi të plotë është mire që të organizohet një takim strategjik ndërmjet institucioneve apo organizatave të cilat kanë punuar me familjen apo kanë njohuri mbi familjen, në mënyrë që të planifikohet vlerësimi dhe të përcaktohen veprime kyçe lidhur me vlerësimin. Kjo është e rëndësishme sidomos kur rasti është kompleks ose kur që prej vlerësimit fillestar rezulton se fëmija ka nevojë për shërbime urgjente (p.sh. nëqoftëse një fëmijë është braktisur ata kanë nevojë për një vend të sigurt për të qëndruar). Edhe nëse janë ofruar ofruar shërbimet e emergjencës, është e rëndësishme që të ndërmerret një vlerësim i plotë pasi kjo do të sigurojë ofrimin e kujdesit të gjithanshëm për fëmijën.

Gjatë procesit të vlerësimit të plotë është mjaft e rëndësishme që të merret në konsideratë niveli i rrezikut në të cilin ndodhet fëmija. Në qoftë se kemi informacion që sugjeron se fëmija mund të jetë në rrezik të lartë ose të menjëhershëm, atëherë mund të nevojiten ndërhyrje të menjëhershme në mënyrë që të ofrohet siguria e fëmijës deri sa të përfundojë vlerësimi.

Fazat gjatë procesit të Vlerësimit

Të gjithë vlerësimet duhet të ndjekin të njëjtat faza:

- Faza e Parë – Planifikimi i Vlerësimit;
- Faza e Dytë – Mbledhja e Informacionit;
- Faza e Tretë – Verifikimi i Informacionit;
- Faza e Katërt – Analizimi i Informacionit (Dhënia kuptim e informacionit)

FAZA E PARË: PLANIFIKIMI I VLERËSIMIT – gjatë kësaj faze përcaktohet se cili është informacioni i nevojshëm, kush do ta mbledhë informacionin, ku dhe kur. Gjatë një rasti në rrezik të menjëhershëm, rrezik të lartë, ose kur situata është shumë komplekse, mund të jetë e nevojshme që të organizohet një takim i Pikave Fokale të Mbrojtjes së Fëmijëve të institucioneve dhe/ose organizatave të cilat kanë punuar me familjen apo kanë njohuri mbi familjen, në mënyrë që të planifikohet vlerësimi dhe të përcaktohen veprime kyçe lidhur me vlerësimin. Kjo është e rëndësishme sidomos kur rasti është kompleks ose kur që prej vlerësimit fillestar rezulton se fëmija ka nevojë për shërbime urgjente (p.sh. nëqoftëse një fëmijë është braktisur ata kanë nevojë për një vend të sigurt për të qëndruar). Edhe nëse janë ofruar shërbimet e emergjencës, është e rëndësishme që të ndërmerret një vlerësim i plotë pasi kjo do të sigurojë ofrimin e kujdesit të gjithanshëm për fëmijën.

FAZA E DYTË: MBLEDHJA E INFORMACIONIT – kjo fazë ka të bëjë me mbledhjen e të gjithë informacionit të duhur. Ka disa mënyra të ndryshme sesi mund të mblidhet informacioni:

- Kontrolli i informacionit të përfshirë në dosje, nga raportet e mëparshme;
- Intervista dhe takime me personat të cilët kanë punuar me familjen – si psh. mësues, mjekë ose OJF;
- Intervista me komunitetin ku gjendet fëmija apo familja;
- Intervista me anëtarët e familjes;



- Intervista me fëmijën;
- Vëzhgimet e marrëdhënieve familjare
- Vizitat në familje/shtëpi (për të vëzhguar dhe vlerësuar mjedisin familjar të fëmijës).


Konfidencialiteti është shumë i rëndësishëm. Personat që organizojnë vlerësimin nuk duhet të nxjerrin informacionin ose ta përgojnë atë!

FAZA E TRETË – VERIFIKIMI I INFORMACIONIT – Shpeshherë kur ndërmerret një vlerësim mund të dëgjohen histori / informacione të ndryshme. Është e rëndësishme që ky informacion të verifikohet edhe përmes personave të tjerë për t'u siguruar që është i saktë. Për shembull, në qoftë se prindi thotë se fëmija sillet gjithmonë keq do të ishte e dobishme që informacioni të kontrollohej me shkollën dhe me anëtarët e tjerë të familjes për të parë nëse edhe ata ndajnë të njëjtin mendim.

FAZA E KATËRT – ANALIZIMI I INFORMACIONIT – Faza përfundimtare e vlerësimit është analizimi. Kjo ka të bëjë me vlerësimin e të gjithë informacionit në mënyrë që të përcaktohet situata e fëmijës dhe niveli i rrezikut në të cilin ndodhet fëmija, në mënyrë që të përcaktohen në mënyrën e duhur dhe nevojat e fëmijës. Ndonjëherë është e vështirë që të analizohet informacioni dhe në këtë rast ky hap mund të shtyhet për fazën tjetër, atë të hartimit të Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës.

Dimensionet e Vlerësimit

Për të kuptuar një vlerësim të gjithanshëm duhet të merren në konsideratë një numër elementesh të cilët janë paraqitur në diagramin e mëposhtme:



Dimensionet gjatë Zhvillimit & Mirëqenies

Një element i rëndësishëm është mirëqenia e fëmijës. Për ta realizuar atë është e nevojshme që të merren në konsideratë nevojat e zhvillimit të fëmijëve pasi fëmijë të moshave të ndryshme kanë nevoja shumë të ndryshme. Kjo mund të arrihet duke marrë në konsideratë një numër dimensionesh të zhvillimit të fëmijës:

Mirëqenien Fizike dhe Mendore: Kjo ka të bëjë me rritjen dhe zhvillimin si edhe me shëndetin fizik dhe mendor. Për t'u zhvilluar fizikisht dhe mendërisht ndër të tjera fëmijët kanë nevojë për një dietë të përshtatshme dhe të ushqyeshme, për një vend të përshtatshëm për të jetuar, vaksinime dhe kontrole të zhvillimit të tyre. Fëmijët më të



ritur kanë nevojë për këshillime dhe informacione lidhur me çështjet shëndetësore, pirjen e duhanit, abuzimin e substancave, sjelljen seksuale dhe duhet të kenë akses ndaj shërbimeve të duhura shëndetësore.

Mirëqenia Emocionale dhe e Sjelljes: Kjo ka të bëjë me ndjenjat dhe veprimet e fëmijëve dhe përfshin aftësinë e tyre për t'iu përshtatur ndryshimit, për të menaxhuar stresin, për të shfaqur vetë-kontrollin, dhe për t'u sjellë në mënyra të përgjegjshme sociale. Këto emocione dhe sjellje ndikohen nga natyra dhe cilësia e marrëdhënieve të hershme të fëmijëve me familjen dhe kujdestarët e tyre dhe me mbështetjen dhe udhëzimet që fëmijët marrin ndërkohë që rriten.

Kapaciteti Mendor: Kjo ka të bëjë me zhvillimin njohës, arritjet arsimore dhe të mësuarit aktiv nga mjedisi i tyre. Zhvillimi i fëmijëve dhe rritja e kapaciteteve forcohen më tepër nga ofrimi i mundësive për shkollim, për të luajtur dhe për të ndërvepruar si me të rriturit ashtu edhe me fëmijët e tjerë, nëse ata kanë akses ndaj librave dhe simulimeve të tjera dhe nëse atyre u jepen mundësi për të fituar një numër aftësish. Ata të cilët shfaqin vështirësi në të mësuar mund të kenë nevojë për mbështetje të vazhdueshme në mënyrë që të sigurohemi që ata do të arrijnë zhvillimin dhe potencialin e tyre maksimal.

Mirëqenia Morale dhe Shpirtërore: Kjo ka të bëjë me ndjenjat, eksperiencat dhe besimin, të cilat stimulojnë ndjeshmërinë e fëmijës, rritjen e moralit dhe krijimin e ideve lidhur me kuptimin dhe natyrën e jetës dhe vdekjes. Për disa fëmijë kjo mund të mbështetet përmes traditave të besimit, të kulturës dhe përmes marrëdhënieve që kanë me familjen dhe anëtarët e komunitetit.

Identiteti: Kjo ka të bëjë me vetë-besimin e fëmijës, me nivelin e respektit dhe vlerësimit si edhe të pranimit nga familja dhe nga shoqëria. Për të pasur një identitet të fortë pozitiv, fëmijët kanë nevojë që arritjet e tyre të vlerësohen dhe inkurajohen dhe që të marrin mesazhe pozitive për aspekte të ndryshme të identitetit.

Përkujdesja ndaj Vetes: Kjo ka të bëjë me shprehitë dhe kompetencat për të cilat kanë nevojë fëmijët në mënyrë që të kujdesen dhe të respektojnë veten e tyre. Këto aftësi fillojnë të zhvillohen që në moshë të hershme psh. fëmijët e vegjël mund të mësojnë sesi të vishen dhe sesi të ushqehen vetë. Fëmijët më të rritur kanë nevojë për mundësi që të mësojnë për aftësitë e jetës të cilat mund t'i ndihmojnë ata për të promovuar zhvillimin e tyre dhe për t'i mbrojtur ata nga rreziqet.

Marrëdhëniet Familjare: Pasja e një jete familjare të qëndrueshme ku ekziston ndjenja e përkatësisë, dhe ku ofrohet një prindërim i përshtatshëm dhe dashuri së bashku me mundësi për të hulumtuar dhe zhvilluar pavarësinë, ndihmon në zhvillimin pozitiv të fëmijës dhe në pasjen e marrëdhënieve të forta familjare. Nga ana tjetër këto marrëdhënie janë të rëndësishme për fëmijët pasi ndihmojnë në zhvillimin e dimensioneve të tjera, si p.sh. në lidhje me mirëqenien emocionale dhe identitetin e tyre.

Që në moshë të hershme, por dhe më vonë ndërkohë që fëmijët rriten, ata gjithashtu fitojnë mundësi për të luajtur dhe për t'u socializuar me bashkëmoshatarët e tyre pasi kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë tek mënyra sesi fëmijët krijojnë lidhjet me botën e jashtme, dhe nga ana tjetër sesi ata ndihen për veten e tyre. Fëmijët gjithashtu mund të përfitojnë nga eksperiencat e tjera dhe nga aftësitë e të rriturve të cilët jetojnë në komunitetin e tyre.

Shfaqja Sociale: Kjo ka të bëjë me të kuptuarit që fëmijët kanë për aftësitë e tyre si dhe me pranimin e ndikimeve që kanë veprimet e tyre, shfaqjen dhe sjelljen ndaj të tjerëve. Kur prindërit dhe të rriturit e tjerë shfaqin një interes ndaj fëmijëve, ata mësojnë se sjellja dhe pamja e jashtme mund të përshtaten në varësi të situatave të ndryshme dhe janë në gjendje të marrin vendime mbi mënyrën sesi ata duan të prezantohen. Kjo është një aftësi e rëndësishme zhvillimi për fëmijën në mënyrë që ata të mësojnë të përshtaten më mirë me mjedisin dhe komunitetin e tyre.

Detyrat e prindërimit dhe përkujdesjes duhet t'i përshtaten kapaciteteve zhvillimore të fëmijës gjatë periudhës së rritjes, ndërsa zhvillohen dhe bëhen më të pavarur, dhe duhet të marrin në konsideratë karakteristikat individuale të fëmijëve.

Marrëdhëniet Shoqërore dhe me Bashkëmoshatarët: Kjo lidhet me aftësinë e fëmijës për të pasur shokë dhe për t'u ndjerë pjesë e një grupi bashkëmoshatarësh dhe sesi ata lidhen me të rritur të tjerë të cilët nuk bëjnë pjesë në rrethin e tyre familjar. Që në moshë të hershme, por dhe më vonë ndërkohë që fëmijët rriten ata gjithashtu fitojnë



mundësi për të luajtur dhe për t'u socializuar me bashkëmoshatarët e tyre pasi kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë tek mënyra sesi fëmijët krijojnë lidhjet me botën e jashtme, dhe nga ana tjetër sesi ata ndihen për veten e tyre. Fëmijët gjithashtu mund të përfitojnë nga eksperiencat e tjera dhe nga aftësitë e të rriturve të cilët jetojnë në komunitetin e tyre.

Etapat e Zhvillimit

Ndërkohë që çdo fëmijë është një individ më vete dhe arrin zhvillimin në mosha që janë pakëz të ndryshme, pjesa më e madhe e fëmijëve zakonisht arrijnë disa faza kyçe të zhvillimit në mosha të ngjashme. Shpeshherë këtyre i referohemi si etapat e zhvillimit. Megjithatë nuk përbën problematikë arrija e disa etapave të zhvillimit me një vonesë prej disa muajsh, evidentimi i mungesës së disa etapave të zhvillimit mund të jetë një tregues që kemi të bëjmë me një problematikë. Në këto raste mund të dyshohet se fëmija ka nevoja të veçanta dhe i nevojitet mbështetje shtesë, ose se fëmija po abuzohet / neglizhohet dhe dështimi për përmbushjen e etapave të zhvillimit përbën një simptomë.

Etapat kyçe të zhvillimit:

Mosha e mitur – nga lindja deri në 2 vjeç

- Shfaq buzëqeshje sociale
- Rrotullon veten
- I aftë të qëndrojë vetëm, pa mbështetje
- Belbëzon
- Dalja e dhëmbit të parë
- E ngre veten në pozicion qëndrimi
- Ecën ndërkohë që mbahet diku (p.sh. dora)
- Thotë mama dhe baba duke përdorur termat në mënyrën e duhur
- Është në gjendje të pijë nga një gotë
- Kupton “JO” dhe reagon duke ndaluar veprimin
- Ecën pa mbështetje
- Përdor deri në 8 fjalë dhe kupton komandat e thjeshta
- Fillon të përpiqet të ushqehet vetë
- Përmend emrat e objekteve të njohura në fotografi dhe tregon me gisht pjesët e trupit
- Imiton fjalët e të tjerëve, duke përsëritur fjalët
- Është në gjendje të thotë emrin

Fëmijëria e hershme - 3 – 6 vjeç

- Mëson që të luajë me radhë (nëse udhëzohet) ndërkohë që luan me fëmijë të tjerë
- I aftë të ushqehet me kujdes, duke e derdhur ushqimin pak fare
- I aftë të vrapojë, kthehet dhe të ecë mbrapsht
- I aftë të vizatojë një vijë (kur i tregohet)
- Njeh dhe thotë ngjyrat saktësisht (nëse ja kanë mësuar)
- Vishet vetë me vetëm pak ndihmë
- Mëson të ndajë me të tjerët (pa u udhëzuar nga adultët)
- I aftë të vizatojë një rreth
- I aftë të vizatojë njerëz dhe kafshë, përmes rrathëve dhe vijave, ngjit fotografi me figura, ku paraqiten 2 deri në 3 karakteristika të njerëzve
- Kërcen me një këmbë
- Kap topin kur i hidhet
- Kupton dallimet lidhur me konceptet e përmasave
- I pëlqejnë ritmet dhe të luajë me fjalët
- I pëlqen të bëjë shumicën e gjërave në mënyrë të pavarur, pa ndihmë
- Kupton konceptet e kohës
- Fillon të njohë fjalët e shkruara – fillojnë të shfaqet aftësitë për të lexuar



- Bën dallimet ndërmjet gjinive

Fëmijëria e mesme - 7 – 12 vjeç

- Kupton dhe është në gjendje të ndjekë drejtimet që kanë vazhdimësi
- Fillon shfaqjen e aftësive për sportet me ekipe (futboll, etj.)
- I bien dhëmbët e fëmijërisë dhe i dalin dhëmbët e përhershëm
- Veprimet e përhershme janë të rëndësishme për aktivitetet ditore
- Zhvillohen më tej aftësitë lexuese
- Njohja e bashkëmoshatarëve fillon të bëhet e rëndësishme
- Vajzave mund të fillojnë t'u shfaqen qime në sqetull dhe në zonën pubike, zhvillim i gjoksit
- Te vajzat mund të shfaqet perioda e parë menstruale

Adoleshenca - 13 - 18 vjeç

- Djemve fillojnë t'u shfaqen qime në sqetull, gjoks dhe në zonën pubike; ndryshime në zë; rritje të testikujve / rritje e penisit
- Vajzave fillojnë t'u shfaqen qime në sqetull dhe në zonën pubike; zhvillim i gjoksit; periudhat menstruale
- Arrihet gjatësia, pesha, pjekja seksuale adulte
- Kupton konceptet abstrakte
- Është e rëndësishme të pranuarit dhe njohja e bashkëmoshatarëve
- Bën plane konkrete për të ardhmen / jetën kur të rritet



ANEKSI 4 – Formulari i Vlerësimit dhe Analiza e Rrezikut

Ky formular duhet të përdoret për të regjistruar të gjithë informacionin e marrë përmes procesit të vlerësimit. Ai duhet të shpërndahet paraprakisht në Takimin e Grupit Teknik Multidisiplinar. Disa pjesë të formularit, si psh. nivelet e riskut, duhet të plotësohen në fund të takimit.

FORMULAR VLERËSIMI	
Emri i Fëmijës:	Referenca e Identitetit:
Mosha / Data e Lindjes:	Gjinia:
Data kur është plotësuar Vlerësimi:	Vlerësimi është bërë nga:
Përbërja Familjare / Anëtarët e Familjes:	Adresa e Familjes:
Shërbimet / Agjencitë në kontakt me Fëmijën:	Shkolla:
ARSYEJA PËRSE ËSHTË BËRË REFERIMI	
Sfondi Familjar / Përmbledhje e Historive të Fundit / Ngjarje Kritike:	
Zhvillimi & Mirëqenia e Fëmijës (fizike, emocionale, njohëse, shpirtërore etj dhe çdo nevojë tjetër e veçantë - p.sh. aftësia e kufizuar):	



Prezantimi & Marrëdhënia e Fëmijës me të Tjerët (përfshirë familjen & miqtë):

Arsimimi:

Kapaciteti i Prindërimit & Aftësia për ta përballuar:

Funksionet Familjare (Marrëdhëniet & Dinamikat):

Kushtet e jetesës & Situata Ekonomike / Punësimit:

Mbështetje nga Familja / Komuniteti i Gjerë:

Histori të Mëparshme Abuzimi:



Nëse referimi është bërë lidhur me incidente specifike abuzimi, cili është rezultati i hetimi (nëse është përfunduar)

RISQET DHE RREZIQE PËR FËMIJËN:

Opinionet e Prindërve / Kujdestarëve:

Këndvështrimet / Dëshirat e Fëmijës:

Burime Shtesë / Mbështetja e Disponueshme:

Pikat e forta të Fëmijës dhe Familjes:

Çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje:

ANEKS 4(b) - ANALIZA E RREZIKUT

Pasi është përfunduar vlerësimi është e rëndësishme të vlerësohet niveli i rrezikut.

Në këtë moment duke pasur informacione shtesë, është e mundur që të jemi më të saktë në vlerësimin e nivelit të rrezikut. Është e rëndësishme të përcaktohet niveli i rrezikut duke qenë se kuptimi i nivelit të rrezikut përbën bazën për zhvillimin e një plani i cili do ta mbrojë fëmijën dhe do të promovojë mirëqenien e tij.



Grupe të caktuara fëmijësh mund të quhen “vulnerabël” ose “në rrezik për abuzim”. Në kontekstin e këtij Udhëzimi, rreziku nuk është i njëjtë me vulnerabilitetin. Në Udhëzim, kur flitet për “nivelin e rrezikut” kjo lidhet me nivelin e abuzimit që ka pësuar (apo mund të pësojë) fëmija dhe me rrezikun që ky abuzim do të dëmtojë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës. Vulnerabiliteti i referohet fëmijëve në nevojë, të cilëve nuk i plotësohen të gjitha nevojat, por që nuk janë në rrezik mbijetese. Gjithsesi në një perspektivë afatgjatë, vulnerabiliteti ndikon gjithashtu negativisht në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Ndërkohë që veprime si përdhunimi janë natyrisht raste të qarta abuzimi, ka edhe situata të tjera të cilat janë më të vështira për t'u vlerësuar. Për shembull, përkufizimi i saktë i termit abuzim psikologjik (emocional) është disi problematik pasi kërkon një vlerësim të kujdesshëm të vetë veprimit në lidhje me cilësinë dhe natyrën e marrëdhënies midis fëmijës dhe abuzuesit. Në këtë mënyrë një prej përcaktuesve kyç në përkufizimin e abuzimit është kuptimi që merr për fëmijën, pra pasoja në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë.

Për këtë arsye koncepti i kufirit është i dobishëm. Kjo do të thotë se një veprim (ose veprime) mund të konsiderohen si abuzuese kur ka pasur ose kur ka predispozitë të krijojë dëm të madh ndaj zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës. Kjo kërkon një vlerësim të kujdesshëm të fëmijës, duke marrë në konsideratë nevojat e tij të zhvillimit.

Janë identifikuar katër nivele rreziku (ose kufij rreziku) – i ulët, i mesëm, i lartë dhe i menjëhershëm. Përcaktimi i nivelit të rrezikut kërkon vlerësim të kujdesshëm, megjithatë në mënyrë të përgjithshme, faktorët të cilët kanë tendencë të shfaqen në një nivel të caktuar rreziku, përfshijnë:

Tabela e mëposhtme ofron udhëzime të vlerësimit të nivelit të rrezikut.

Të gjitha rastet kur fëmija gjendet para një situatë kërcënuese për jetën, kur fëmija mund të dëmtohet apo gjymtohet rëndë, duhet të konsiderohen si Rrezik i Menjëhershëm.

Në varësi të ngarkesës së punës dhe numrit të rasteve të identifikuara, NJMF duhet t'i japë përparësi menaxhimit të rasteve të konsideruara “rrezik i menjëhershëm” dhe “rrezik i lartë”.

Faktorët ndikojnë që	Rrezik i Ulët	Rrezik i Mesëm	Rrezik i Lartë
Mosha e fëmijës dhe kapaciteti mbrojtës	Fëmija është mbi 10 vjeç; fëmija nuk ka nevojë, ose ka shumë pak nevojë për përkujdesjen dhe mbështetjen e një të rrituri, në mënyrë që të mbrojë veten. Nuk ka paaftësi fizike ose zhvillimore.	Fëmija është 5-9 vjeç; në këtë moshë fëmija ka nevojë për ndihmën e një të rrituri në mënyrë që ta mbrojë osë të përkujdeset për atë; fëmijë introvers; sëmuret shpesh, problematika të mëdha të zhvillimit fizik dhe mendor; ka një paaftësi të lehtë ose të moderuar.	Fëmija është nën 5 vjeç; në këtë moshë fëmija varet tërësisht nga një i rritur për përkujdesje dhe mbrojtje; sëmuret shumë shpesh, problematika shumë të mëdha të zhvillimit fizik dhe mendor; Fëmijë me probleme sjelljeje shumë të mëdha.



Niveli i Abuzimit Seksual / Fizik	Nuk ka dëmtim ose ka dëmtim të lehtë; nuk është e nevojshme të merrret trajtim mjekësor; nuk kanë ndikim të dukshëm mbi fëmijën; incident i izoluar	Plagosje e lehtë fizike ose të pashpjegueshme; ka nevojë për përkujdesje mjekësore ose diagnostikim; familja njihet për disiplinë të fortë, abuzim seksual pa kontakt	Ka nevojë të shkojë në spital ose të shtrohet në spital; familja njihet për disiplinë ekstreme ose mund të njihet për ngacmime seksuale
Pjesët e plagosura	Gjunjtë, duart ose vithet	Busti	Koka, fytyra ose organet riprodhuese
Niveli i neglizhimit	Nuk kanë ndikim të dukshëm mbi fëmijën; incident i izoluar	Shqetësim që Prindi/Kujdestari nuk mund të përmbushë nevojat bazë mjekësore, ushqyerjen, strehimin; me raste e lë fëmijën të pambikëqyrrur	Prindi/Kujdestari nuk ka predispozitën që t'i ofrojë fëmijës kujdes mjekësor, ushqim ose strehim; shpeshherë fëmija lihet i pambikëqyrrur
Histori të mëparshme mbi abuzimin / neglizhimin	Nuk ka histori abuzimi ose neglizhimi	Raportet e mëparshme shfaqin problematika; në të shkuarën është ofruar shërbim mbrojtjeje	I panjohur; raportet e mëparshme shprehen se ka pasur abuzim të madh ose të fortë
Mundësia që abuzuesi të kontaktojë fëmijën	Nuk ka – është larguar nga shtëpia / zona dhe nuk mund të kontaktojë fëmijën	Abuzuesi është akoma në shtëpi / zonën por ka një prind tjetër, apo të rritur i cili mund të mbrojë fëmijën dhe fëmija nuk lihet vetëm	Abuzuesi jeton në shtëpi dhe kontakton me fëmijën lehtësisht; nuk ka mundësi për të konfirmuar nëse të rritur të tjerë kanë mundësi të mbrojnë fëmijën
Aftësitë e prindërimit, kapaciteti emocional dhe fizik i Prindit/Kujdestarit	Nuk ka dëmtim intelektual ose fizik; pritshtëri të pranueshme për fëmijën; aftësi të plotë për të kontrolluar veten e tij / saj; emocionet / sjelljen; aftësi prindërimi të përshtatshme dhe njohin përgjegjësitë e tyre	Shfaq disa probleme të zhvillimit mendor, probleme shëndetësore, ka nevojë për planifikim dhe mbështetje për tu përkujdesur për fëmijën; cilësia e paqëndrueshme ose shumë e ulët e përkujdesjes; përdorimi i substancave (p.sh. drogë dhe alkool) zakonisht ndikojnë mbi aftësinë e prindërimit	Aftësi e kufizuar e rëndë / dëmtim njohës; mungesë e perceptimit real mbi realitetin; pritshtëri ose perceptime jorealiste lidhur me sjelljen e fëmijës; aftësi prindërimi të ulët / ose mungon fare; abuzim me substanca të cilat shpeshherë ndikojnë mbi aftësinë e prindërimit



Disponueshmëria e kujdestarëve të tjerë	Dikush i cili është gati dhe në gjendje të marrë rolin e kujdestarit dhe i cili është në gjendje të ofrojë mbështetje dhe stabilitet	Dikush në familje mund të marrë përsipër rolin e kujdestarit kryesor por ata mbase nuk mund të jenë gjithmonë në shtëpi ose mund të përmbushin vetëm kërkesat bazë të përkujdesjes ndaj fëmijës ose ka nevojë për mbështetje shtesë	Nuk ka ndonjë të rritur të përshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijën; i rrituri nuk ka dëshirë / mundësi ose mund të përbëjë rrezik për fëmijën
Sistemet e mbështetjes së familjes	Anëtarët e familjes, fqinjët ose miqtë premtajnë të ofrojnë mbështetje për fëmijën; familja është e përfshirë në aktivitete komunitare	Familja dhe fqinjët mund të ofrojnë mbështetje por kjo është e kufizuar	Nuk ka mbështetje familjare ose komunitare; familja dhe miqtë nuk kontribuojnë për problemin; familja jeton në zona të thella dhe janë të izoluar; familja nuk ka telefon ose mjete komunikimi
Mjedisi ku jeton familja	Shtëpia është e pastër dhe nuk ka / ka pak rreziqe sigurie ose shëndetësore	Ka mbeturina dhe materiale të tjera të papastra; nuk ka ujë / energji elektrike; ka milingona, buburreca etj.	Familja jeton në një zonë të thellë ose në një banesë të papërshtatshme
Stresi në familje / faktorë të tjerë rreziku	Familje, punë dhe të ardhura të qëndrueshme; marrëdhënie të ngushta me të afërmit	Shtatzëni ose fëmijë i porsalindur; nuk ka të ardhura ose ushqim të mjaftueshëm; familjes i mungojnë aftësitë për të menaxhuar çështjet familjare; ka konflikt në marrëdhënie me të afërmit	Bashkëshorti / bashkëshortja ka vdekur / është larguar ose ka pasur ndryshim në statusin martesor; konflikt martesor; dhunë në familje

Lista e Faktorit të Rrezikut

Ky formular mund të përdoret për të regjistruar rreziqet, si pjesë e vlerësimit, dhe për të ndihmuar në analizimin dhe fazat e marrjes së vendimit gjatë procesit të vlerësimit. Nuk është i detyrueshëm përdorimi i këtij formulari, por mund të shërbejë si një mjet i dobishëm.

Faktorët e Identifikuar të Rrezikut



FËMIJA			
Abuzimi/Dhuna			
Fizike	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> abuzim i konfirmuar	<input type="checkbox"/> në rrezik
	<input type="checkbox"/> i dokumentuar	<input type="checkbox"/> në familje	<input type="checkbox"/> nga i huaj
	<input type="checkbox"/> në institucion		
Seksuale	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> i konfirmuar	<input type="checkbox"/> në rrezik
	<input type="checkbox"/> i dokumentuar	<input type="checkbox"/> në familje	<input type="checkbox"/> nga i huaj
	<input type="checkbox"/> në institucion		
Psikologjike/Emocionale	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> i konfirmuar	<input type="checkbox"/> në rrezik
	<input type="checkbox"/> i dokumentuar	<input type="checkbox"/> në familje	<input type="checkbox"/> nga i huaj
	<input type="checkbox"/> në institucion		
Neglizhimi	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> i konfirmuar	<input type="checkbox"/> në rrezik
	<input type="checkbox"/> i dokumentuar	<input type="checkbox"/> në familje	<input type="checkbox"/> nga i huaj
	<input type="checkbox"/> në institucion		
Situata Shoqërore	<input type="checkbox"/> punë joformale	<input type="checkbox"/> e dëmshme	<input type="checkbox"/> në rrezik shfrytëzimi
	<input type="checkbox"/> punon në biznesin e familjes _____	<input type="checkbox"/> shëgert	<input type="checkbox"/> numri i orëve të punës në javë
Arsimimi	<input type="checkbox"/> shkon rregullisht	<input type="checkbox"/> frekuentim i çrregullt	<input type="checkbox"/> mungesa të shpeshta
	<input type="checkbox"/> nuk ka shkuar asnjëherë në shkollë	<input type="checkbox"/> e ka lënë shkollën	<input type="checkbox"/> analfabet
	<input type="checkbox"/> pjesërisht analfabet		
Mbarëvajtja në shkollë	<input type="checkbox"/> arritje të mira akademike	<input type="checkbox"/> arritje mesatare	<input type="checkbox"/> nivel i dobët arritjesh



	<input type="checkbox"/> përparim i çrregullt		
Trajnimi Profesional	<input type="checkbox"/> skemë e qeverisë	<input type="checkbox"/> kurs nga OJF-të	<input type="checkbox"/> pret për një vend
	<input type="checkbox"/> nuk ka kurse të përshtatshme ekzistuese		
Trafikimi	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> në rrezik	<input type="checkbox"/> i trafikuar më parë
	<input type="checkbox"/> i kthyer në familje më parë	<input type="checkbox"/> anëtarët e përfshirë të familjes	<input type="checkbox"/> palët e treta të angazhuara
	<input type="checkbox"/> hetim nga policia		
Të Miturit e pashoqëruar	<input type="checkbox"/> nga jashtë	<input type="checkbox"/> brenda Shqipërisë	
Migrimi	<input type="checkbox"/> nga jashtë	<input type="checkbox"/> brenda Shqipërisë	<input type="checkbox"/> i peregjistruar në vendndodhjen aktuale
Abuzimi i Alkoolit/Drogës ose Substancave	<input type="checkbox"/> çfarë substance?	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> përdorues i konfirmuar
	<input type="checkbox"/> shpeshtësi apo nivel përdorimi		
SHËNDETI			
Fizik	<input type="checkbox"/> i shëndetshëm	<input type="checkbox"/> të prera, të nxira të dukshme	<input type="checkbox"/> gjymtyrë ose kocka të thyera
	<input type="checkbox"/> probleme me zemrën	<input type="checkbox"/> diabet	<input type="checkbox"/> azëm
	<input type="checkbox"/> gjendje kronike	<input type="checkbox"/> merr ilaçe rregullisht	<input type="checkbox"/> i paekzaminuar
Mendor	<input type="checkbox"/> nuk ka probleme	<input type="checkbox"/> i paekzaminuar	<input type="checkbox"/> çrregullim i shëndetit mendor – gjendja, lloji
Aftësitë e Kufizuara	<input type="checkbox"/> fizike	<input type="checkbox"/> probleme dëgjimi	<input type="checkbox"/> probleme shikimi
	<input type="checkbox"/> probleme me të mësuarin - lloji	<input type="checkbox"/> lëvizshmëri – e pavarur	<input type="checkbox"/> lëvizshmëri – ka nevojë për ndihmë me nevojat e përditshme të jetesës
Çështjet Psikologjike			



Sjellja	<input type="checkbox"/> agresive	<input type="checkbox"/> i tërhequr	<input type="checkbox"/> hiperaktive
	<input type="checkbox"/> largohet nga shtëpia ose shkolla	<input type="checkbox"/> i shkakton dëm vetes	
Emocionale	<input type="checkbox"/> ankth	<input type="checkbox"/> ka frikë (nga çfarë)	<input type="checkbox"/> xheloz
	<input type="checkbox"/> mungesë vlerësimi për veten	<input type="checkbox"/> i trishtuar/me depresion <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/> lag ose ndot shtratin
	<input type="checkbox"/> çrregullime në ngrënie	<input type="checkbox"/> çrregullime gjumi	<input type="checkbox"/> përqendrim i dobët apo i kufizuar
Trauma	<input type="checkbox"/> pikëllim nga humbja	<input type="checkbox"/> aksident madhor	<input type="checkbox"/> fatkeqësi natyrore
	<input type="checkbox"/> fillim i aftësisë së kufizuar		
Faktorë të Tjerë Zhvillimi			
	<input type="checkbox"/> zhvillim në shkallë mesatare për moshën	<input type="checkbox"/> vonesë në të folur	<input type="checkbox"/> vonesë në zhvillimin fizik
Marrëdhëniet Mësues-Nxënës	<input type="checkbox"/> të mira	<input type="checkbox"/> fushat e konfliktit - llojet	<input type="checkbox"/> diskriminim
	<input type="checkbox"/> dhunë fizike	<input type="checkbox"/> abuzim emocional	
Marrëdhëniet shokë me shokë	<input type="checkbox"/> i detyruar nga “të fortët”	<input type="checkbox"/> dhunë fizike	<input type="checkbox"/> kërcënime si fizike ashtu dhe/ose psikologjike
	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> i konfirmuar	<input type="checkbox"/> në rrezik
FAMILJA			
Prindërit / Kujdestarët	<input type="checkbox"/> të martuar dhe jetojnë bashkë	<input type="checkbox"/> të ndarë	<input type="checkbox"/> duke u divorcuar
	<input type="checkbox"/> të divorcuar	<input type="checkbox"/> [prind] i vetëm	<input type="checkbox"/> i/e ve
	<input type="checkbox"/> një nga prindërit ka	<input type="checkbox"/> të dy prindërit	<input type="checkbox"/> mama dhe njeri



	vdekur	kanë vdekur	
	<input type="checkbox"/> baba dhe njerë	<input type="checkbox"/> kushërinj të tjerë –marrëdhënia	
Motrat dhe vëllezërit	<input type="checkbox"/> fëmijë i vetëm	<input type="checkbox"/> fëmija më i madh	<input type="checkbox"/> fëmija më i vogël
	<input type="checkbox"/> vëllezër, sa?	<input type="checkbox"/> motra, sa?	<input type="checkbox"/> fëmijë të tjerë që jetojnë në familje – marrëdhënia
	<input type="checkbox"/> të adoptuar	<input type="checkbox"/> birësuar	
Shëndeti	<input type="checkbox"/> prindërit kanë sëmundje mendore	<input type="checkbox"/> të dy apo njëri nga prindërit kanë një aftësi të kufizuar fizike ose të mësuari	<input type="checkbox"/> të dy apo njëri nga prindërit kanë një problem me alkoolin ose drogat
Dhuna në familje	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> nivel dhe shpeshtësi e lartë	<input type="checkbox"/> raporte të policisë
	<input type="checkbox"/> trajtimit spitalor	<input type="checkbox"/> raportimi i dhunës i tërhequr	<input type="checkbox"/> në pritje akuze
Të ardhurat	<input type="checkbox"/> varfëri ekstreme	<input type="checkbox"/> varfëri afat-gjatë kronike	<input type="checkbox"/> marrin vetëm ndihmë ekonomike
	<input type="checkbox"/> mbështetur nga OJF-të	<input type="checkbox"/> lutet	<input type="checkbox"/> të ardhura nga familjarët jashtë vendit
	<input type="checkbox"/> mbajnë kafshë dhe rrisin kafshë		
Punësimi	<input type="checkbox"/> i rregullt	<input type="checkbox"/> i pjesëm	<input type="checkbox"/> rastësor/joformal
	<input type="checkbox"/> asnjë	<input type="checkbox"/> i rrituri ka një aftësi të kufizuar dhe nuk mund të punojë	<input type="checkbox"/> merr pension ose pension paaftësie
Strehimi	<input type="checkbox"/> shtëpi e sigurt	<input type="checkbox"/> me qira	<input type="checkbox"/> pa shtëpi
	<input type="checkbox"/> jeton në rrugë	<input type="checkbox"/> strehim i papërshtatshëm ose i pasigurt	<input type="checkbox"/> godinë me shumë njerëz



Hakmarrje gjakësie	<input type="checkbox"/> i ekspozuar ndaj gjakmarrjes	<input type="checkbox"/> i ngujuar	<input type="checkbox"/> të afërm të familjes së zgjeruar të përfshirë në gjakmarrje
	<input type="checkbox"/> fëmijë që nuk shkojnë në shkollë dhe nuk marrin kujdes shëndetësor		
Diskriminimi (etnik, gjinor, aftësitë e kufizuara)	<input type="checkbox"/> i dyshuar	<input type="checkbox"/> i konfirmuar	<input type="checkbox"/> në trezik
	<input type="checkbox"/> shumë i shpeshtë	<input type="checkbox"/> i kufizuar	
Burimet mjedisore ose komunitare			
Aktivitetet e kohës së lirë	<input type="checkbox"/> pranë shtëpisë së familjes	<input type="checkbox"/> jo të pranishme në komunitet	<input type="checkbox"/> prani e kufizuar
	<input type="checkbox"/> salla bilardoje	<input type="checkbox"/> kafene	<input type="checkbox"/> bibliotekë
	<input type="checkbox"/> fusha sportive	<input type="checkbox"/> qendra kulturore	<input type="checkbox"/> kinema
Rrjetet e besimit ose rrjetet e mbështetjes	<input type="checkbox"/> asnjë	<input type="checkbox"/> OJF	<input type="checkbox"/> kishë
	<input type="checkbox"/> xhami	<input type="checkbox"/> shoqata grash	<input type="checkbox"/> grupe të rinjsh

ANEKS 4(c) – Mënyra të Tjera për Mbledhjen e Informacionit

Përveç intervistimit të fëmijës dhe anëtarëve të familjes mund të përdoren gjithashtu një seri metodash të cilat janë më të thjeshta dhe përfshijnë fëmijën apo familjen për të marrë pjesë në procesin e vlerësimit. Dy metoda të tilla janë Ekohartat dhe Genogramat, të cilat janë praktike dhe për përdorimin e tyre nevojiten materiale të thjeshta. Këto metoda mund të përshtaten për përdorim si në rastin e një fëmije, të rrituri ose familjeje.

Genograma

Genograma përbën një mundësi për punonjësit dhe anëtarët e një familjeje të bashkëpunojnë në një aktivitet të përbashkët. PMF duhet të përpiqen të përfshijnë sa më shumë që të jetë e mundur në këtë aktivitet prindërit, fëmijët dhe anëtarë të tjerë të përshtatshëm të familjes (p.sh. gjyshërit). Qëllimi i aktivitetit është që të bëjë një vizatim të familjes, dhe të marrëdhënieve midis tyre (një lloj peme familjare). Kjo bëhet duke përdorur simbole të veçanta të cilët përfaqësojnë njerëz të ndryshëm dhe marrëdhënie. Është mirë të përdoret një fletë e madhe letre dhe lapsa me ngjyra të ndryshme.

Genogramat mund të bëhen për të përfshirë pjesë të ndryshme të familjes së zgjeruar, p.sh. fëmijët nga marrëdhëniet e mëparshme, kushërinjtë, burrat dhe gratë e reja. Në përgjithësi është me vlerë kur gjenograma mbulon të paktën tre breza, gjyshërit, prindërit dhe fëmijët. Puna mbi një gjenogramë krijon një mundësi për të diskutuar historinë e një familjeje në detaje dhe për të parë se si ndjehen anëtarët e familjes në lidhje me atë që ju ka ndodhur. Në Genogramë mund të shtohen detaje shtesë, si p.sh. vendet dhe ndodhitë e rëndësishme, p.sh. një aksident që krijon nevoja të veçanta për një person.

Puna mbi një gjenogramë është gjithashtu një mundësi për PMF që të vëzhgojë se si ndërveprojnë anëtarët e një familjeje me njëri tjetrin. Për shembull sa të hapur janë me njëri-tjetrin, sa mirë iu përgjigjen nevojave të njëri-tjetrit dhe sa dinë për njëri-tjetrin. Për shembull a del në pah ndonjë informacion që nuk është përmendur më parë në familje mbi një anëtar të familjes?

Nëse PMF nuk ka eksperiencë në vizatimin e gjenogramave, mund ta praktikojë këtë teknikë me kolegët duke marrë për shembull familjen e tij/saj.


Simbolet e Gjeneogramës



Simbolet e Gjeneogramës



Mashkull



Femër



I panjohur



Vdekje



Abort ose dështim




Lidhje afatgjatë, martuar ose jetojnë bashkë



Marrëdhënie afatshkurtër




Divorc



Ndarje

Një vizë me pika duhet të vizatohet rreth personave të cilët aktualisht jetojnë në të njëjtën shtëpi.

SHEMBULL I SHKURTËR





Ekohartat

Ekoharta është një përfaqësim vizual i familjes në lidhje me komunitetin. Ajo tregon lidhjet midis anëtarëve të familjes, njësisë familjare dhe sistemeve të jashtme të tilla si kopshtet, shkollat, sistemi shëndetësor, puna, aktivitetet dëfryese dhe komunitetin. Nëpërmjet ekohartës merret informacioni mbi kohën e duhur për të arritur tek pika e kujdesit shëndetësor, në shkollë, koha për bletjen e ushqimeve dhe të mirave të tjera për familjen, kujdesi për kafshët, aksesit në transport dhe siguria e familjes. Ekoharta është një tjetër mjet vlerësimi që ofron një pamje të prekshme dhe të qartë grafike të situatës së familjes.

Ekohartat përdorin simbole për të treguar, natyrën e marrëdhënieve midis familjeve dhe sistemeve të tjera. Ato gjithashtu tregojnë rrjedhën e energjisë, dhe si rezultat përpjekjet që bëjnë anëtarët e familjes si edhe frymën e familjes. Kur evidentohet një mungesë e madhe ekuilibri në këto marrëdhënie, ky fakt mund të përdoret nga PMF dhe familja për të përcaktuar disa mundësi për ndërhyrje.

Kur ndërtojmë një Ekohartë, elementi më i rëndësishëm është se të gjithë duhet të përfshihen në proces.

Zakonisht, një ekohartë mund të përdoret në situata ku punonjësi ka arsye të besojë se ka probleme në “përshtatjen” midis familjes dhe mjedisit. Në këtë aspekt, ekoharta mbase është një mjet i nevojshëm për PMF sidomos në hapat e parë të vlerësimit. Por me identifikimin e informacionit të ri ose kur familja është në gjendje të gjejë burime të reja, harta do të ndryshojë. Paraqitja e ndryshimeve mund të jetë një mënyrë e mirë për të përforcuar vlerësimin lidhur me ecurinë që ka pasur familja.

Udhëzimet e përdorimit të Ekohartës

- Vizatoni sistemin e familjes ose shtëpisë siç përcaktohet nga anëtari/ët e familjes, në një rreth të madh në qendër të hartës.
- Përdorni simbolet e Gjeneogramës për të përshkruar anëtarët e familjes. Tregoni lidhjet si në një pemë tradicionale të familjes ose në skemën gjenetike. .
- Plotësoni ose vizatoni rrethë për sistemet e tjera të mjedisit të familjes, por ndryshe nga Rrethët e Familjes, rrethët mund të jenë të çdo madhësie dhe madhësia nuk pasqyron rëndësinë. Disa nga sistemet dhe burimet më të përgjithshme të familjes janë: familjet e zgjeruara, pushimi, kujdesi shëndetësor dhe shkolla.
- Lidhni pikat ndërmjet familjes dhe sistemeve të ndryshme të mjedisit të tyre. Tregoni natyrën e lidhjeve sipas llojit të vijës që përdorni. Një vijë e trashë ose pa-ndërprerje tregon një lidhje të fortë ose të rëndësishme dhe një vijë me ndërprerje tregon një lidhje të tensionuar; shenjat me dhëmbëza përgjatë vijës tregojnë një marrëdhënie të stresuar ose me konflikte.
- Tregoni drejtimin e rrjedhjes së burimeve, energjisë, ose interesit duke vizatuar shigjeta përgjatë vijave lidhëse.


Lidhjet mund të vizatohen për familjen si një e plotë nëse kanë si synim të përshkruajnë sistemin e lidhjeve të plota të familjes me disa sisteme në mjedis. PMF mund të vizatojë lidhje të tjera midis një individi të veçantë në familje dhe një sistemi të jashtëm, ku personi është i vetmi anëtar i përfshirë ose janë të përfshirë anëtarë të ndryshëm të familjes me një sistem të jashtëm në mënyra të ndryshme. Një mënyrë e tillë paraqitje bën të mundur që harta të theksojë kontrastin se si anëtarë të ndryshëm të familjes janë të lidhur me sisteme të tjera.

Tradicionalisht një Ekohartë krijohet me letër dhe stilolaps por mund të krijohet me mjete të ndryshme ku përfshihen zare qelqi ose gurë të masave, ngjyrave dhe përbërjeve të ndryshme, kopsa, fotografi të anëtarëve të familjes ose vizatime.


ANEKS 4(d) – Harta e Trupit

Ju lutemi paraqisni detaje të plagosjeve, duke shënuar datën dhe orën dhe emrin e personit që plotëson hartën.

COMMON SITES FOR BRUISES



QUESTIONABLE SITES FOR BRUISES





ANEKSI 5 – Vizita në Shtëpi / Shqyrtimi i Fletës së Shënimeve

VIZITA NË SHTËPI / SHQYRTIM I FLETËS SË SHËNIMEVE				
<p><i>Ky formular është krijuar për të ndihmuar punonjësit në maksimizimin e përdorimit të vizitave në shtëpi duke ofruar një strukturë për mbledhjen e informacionit dhe për të reflektuar informacionin e marrë përmes vizitës në shtëpi dhe mbi mënyrën sesi kjo mund të ndikojë mbi mirëqenien / mbrojtjen e fëmijës.</i></p> <p><i>SHËNIM – Kur përmenden prindërit, zakonisht kjo i referohet atij që normalisht kujdeset rregullisht për fëmijën – psh. gjyshi / gjyshja.</i></p>				
DATA / ORA:	MBIEMRI I FAMILJES:		PUNONJËSI:	
Kush është i pranishëm:				
	Nuk ka shqetësim	Ka pak shqetësim	Ka shumë shqetësime	Komente / Shënime
Mjedisi Fizik				
A është e përshtatshme shtëpia? Për shembull ka hapësira të mjaftueshme? A ka ujë pa ndërprerje / tualet? A është mjaftueshëm e ngrohtë?				
A është shtëpia e pastër dhe e rregullt? A ka ndonjë tregues që mund të ketë rreziqe për shëndetin e fëmijës?				
A ka një vend të përshtatshëm për fëmijën ku të flejë?				
A ka rreziqe fizike të dukshme? Për shembull xhama, thika dhe objekte të mprehta që gjenden rrotull ose pranë një rrugë të ngarkuar?				
A ka lodra të disponueshme që përshtaten me moshën e fëmijës?				
Vëzhgimi & Sjellja e Fëmijës				
A është i veshur fëmija në mënyrën e duhur?				
A është i pastër fëmija?				



<i>Duke mbajtur parasysh moshën e fëmijës, a i përmbushin ata etapat e një zhvillimi normal?</i>				
<i>A është ndërveprimi i fëmijës me ju i përshtatshëm, duke mbajtur parasysh moshën e tyre?</i>				
<i>A është e folura dhe gjuha në përputhje me moshën e tyre?</i>				
<i>A luan fëmija / a e mbush kohën e tij / saj në mënyrën e duhur?</i>				
<i>A i ndjek fëmija udhëzimet / kërkesat?</i>				
<i>A ka shenja abuzimi si p.sh. nxirje ose dëmtime të pashpjegueshme?</i>				
<i>A ka ndonjë sjellje e cila mund të përbëjë shqetësim ose e cila mund të mos duket “normale”?</i>				
Ndërveprimi Prind—Fëmijë				
<i>A ka ndonjë veprim fizik / të përzemërt ndërmjet prindit dhe fëmijës?</i>				
<i>A bën prindi komente pozitive për fëmijën në prani të fëmijës?</i>				
<i>A është ndërveprimi prind—fëmijë udhëzues (kontrollues) apo ata i lenë fëmijës mundësi zgjedhjeje?</i>				
<i>A shihet prindi dhe fëmija në sy?</i>				
<i>A duket se ka një marrëdhënie të ngrohtë dhe të natyrshme ndërmjet prindit dhe fëmijës (apo fëmija duket i frikësuar / i kujdesur)?</i>				
<i>A duket i lumtur fëmija?</i>				
<i>A duket se ka një dallim të dukshëm në sjellje ose qëndrim ndaj fëmijëve të ndryshëm në familje?</i>				
<i>Nëse ka fëmijë të tjerë në shtëpi, a duket se marrëdhënia mes fëmijëve është e përshtatshme? Ndonjëri nga fëmijët a po dominon ose po ushtron bullizëm ndaj të tjerëve?</i>				
Prezantimi i Prindërve / Adultëve				



<i>A paraqet prindi pritsshmëri jorealiste për fëmijën / sjelljen e tyre?</i>				
<i>A flet prindi me negativitet për fëmijën / duket shumë kritik?</i>				
<i>A duket sikur prindi kontrollon tërësisht sjelljen e tyre ose a duken ata sikur janë nën ndikimin e drogës, alkoolit etj.?</i>				
<i>A ka ndonjë shenjë të dhunës në familje brenda familjes?</i>				
<i>A ka ndonjë shenjë ose a përmendet ndonjë vështirësi në marrëdhëniet ndërmjet adultëve në shtëpi?</i>				
<i>A përmend prindi ndonjë sjellje për kujdesin e fëmijës që mund të jetë shkak për një shqetësim? Për shembull ndëshkimi trupor.</i>				
<i>A ka ndonjë gjë të “çuditshme”, ose shqetësuese mbi sjelljen e prindërve që mund të sugjerojë praninë e problematikave të rëndësishme si p.sh. probleme me shëndetin mendor?</i>				
<i>A ishte prindi agresiv / mbrojtës gjatë vizitës?</i>				
PAS VIZITËS				
Cilat ishin dinamikat gjatë vizitës?				
A patët mundësi të flisnit me fëmijën në mënyrë individuale? Nëse po, a keni ndonjë element që do të donit ta trajtonit?				
A ka ndonjë çështje / problematikë që ka nevojë të ndiqet?				
Duke menduar për vizitën në shtëpi a jeni të shqetësuar për mirëqenien / sigurinë e fëmijës? A mendoni që ata janë përballë ndonjë risku? Nëse po, atëherë ju lutem përmendi përse.				



ANEKS 6 - INTERVISTIMI I FËMIJËS DHE ANËTARËVE TË FAMILJES

Intervistat me anëtarët e familjes dhe fëmijën përbëjnë një element të rëndësishëm të procesit të vlerësimit, sidomos kur vlerësimi vjen si rezultat i një referimi lidhur me një incident që ka të bëjë me marrjen në mbrojtje të fëmijës/ve (pra nuk ka të bëjë vetëm me shqetësime të përditshme lidhur me prindërimin ose mirëqenien e fëmijës).

Llojet e intervistave

Për të mbledhur informacion nga fëmijët dhe/ose të rriturit, mund të përdoren mënyra të ndryshme në varësi të informacionit i cili i nevojitet PMF. Zakonisht përdoren një grup metodash për të mbledhur informacionin e duhur për të plotësuar vlerësimin.

Me përjashtim të rasteve kur fëmija po intervistohet dhe është pjesë e një hetimi të policisë lidhur me veprime të presupozuara penale, Grupi Teknik Multidisiplinar duhet të vendosë se cili është personi më i përshtatshëm për të intervistuar fëmijën në mënyrë që fëmija të ndihet sa më mirë. Ky mund të jetë një punonjës pranë një institucioni rezidencial, OJF etj, pra një person të cilin fëmija e njeh tashmë. Në raste të tilla intervistuesi duhet të punojë nën drejtimin e PMF lidhur me qëllimin dhe natyrën e informacionit të nevojitur, ose PMF duhet të intervistojë fëmijën në prezencë të personit të njohur për fëmijën.

Intervista për Mbledhjen e Informacionit Bazë - mbledhja e informacionit bazë për fëmijën, familjen dhe shërbimet ose ndihmën profesionale që fëmija dhe/apo familja merr / ka marrë aktualisht. Për më tepër mund të zbulojë nëse ka pasur problematika ose pretendime në të shkuarën për fëmijën.

Intervista Informuese – identifikon nëse incidenti ose shqetësimi i raportuar ka pasur ndikim mbi shëndetin, sjelljen dhe mirëqenien e fëmijës dhe nëse është e nevojshme që të ndërhyjnë profesionistë të tjerë. Intervista Informative mund të bëhet me telefon me specialistët dhe organizatat e tjera që merren me kujdesin për fëmijët, specialistët e shëndetit ose duke folur direkt me fëmijën ose anëtarët e familjes.

PMF duke u bazuar në rastin individual, me qëllim që të mbledhë informacione mbi të tashmen dhe të kaluarën e fëmijës, motrat dhe vëllezërit e tij/saj dhe/apo anëtarët e familjes, mund të flasë me doktorin e familjes, mësuesin/en e fëmijës, psikologun e shkollës, punonjësën e rendit publik në zonën ku jeton fëmija dhe ofrues shërbimesh publike e privatë në komunitet, nëse familja është e njohur për ta, apo cdo person tjetër që mund të japë informacion mbi fëmijën apo familjen.

Intervista Kërkuese - përqendrohet në mbledhjen e informacionit dhe detajeve mbi abuzimin e supozuar/të ndodhur, rrezikun e dëmtimit ose shqetësimet për mirëqenien e fëmijës. Intervista kërkuese mund të bëhet me fëmijën dhe / ose me pjesëtarët të veçantë të familjes, megjithëse një fëmijë duhet gjithmonë të intervistohet pa prezencën e abuzuesit të dyshuar.

Në situata ku abuzimi ka shkaktuar trauma apo plagosje të rënda për fëmijën, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës duhet të informojë policinë dhe të kërkojë ndihmë mjekësore për fëmijën. Nëse masa e abuzimit fillimisht nuk është e njohur por PMF dyshon (bazuar mbi detajet e dhëna nga referuesi) që fëmija ka pësuar lëndim, ai/ajo duhet ta diskutojë situatën me policinë përpara se të zhvillojë intervistën, dhe në rrethana të tilla duhet të kërkohet ndihmë ligjore për t'u siguruar që çdo deklaratë është marrë ashtu siç duhet, sipas rregullit të mbledhjes së provave.

Për të mos i shkaktuar fëmijës trauma dhe ankth të mëtejshëm dhe më të madh, është e rëndësishme që fëmija të mos intervistohet në mënyrë të përsëritur mbi plagosjet apo abuzimin e tij/saj nga specialistë të ndryshëm.

Në rastet kur akuzat i referohen një abuzimi serioz fizik dhe/ose seksual, neglizhimit ose trafikimit, me qëllim që provat thelbësore të mos humbasin apo “dëmtohen” nga një numër i madh hetimesh dhe/ose kontrollesh të fëmijës, hetimi duhet të trajtohet nga policia dhe autoritetet e tjera shtetërore profesionale të përshtatshme.

Një **Hartë e Trupit** (e përfshirë në Shtojcë) duhet të përdoret për të regjistruar vendet dhe nivelin e dëmtimeve fizike si për shembull prerjet, gërvishtjet, djegiet dhe kockat e thyera. Zakonisht kjo duhet të plotësohet nga



punonjësit mjekësore gjatë procesit të vizitës. Përveç punonjësve të shëndetësisë, askujt nuk i lejohet të zhveshë fëmijën apo të kërkojë që ai/ajo t'i tregojë pjesët e mbuluara të trupit.

Për të mbledhur më shumë detaje mbi akuzat ose abuzimin që ka pësuar fëmija, PMF mund të kryejë Intervista Hetuese edhe me prindin/kujdestarin e fëmijës ose referuesin. Kur abuzimi fizik, seksual aktual ose trafikimi është i pretenduar, PMF duhet të jetë i kujdesshëm dhe duhet ta diskutojë situatën me policinë, të kërkojë ndihmë ligjore përpara se të intervistojë abuzuesit e supozuar.

Intervistat Sociale - zhvillohen në momente të ndryshme të ndërhyrjes dhe ndihmës që i jepet një fëmije dhe/ose familjes. Intervistat Sociale mund të përdoren në forma të ndryshme për të sqaruar, përcaktuar dhe trajtuar probleme që ndikojnë mbi fëmijën dhe/ose familjen. Dhënia e informacionit dhe këshillave për prindërit të cilët ndeshin vështirësi me arsimimin e fëmijës së tyre, apo këshilla mbi mënyrat pozitive të prindërimit janë shembuj të Intervistës Sociale.

AFTËSITË E INTERVISTIMIT DHE FORMAT E INTERVISTËS

Një nga aftësitë më të rëndësishme të intervistimit është “dëgjimi”. Aftësitë kyçe të dëgjimi përfshijnë:

- T'i krijosh mundësi dhe t'i ofrosh hapësirën personave për t'u shprehur lirshëm sesi ndihen / çfarë mendojnë ata
- Lejimi i “qetësisë” për t'i dhënë kohë të mendohet dhe të reflektojë
- Të mos ndërpresësh kur të tjerët janë duke folur
- Pranimi i mendimeve, opinioneve dhe ndjenjave të personave që intervistohen
- Të kërkohet për elementët që janë përmendur dhe që nuk janë përmendur dhe t'u jepet përgjigje
- Të kërkohet sqarim dhe shpjegim kur diçka nuk kuptohet
- “Të mos t'i thuhet” të tjerëve sesi ndihen dhe mendojnë ata, por t'i pyesin ata
- Të mos shfaqet i tronditur ose "gjykues" - por të pranojë atë që thonë të tjerët
- Të respektojë të tjerët
- Të jenë të qartë mbi atë që mund të ofrojnë / të bëjnë, dhe të mos bëjnë “premtime boshe” ose pohime të pavërteta
- Të jenë të qartë mbi pasojat, mbi atë që do të ndodhë në të ardhmen

Për më tepër ka një numër teknikash të cilat mund të përdoren për të inkurajuar komunikimin si për shembull:

Bërja e pyetjeve të hapura në vend të pyetjeve të mbyllura – Pyetje të cilave nuk mund t'u përgjigjesh thjesht me një po / jo / ose me vetëm një fjalë – për shembull, “Mund të më thuash çfarë ndodhi më vonë?” - inkurajo njerëzit të flasin

Reflektim - Të tregohet se çfarë është thënë, dëgjuar duke përsëritur atë që është thënë. Për shembull “Unë jam shumë i zënë dhe nuk kam asnjëherë kohë” – “Pra nuk ka asnjëherë kohë”

Sqarime - Pyetje dhe deklarata të cilat mund të ndihmojnë njerëzit për të sqaruar atë që ata mendojnë ose ndiejnë dhe për të kontrolluar si është kuptuar. Për shembull “Pra ti ishe më i zemëruar për shkak të X apo Y?”

Përmbledhje – Përmbledhni shkurtimisht atë që është thënë. Kjo është një teknikë që përdoret veçanërisht për t'i treguar njerëzve që ata janë dëgjuar dhe përdoret për të sqaruar që ajo që është thënë është kuptuar sidomos kur është dëgjuar një histori ose përgjigje e gjatë.

Kur komunikohet me fëmijët duhet të merret në konsideratë zhvillimi dhe mosha e fëmijës. Fëmijët më të vegjël ndonjëherë keqkuptojnë termat ose përdorin fjalë të ndryshme dhe mund të ngatërrohen lidhur me renditjen e ngjarjeve dhe kohën kur kanë ndodhur ato. Gjithashtu për arsye se fëmijët nuk e kuptojnë tërësisht rrethanën, ata ndonjëherë mund të shtojnë informacionin në mënyrë që të kuptohet se çfarë ka ndodhur.

Fëmijëve më të vegjël ju duket shumë e vështirë të rrinë ulur dhe të “intervistohen”. Ka mënyra të tjera përmes të cilave fëmijët mund të komunikojnë për shembull përmes lojës, tregimit të një historie dhe vizatimit por është e rëndësishme që të tregohet kujdes që të mos humbasin nëpër interpretime të ndryshme mbi atë që kanë bërë fëmijët, por të përqendrohemi sesi të përdorim metoda krijuese për të ndihmuar fëmijën për të komunikuar. Për



shembull nëse një fëmijë bën një vizatim është e rëndësishme fëmija të pyetet se çfarë kupton ai me këtë vizatim dhe jo të vendoset nga ana e punonjësit se çfarë po përpiket të thoshte fëmija.

Mund të jetë e vështirë që një fëmijë të flasë gjatë gjithë kohës së intervistës. Ata mund të përpiqen të ndalojnë komunikimin për një numër arsyesh si p.sh. ata mund të kenë frikë, mund të stresohen, nuk kanë besim ose nuk ndihen mirë me intervistuesin ose sepse atyre ju duken kujtimet shumë të dhimbshme ose të vështira për t'i shprehur me fjalë. Fëmijët mund të kenë emocione të ngatërruara për veten e tyre apo abuzuesin e supozuar dhe kanë nevojë për një trajtim të kujdesshëm (jashtë intervistës). Prandaj është e rëndësishme që të jemi të kujdesshëm për të mos fajësuar ose kritikuar abuzuesin e supozuar sidomos kur ata janë pranë fëmijës. Mund të jetë e përshtatshme të thuhet se sjellja e tyre ishte e gabuar, sidomos nëse fëmijët kanë ndjesinë se ishte faji i tyre.

Të gjitha format e abuzimit rezultojnë deri në njëfarë niveli në humbjen e kontrollit të fëmija, me thyerjen e besimit, me turpin dhe (vetë) fajësimin. Prandaj është e rëndësishme që procesi i intervistimit të mos i kombinojë ose të mos i nxisë këto ndjenja. Vetëm në situata të rralla dhe ekstreme duhet të "rrëmbehet" fëmija dhe të informohet paraprakisht për një intervistë mbi ta.

Përpara se të Fillojmë Intervistën – Fakte të Rëndësishme:

Në varësi të mjedisit mund të jetë e vështirë të kërkes një zgjedhje mbi mënyrën sesi ta organizosh intervistën qoftë me një fëmijë ose me një të rritur. Fëmijëve duhet t'i jepet gjithmonë mundësia për një intervistë private si pjesë e procesit të vlerësimit dhe nuk duhet të intervistohet në prani të prindërve ose të kujdestarëve kur ka supozime për abuzim ose neglizhim.

Vendndodhja – cili është vendi më i mirë për intervistën? Për shembull në shtëpinë e tyre apo në një vend asnjans?

Koha – cila është ora më e përshtatshme e ditës për të zhvilluar intervistën? Çfarë ndikimi / problematike do të krijojë në jetën e përditshme?

Kohëzgjatja – sa kohë duhet të zgjasë intervista? Zakonisht me fëmijët intervistat zgjasin pak.

Nevojat e veçanta – a ka ndonjë nevojë të veçantë (si p.sh. vështirësi në komunikim) që duhet marrë në konsideratë? Për fëmijën duhet marrë në konsideratë moshën dhe zhvillimin.

Personat e përfshirë – cili është personi më i përshtatshëm për ta intervistuar? Nëse intervistojmë një fëmijë, a është e përshtatshme për ndonjë person që të jetë i pranishëm në mënyrë që të ndihmojë fëmijën që të ndihet më mirë dhe që të jetë në gjendje të flasë?

Qartësime mbi arsyet e intervistës – për shembull gjasat dhe shkaqet e problematikës në mënyrë që çështjet e rëndësishme të mund të hulumtohen pa qenë e nevojshme që të intervistojmë fëmijën përsëri.

Fazat e Intervistës

Nëse intervistojmë një fëmijë ose një të rritur intervistat duhet të ndjekin një sërë hapash:

Prezantim – përfshin procesin e marrjes së lejes për intervistim, negocimin e kufijve dhe nivelin e konfidencialitetit, nëse intervistojmë një fëmijë duhet ta sigurojmë fëmijën vazhdimisht se nuk është në telashe, marrja e lejes për mbajtjen e shënimeve.

Krijimi i Marrëdhënies – krijimi i marrëdhënies (p.sh. duke bërë pyetje të përgjithshme, të cilat nuk janë të lidhura me incidentin / të flitet për çështje "asnjanëse").

Të folurit Haptazi – të lejojmë fëmijën të flasë haptazi lidhur me incidentin / situatën në familje, pa e ndërprerë megjithëse mund të ketë nevojë për një shtysë (p.sh. : "pra më thuaj çfarë ndodhi kur....").

Qartësime & Pyetje – të plotësohen gjërat e paqarta dhe të sigurohet se ajo që është thënë është kuptuar.

Përmbledhja & Përfundimi – kontrolli për herë të dytë për të siguruar që "historia" është kuptuar, shpjegim se çfarë do të ndodhë më pas dhe verifikime nëse ka ndonjë pyetje. Në këtë fazë është shumë e rëndësishme që të mos



bëhen premtime false ose të deklarohet që diçka do të ndodhë / nuk do të ndodhë në rast kur kjo nuk mund të garantohet. Nëse premtimet dhe angazhimet nuk mbahen, atëherë do të kemi një thyerje të besimit.

Edhe nëse detajet e supozimit janë të njohura, shpeshherë gjatë intervistës një fëmijë mund të përmendë edhe abuzime të tjera (ndoshta duke përfshirë të tjerët) dhe jep më shumë informacion. Në qoftë se ndodh kjo atëherë është e rëndësishme që këto pohime të trajtohen në mënyrën e duhur duke:

- Siguruar fëmijën se ata po bëjnë veprimin e duhur u shprehur për problemin;
- Pranuar atë që thotë fëmija;
- Mos shfaqur tronditje ose mungesë besimi.

Nëse bëhet një pohim është e rëndësishme që të shqyrtohet siguria e fëmijës dhe të bëhen organizimet e duhura. Është gjithashtu e rëndësishme që intervista të ndërpritet nëse është e nevojshme, psh. nëse na nevojiten udhëzime ose në qoftë se fëmija ka nevojë të qetësohet sepse është shumë i mërzhitur.

VIZITAT NË SHTËPI DHE VËZHGIMET NË FAMILJE

Të paktën duhet të bëhet një vizitë në shtëpi si pjesë e procesit të vlerësimit. Kjo do të krijojë mundësinë jo vetëm për të parë kushtet se ku jeton fëmija por gjithashtu, në varësi të personit tjetër që është i pranishëm gjatë vëzhgimit, për të kuptuar ndërveprimin ndërmjet anëtarëve e familjes.

FLETA E REGJISTRIMIT PËR VIZITAT NË SHTËPI DHE VËZHGIME duhet të përdoret për të mbajtur shënime detaje të ndryshme gjatë vizitës në shtëpi / vëzhgimeve në familje dhe një kopje duhet të mbahet në dosje.

Gjithashtu duhet të bëhen vizita të rregullta në shtëpi, për të vlerësuar ecurinë dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes dhe Përkujdesit të fëmijës.

Vizita në Familje mundëson:

- Që familja të shikohet në mjedisin e tyre të natyrshëm dhe që të bëhen vlerësimet e kushteve në shtëpi.
- Vëzhgimet e llojeve të marrëdhënieve ose konflikteve ndërmjet anëtarëve të familjes.
- Vëzhgimet e sjelljeve të fëmijëve.

Vizitat në familje mund të organizohen edhe me profesionistë të tjerë. Nëse ka rrezik për fëmijën, nëse familja nuk pranon të vijë pranë NJMF, ose për të realizuar vizitën e parë në familje, për arsye sigurie mund të organizohet një vizitë e përbashkët e PMF me një anëtar tjetër të Grupit Teknik Multidisiplinar. Në rastet kur ka problematika të lidhura me sigurinë dhe kur ka rrezik për praninë e dhunës, në vizitat në familje duhet të përfshihet edhe policia.

Megjithëse shtëpia përbën një mjedis joformal, punonjësit janë atje si profesionistë dhe duhet ta ruajnë këtë pozicion.



ANEKSI 7 – Formulari i Shqyrtimit të Progresit / Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës

FORMULARI I SHQYRTIMIT TË PROGRESIT / PLANIT INDIVIDUAL PËR MBROJTJEN E FËMIJËS			
Emri i Fëmijës:	Data kur është bërë Planit:	Data e Shqyrtimit të Radhës të Progresit:	
Emrat e Personave që Plotësojnë Planin / Agjencia:			
Personi Përgjegjës për Monitorimin e Brendshëm të Planit (deri në Shqyrtimin e Progresit të Radhës)			
Plani i Pasigurisë: Çfarë veprimesh do të ndërmerren nëse plani nuk mund të zbatohet deri në shqyrtimin e radhës ose nëse situata e fëmijës ndryshon?			
Ju lutemi konfirmoni nëse prindërit / fëmija ishte i pranishëm (nëse jo si u morën në konsideratë mendimet e tyre gjatë hartimit të planit?)			
Datat e Shqyrtimeve të Mëparshme: <i>Shënim shqyrtimi duhet të ndërmerren – Shqyrtimi me Nr. 1 duhet bërë 6 javë pas planit të zhvillimit dhe më pas çdo 3 muaj.</i>			
<i>Ju lutemi rendisni nevojat e identifikuar në bazë të secilit dimension përkatës. JU LUTEMI referojuni vlerësimit dhe detajoni mënyrën sesi secili faktor rrisht do të ulët / eliminohet.</i>			
Dimensionet – Nevojat e Veçanta janë të Identifikuara.	Shërbimet e Nevojshme për të Përbushur Nevojat.	Agjencia Përgjegjëse & Afati Kohor.	Përditësim gjatë Shqyrtimit / Ndryshim i Planit.
Nevojat për Siguri:			
Strehimi / Akomodimi & Nevojat Bazë:			



Shëndeti & Nevoja për Zhvillim (duke përfshirë nevojat fizike, emocionale dhe psikologjike):			
Arsimi & Aftësitë e Jetës:			
Marrëdhëniet Sociale:			
Marrëdhëniet Familjare: (përfshirë si do të mbahen kontaktet nëse fëmija do të shkëputet nga familja)			
Kulturor / Identiteti:			
Nevojat për aktivitete çlodhëse:			
Çdo lloj tjetër i veçantë nevoje (p.sh. konsultime etj. për të ndihmuar në përmirësimin e situatës):			

**ANEKSI 8 – Mbyllja e Rastit**

Ky formular duhet të plotësohet dhe të ruhet në një dosje kur mbyllet rasti.

MBYLLJA E RASTIT	
Emri i Fëmijës:	Numri i Identifikimit:
Arsyet për referimin e parë & data e referimit:	
Përse po mbyllet rasti? Si ka ndryshuar situata (jepni specifikat):	
Këndvështrimet e Fëmijës / Prindërit lidhur me mbylljen:	
Emrat e atyre që morën pjesë në vendimin për mbylljen e rastit:	
Data e Mbylljes së Rastit:	



ANEKS 9 – Fleta e Informacioneve Bazë

Ky formular duhet të mbahet në fillim të dosjes individuale të fëmijës – dhe duhet përditësuar rregullisht.

FLETA E INFORMACIONEVE BAZË	
Emri i Fëmijës:	Numri i Identitetit të Dosjes:
Data e Lindjes / Gjinia:	Emrat e Prindërve & Adresa:
Vendndodhja Aktuale e Fëmijës / Ku po jeton Fëmija:	Shkolla & Personi i Kontaktit:
Doktori / Shërbimet Shëndetësore & Personi i Kontaktit:	Datat e Vlerësimeve Mjekësore / Kontrollat Shëndetësore etj.
Data e Referimit:	Datat e Shqyrtimeve të Planit të cilat janë mbajtur:
Persona të tjerë të rëndësishëm në jetën e Fëmijës & Detajet e Kontaktit:	Shërbime të tjera / Agjenci të Përfshira & Numrat e Kontaktit:

**ANEKS 10 – Fleta e Ditarit**

Ky formular duhet të përdoret për të regjistruar TË GJITHA veprimet dhe kontaktet që bëhen në lidhje me një ras dhe mbahet në dosjen e fëmijës. Kur përdoret një bllok shënimesh, informacioni nga blloku i shënimeve DUHET t pasqyrohet në këtë formular.

FLETA E DITARIT		
Data / Ora	Metoda e Komunikimit (p.sh. përmes telefonit, vizitës, takimit)	Përmbledhje e Kontaktit



ANEKS 11 – Formular Miratimi per Ndarjen e Informacionit

Miratimi për Ndarjen e Informacionit

..... është përgjegjëse për sigurimin e mirëqenies dhe të drejtave të të gjithë fëmijëve që janë të regjistruar në këtë zonë.

Për të garantuar se çdo fëmijë i ofrohet shërbimi i përshtatshëm është shpesh e nevojshme të ndahet informacion personal i mbledhur nga fëmija dhe pjesëtarët e familjes me autoritete/ organizata të tjera.

Kjo formë kërkon miratimin tuaj, për ndarjen e informacionit thelbësor të mbledhur nga Punonësja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilës i është caktuar rasti i fëmijës suaj, me specialistë të cilët mund të jenë në gjendje të ndihmojnë në punën për Mbrojtjen e Fëmijës.

Unë.....(Emri mbiemri i fëmijës dhe/ose prindi/kujdestarit) bie dakord që Punonësja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëvee caktuar nëmund të ndajë informacionin thelbësor në lidhje me (emri mbiemri i fëmijës) me autoritetet e administratës publike, policinë ose organizatat jofitimprurëse siç konsiderohet e nevojshme, për të mbrojtur mirëqenien dhe të drejtat e fëmijës së përmendur.

Firma:
Fëmija/Prindi/kujdestari/Kujdestari

Firma:.....

Punonësja e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve

Data:



VENDIM
Nr. 8, datë 26.2.2015
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 09.10.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 42/11 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Fatmir Maliqi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2013-725, datë 30.05.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 42/1/2, 43, 131/“f” dhe 134/1/“g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe neni 6/3/“c” i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 2008 kërkuesi Fatmir Maliqi është gjykuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/“a”/2 e 22 të Kodit Penal (KP). Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 43, datë 30.06.2008, Gjykata e Shkallës së Parë për

Krime të Rënda ka vendosur të deklarojë të pafajshëm kërkuesin Fatmir Maliqi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohej.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 55, datë 14.10.2008, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, për arsye të shkeljeve të rregullave procedurale të konstatuara në atë proces.

3. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 39, datë 02.07.2009, në pamundësi të realizimit të njoftimit për kërkuesin Fatmir Maliqi, ka vendosur ndarjen e çështjes për këtë të pandehur, duke vijuar me procedimin për tre të pandehurit e tjerë.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 31, datë 01.10.2010, ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Fatmir Maliqi për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 283/“a”/2 e 22 të KP-së dhe duke aplikuar edhe nenin 23/2 të KP-së, dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim...”*

5. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 62, datë 28.12.2010, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë mbrojtësi i kërkuesit.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-725, datë 30.05.2013, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

7. **Kërkuesi Fatmir Maliqi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe paraqet këto shkaqe në mbështetje të pretendimit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor:

7.1 Çështja në ngarkim të kërkuesit u veçua nga çështja në ngarkim të të pandehurve të tjerë, të cilët u deklaruan fajtorë me vendimin nr. 39/2009, i cili u la në fuqi edhe nga gjykata e apelit. Në këto dy vendime, të cilat iu bashkëngjitën konkluzioneve përfundimtare të prokurorisë, gjykatat, në pjesën arsyetuese, bëjnë



analizën e provave për fajësinë e kërkuesit njësoj si për të pandehurit e tjerë, duke e gjetur edhe atë fajtor dhe pse mungon dhënia e dënimit për të.

7.2 Duke iu referuar këtyre vendimeve, gjykatat që kanë gjykuar dhe dënuar kërkuesin kanë cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi e kanë nisur çështjen me paragjykimin e fajësisë së tij. Gjykatat kanë administruar në cilësinë e provës një akt që nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit dhe verifikimit në seancë gjyqësore, pasi në arsyetim ato i referohen vendimit të formës së prerë që deklaronte fajtorë tre të pandehurit e tjerë.

7.3 Fillimisht çështja në ngarkim të kërkuesit është gjykuar nga një trup tjetër gjykues, i cili me vendimin nr. 43, datë 30.06.2008 e deklaroi atë të pafajshëm. Në rigjykimin e çështjes nuk u pretendua që gjykata të kishte parasysh këtë vendim, sepse rigjykimi presupozon gjykimin nga e para, pa marrë parasysh vendimet e mëparshme të gjykatave.

7.4 Vendimi i dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, i ka hequr kërkuesit çdo të drejtë që të dëgjohet në proces. Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është ngritur në të gjitha shkallët e gjykimin, përfshirë edhe rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por ai nuk është marrë parasysh dhe nuk i është dhënë përgjigje.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

8.1 Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar. Nga vlerësimi në tërësi i akteve nuk rezulton asnjë e dhënë që të tregojë se gjykatat e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ose që ato ta kenë konsideruar atë fajtor përpara një vendimi përfundimtar fajësie.

8.2 Bazuar në vendimet gjyqësore, fajësia e kërkuesit është bazuar jo vetëm në vendimin penal të formës së prerë nr. 39/2009, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimin. Përdorimi i vendimit nr. 39/2009 është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 193/5 të KPP-së dhe përdorimi i këtij vendimi për efekte provuese nuk cenon nenin 30 të Kushtetutës, pasi ai është vlerësuar në unitet me provat e tjera, unitet i cili nëse nuk formohet,

nuk është në gjendje të krijojë bindjen për ekzistencën e faktit.

8.3 Pretendimi për vendimin e dhënë në dhomë këshillimi është i pabazuar, pasi pretendimet e kërkuesit të paraqitura në rekurs janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar nga Kolegji Penal si të pabazuara, duke konkluduar në mospranimin e tyre. Për më tepër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo lloj veprimtarie e dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

9. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Sipas tij, gjykatat e kanë nisur çështjen me paragjykimin e fajësisë së tij. Ato kanë administruar në cilësinë e provës një akt që nuk ka qenë pjesë e shqyrtimit dhe verifikimit në seancë gjyqësore, konkretisht vendimi i formës së prerë që deklaronte fajtorë tre të pandehurit e tjerë, të cilit i janë referuar edhe në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

10. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 9, datë 28.04.2004; nr. 23 datë 23.07.2009 dhe nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6 § 1 i Konventës. Ky parim jo vetëm ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi “i akuzuar për një veprë penale” është fajtor



përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin, por përfshin edhe deklaratimet e bëra nga zyrtarë të tjerë publikë. Gjykata ka specifikuar më tej se neni 6 § 2 mund të zbatohet kur një vendim gjykate, i dhënë në procedime që nuk janë drejtuar kundër aplikantit në cilësinë e tij si “i akuzuar”, por që, megjithatë, kanë të bëjnë me procedimet penale që në të njëjtën kohë janë duke u kryer ndaj tij, përfshin një vlerësim paraprak të fajësisë së tij (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014*).

12. Në çështjen *Karaman kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja ka vlerësuar nëse parimi i prezumimit të pafajësisë mund të cenohet nga deklaratimet e përfshira në një vendim të dhënë kundër bashkë të pandehurve në procedime të veçanta, por që nuk kanë efekt ligjor detyrues në procedime penale në zhvillim ose të ardhshme kundër aplikantit. Duke ju referuar interpretimit të saj për qëllimin e zbatimit të nenit 6 § 2, GEDNJ-ja ka vlerësuar se një dallim thelbësor duhet bërë ndërmjet një deklarimi se dikush thjesht dyshohet se ka kryer një veprë penale dhe një deklarimi të qartë, në mungesë të një dënimi përfundimtar, se një individ ka kryer veprën penale në fjalë. Në procedime penale komplekse që përfshijnë disa persona, të cilët nuk mund të gjykohen së bashku, referencat nga gjykatat lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë, të cilët mund të gjykohen veçmas më vonë, mund të jenë të domosdoshme për vlerësimin e fajësisë së atyre që janë duke u gjykuar. Gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime. Kjo zbatohet edhe ndaj fakteve që lidhen me përfshirjen e personave të tretë. Megjithatë, nëse fakte të tilla duhet të paraqiten, gjykata duhet të evitojë të japë më shumë informacion se sa është e nevojshme për vlerësimin e përgjegjësisë penale të atyre personave që janë të pandehur në gjykimin përpara saj (*shih paragrafët 63 dhe 64 të vendimit të GJEDNJ-së*).

13. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se gjatë gjykimin të kësaj çështjeje penale, në pamundësi të realizimit të

njoftimit për kërkuesin Fatmir Maliqi, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 39, datë 02.07.2009, pas kthimit të çështjes për rigjykim nga gjykata e apelit, ka vendosur ndarjen e çështjes për këtë të pandehur, duke vijuar me procedimin për tre të pandehurit e tjerë. Në arsyetimin e këtij vendimi, me të cilin të gjykuarit e tjerë janë deklaruar fajtorë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzoheshin, gjykata është shprehur, mes të tjerash, se “Në trafikimin e lëndës narkotike i pandehuri I.K. ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Fatmir Maliqi, i cili e ka shoqëruar atë për gjatë gjithë rrugës, deri në momentin e ndërhyrjes të të pandehurve P.GJ. dhe A.K. ...”. Vendimi nr. 39/2009 ka marrë formë të prerë dhe gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, gjykata i është referuar si provë edhe këtij vendimi. Në vendimin e saj nr. 31, datë 01.10.2010, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda shprehet: “Në të njëjtin gjykim edhe i gjykuari I.K. është gjykuar dhe deklaruar fajtor... Sipas vendimeve gjyqësore i gjykuari I.K. këtë veprë penale e ka kryer jo i vetëm, por në bashkëpunim me të pandehurin Fatmir Maliqi dhe për këtë shkak veprimet e tij janë cilësuar sipas paragrafit të dytë të nenit 283/a të KP-së... E njëjta rrethanë ekziston edhe për të gjykuarin I.K., veprimet dhe vepra penale e konsumuar prej të cilit janë vërtetuar në vendimin e mësipërm të formës së prerë dhe sipas nenit 193/5 të KPP-së ai mund të merret si provë në këtë gjykim vetëm në lidhje me ekzistencën e faktit, duke e vlerësuar në unitet me provat e tjera. Megjithatë, gjykata e gjen me vend të theksojë se në rastin në gjykim, për të gjykuarin I.K. dhe të pandehurin Fatmir Maliqi, vendimi penal nr. 39, datë 02.07.2009 i gjykatës së shkallës së parë, që ka marrë formë të prerë... nuk ka zëjdhur rastësisht në çështjen e të parit edhe një fakt që lidhet me çështjen e të dytit, por bëhet fjalë pikërisht për të njëjtin fakt që përbën veprë penale (që është edhe objekt i akuzës) dhe për të njëjtat prova të marra në shqyrtim në të dyja proceset gjyqësore...” (faqe 6 e vendimit).

14. Në bazë të pikës 5, të nenit 193 të KPP-së, vendimet e formës së prerë mund të merren për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, duke u vlerësuar në unitet me provat e tjera. Edhe në rastin konkret, në zbatim të kësaj dispozite, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që ka gjykuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit, i është referuar vendimit penal të formës së prerë lidhur me ekzistencën e



rrethanave të çështjes dhe vërtetimin e faktit penal që i ngarkohet edhe kërkuesit. Edhe pse vendimi i përdorur si provë në këtë gjykim përmban disa deklarime në lidhje me përfshirjen e kërkuesit në veprimtarinë kriminale, nuk rezulton që gjykata të ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të tij, gjykata nuk ka arritur asnjë konkluzion *apriori* për fajësinë e kërkuesit, duke u bazuar vetëm në gjykimin penal në të cilin ai nuk ka marrë pjesë. Përkundrazi, përfundimi i gjykatës për fajësinë e kërkuesit është arritur pas një procesi shqyrtimi dhe vlerësimi të provave të administruara në gjykim, duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Gjykata vëren se vendimit të formës së prerë nr. 39/2009 nuk i është dhënë një vlerë e paracaktuar në gjykim, por ai i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor së bashku me provat e tjera të administruara në proces, duke u vlerësuar në unitet me to.

15. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

B. Për pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

16. Sipas kërkuesit, edhe pse pretendimi për cenimin e prezumimit të pafajësisë është ngritur në rekurs, ai nuk është marrë parasysh dhe nuk i është dhënë përgjigje nga Gjykata e Lartë.

17. Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit duhet të trajtohet në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë.

18. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi

i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 7, datë 11.03.2008; nr. 14, datë 03.06.2009; nr. 4, datë 23.02.2011; nr. 6, datë 26.02.2013 dhe nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në nenin 432 të KPP-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 433 të KPP-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 8, datë 02.05.2006; nr. 5, datë 26.01.2007; nr. 4, datë 25.02.2009; nr. 25, datë 10.06.2011 dhe nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet



pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (shih vendimin nr. 26, datë 09.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Gjykata vlerëson se në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe, për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë, nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por ai konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 19, datë 19.07.2005 dhe nr. 22, datë 06.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006; nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.07.2013 dhe nr. 52, datë 02.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

21. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata nuk konstaton cenim të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e

paraqitura në rekurs i ka dhënë përgjigje kërkesit lidhur me to, në rastin konkret, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së.

22. Edhe për sa i përket arsytimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, Gjykata ka vlerësuar se nuk jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (shih vendimet nr. 36, datë 26.07.2011; nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 6, datë 10.02.2014; nr. 17, datë 24.03.2014 dhe nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Në kushtet kur nuk ka pretendime të natyrës kushtetuese, vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se procesi gjyqësor nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.

23. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe, për pasojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi.



MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Kërkuesi ka pretenduar se përdorimi si provë në gjykimin e zhvilluar ndaj tij i vendimit penal të formës së prerë nr. 39/2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në të cilin kërkuesi është cilësuar si bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale, ka sjellë cenimin e të drejtës së tij për t'u prezumuar i pafajshëm. Shumica e ka rrëzuar këtë pretendim si të pabazuar. Ajo arsyeton se *“edhe pse vendimi i përdorur si provë në këtë gjykim përmban disa deklarime në lidhje me përfshirjen e kërkuetit në veprimtarinë kriminale, nuk rezulton që gjykata të ketë nisur procesin me bindjen se kërkuesi është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Gjatë shqyrtimit të çështjes penale në ngarkim të tij, gjykata nuk ka arritur asnjë konkluzion apriori për fajësinë e kërkuetit, duke u bazuar vetëm në gjykimin penal në të cilin ai nuk ka marrë pjesë. Përkundrazi, përfundimi i gjykatës për fajësinë e kërkuetit është arritur pas një procesi shqyrtimi dhe vlerësimi të provave të administruara në gjykim, duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Gjykata vëren se vendimit të formës së prerë nr. 39/2009 nuk i është dhënë një vlerë e paracaktuar në gjykim, por ai i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor së bashku me provat e tjera të administruara në proces, duke u vlerësuar në unitet me to”* (prg. 14 i vendimit). Nuk pajtohemi me këtë përfundim të shumicës dhe në vijim do të paraqesim argumentet tona për këtë qëndrim.

3. Parimi i prezumimit të pafajësisë, i interpretuar në jurisprudencën e Gjykatës, referuar edhe standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ, kërkon që deklarimi i fajësisë të së pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

4. Sipas GJEDNJ, parimi i prezumimit të pafajësisë, i parë si një garanci procedurale në kontekstin e një procesi penal, imponon kushte, në lidhje me, *inter alia*, deklarimin paraprak nga gjykatat ose zyrtarë të tjerë publikë për fajësinë e të pandehurit. Neni 6 § 2 i Konventës ka qëllim të parandalojë dëmtimin e një gjykimi të drejtë nga deklarimet paragjyquese të lidhura ngushtë me procedimin. Edhe në mungesë të përfundimeve formale mjafton të ketë një arsyetim që sugjeron se gjykatat e konsiderojnë të pandehurin fajtor. Neni 6 § 2 i Konventës mund të zbatohet kur një vendim gjykate, i dhënë në procedime që nuk janë drejtuar kundër kërkuetit në cilësinë e tij si “i akuzuar”, por që, megjithatë, kanë lidhje me procedimet penale që në të njëjtën kohë janë duke u kryer ndaj tij, përfshin një vlerësim të parakohshëm të fajësisë së tij. Parimi i prezumimit të pafajësisë, në teori, mund të cenohet edhe në rast të deklarimeve të parakohshme për fajësinë e një subjekti, të bëra me qëllim të një gjykimi kundër të pandehurve të tjerë, të gjykuar veçmas. Konventa, si një instrument për mbrojtjen e individit, kërkon që dispozitat e saj të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë që ta bëjnë këtë mbrojtje praktike dhe efektive dhe kjo zbatohet edhe në lidhje me nenin nenin 6 § 2 të saj (*shih paragrafët 41-42 të vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Karaman kundër Gjermanisë*).

5. Në rastin konkret, vendimi nr. 39/2009 është dhënë në një procedim tjetër, të ndarë nga ai i zhvilluar ndaj kërkuetit. Ky vendim nuk ka pasur efekt të drejtpërdrejtë mbi kërkuetin, në kuptimin që nuk ka qenë detyrues për akuzën për iniciimin e procedimit penal apo për gjykatën që ka shqyrtuar çështjen ndaj kërkuetit për dënimin e tij. Përfundimet e këtij vendimi në lidhje me gjykimin dhe dënimin u referohen të pandehurve të tjerë, ndërsa kërkueti është proceduar në një gjykim të ndarë dhe dënimin i tij për kryerjen e veprës penale ka qenë rezultat i këtij gjykimi.

6. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se pas ndarjes së çështjes për kërkuetin, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vijuar me gjykimin ndaj të pandehurve të tjerë dhe në vendimin e saj nr. 39, datë 02.07.2009, mes të tjerash, është shprehur se *“në trafikimin e lëndës narkotike, i pandehuri I.K. ka vepruar në bashkëpunim me të pandehurin Fatmir Maliqi, i cili e ka shoqëruar*



atë për gjatë gjithë rrugës, deri në momentin e ndërhyrjes të të pandeburve P.GJ. dhe A.K. (...) Sipas vendimeve gjyqësore, i gjykuari I.K. këtë veprë penale e ka kryer jo i vetëm, por në bashkëpunim me të pandeburin Fatmir Maliqi?. Ky vendim është paraqitur nga akuza si provë në gjykimin penal që është zhvilluar ndaj kërkuesit, i cili ndërkohë po procedohej veçmas për të njëjtën akuzë (*shih prg. 13 të vendimit*). Duke qenë se jemi përpara të njëjtës ngjarje dhe veprimtari kriminale, ato pjesë të vendimit nr. 39/2009, që i referohen përfshirjes së kërkuesit si bashkëpunëtor në këtë veprimtari, kanë qenë, gjithashtu, objekt i gjyimit penal që pritej të zhvillohej ndaj tij dhe, për pasojë, kishin një lidhje të drejtpërdrejtë me këtë gjykim. Këto përfundime të gjykatës, të shprehura në vendimin nr. 39/2009, edhe pse nuk kanë qenë detyruese në çështjen penale ndaj kërkuesit, rezultojnë të kenë pasur një efekt në procesin penal të zhvilluar ndaj tij, për sa kohë që ky vendim është administruar si provë dhe është vlerësuar si i tillë nga gjykata. Në këto kushte, bazuar në standardet e jurisprudencës së GJEDNJ, në lidhje me çështje komplekse, me disa të pandehur të gjykuar veçmas, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë mund të ngrihet në çështjen në shqyrtim.

7. Për të vlerësuar nëse kemi cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi, u referohemi sërish standardeve të vendosura nga GJEDNJ në çështjen e sipërcituar, *Karaman kundër Gjermanisë*. Në zbatim të nenit 6 § 2 të Konventës parimi i prezumimit të pafajësisë konsiderohet i cenuar nëse një vendim gjyqësor reflekton një opinion se personi i akuzuar është fajtor përpara se fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin. Gjithsesi, një dallim thelbësor duhet bërë ndërmjet një deklarimi se dikush thjesht dyshohet që ka kryer një veprë penale dhe një deklarimi të qartë, në mungesë të një dënimi përfundimtar, se një individ ka kryer veprën penale në fjalë. GJEDNJ, në vendimin e referuar më sipër, ka theksuar se në procedime penale komplekse që përfshijnë disa persona, të cilët nuk mund të gjykohen së bashku, referencat nga gjykatat lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë, të cilët mund të gjykohen veçmas më vonë, mund të jenë të domosdoshme për vlerësimin e fajësisë së atyre që janë duke u gjykuar. Gjykatat penale

janë të detyruara të përcaktojnë faktet e rëndësishme të çështjes për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur. Kjo zbatohet edhe ndaj fakteve që lidhen me përfshirjen e personave të tretë. Megjithatë, nëse është e nevojshme që fakte të tilla të paraqiten në vendim, gjykata duhet të evitojë të japë më shumë informacion nga sa është e nevojshme për vlerësimin e përgjegjësisë penale vetëm të atyre personave që janë të pandehur në gjykimin që zhvillohet para saj (*shih paragrafët 63-64 të vendimit*).

8. Duke iu rikthyer rastit konkret, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se deklaratimet e dhëna në vendimin nr. 39/2009 të formës së prerë, përmbajnë vlerësim në lidhje me rolin e kërkuesit në veprimtarinë kriminale që është marrë në shqyrtim nga gjykata. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që referimet nga gjykata, në lidhje me persona të tjerë, që dyshohen të përfshirë në ngjarjen kriminale, duhet të kufizohen në një përshkrim neutral të fakteve dhe të çështjes. Çdo referencë duhet të jetë e kufizuar, pa u ndalur në vlerësime të përgjegjësisë penale të personave që nuk janë të pandehur në gjykimin në fjalë.

9. Në kuptim të nenit 193/5 të KPP referimet në një vendim të formës së prerë mund të bëhen për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, pra për të përcaktuar rrethanat e çështjes, në mënyrë që më tej gjykata të gjykojë mbi kontributin individual të të akuzuarit në kryerjen e veprës penale. Edhe pse kjo është veçanërisht e nevojshme në rast të lidhjeve faktike mes dy procedimeve të realizuara në mënyrë të ndarë, të tilla prova duhen vlerësuar nga gjykata në unitet me provat e tjera të administruara në proces. Për më tepër, kërkuesi, duke qenë se nuk ka marrë pjesë në procesin e zhvilluar ndaj të pandehurve të tjerë, nuk ka pasur asnjë mundësi që të debatojë mbi provat apo të kundërshtojë vendimin gjyqësor, në të cilin gjykata është shprehur mbi përfshirjen dhe rolin e tij në kryerjen e veprës penale.

10. Në kundërshtim me standardet e mësipërme, arsyetimi i vendimit nr. 39/2009, i parë në tërësinë e tij, të krijon përshtypjen se kërkuesi është prezumuar fajtor për shkak të rolit të tij të përcaktuar në atë gjykim, si bashkë-



punëtor në kryerjen e veprës penale. Arsyetimi i gjykatës shkon përtej një përshkrimi të thjeshtë të fakteve dhe nuk kufizohet në një përshkrim neutral të veprimeve ku përfshihet kërkuesi, por me një gjuhë të qartë ndalet në analizën e elementeve objektive dhe subjektive të veprës, duke nënvizuar përfshirjen e tij në këtë veprimtari kriminale. Për pasojë, vlerësimet e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në vendimin nr. 39/2009, të analizuara në tërësinë e tyre, e lënë të nënkuptuar deklarinimin e fajësisë të kërkuesit edhe pse formalisht në vendim nuk ka asnjë masë dënimi ndaj tij.

11. Megjithëse vendimi nr. 39/2009 nuk ka pasur ndonjë efekt detyrues për gjykatën që ka shqyrtuar çështjen penale kundër kërkuesit, përfundimet e tij janë marrë të mirëqena apriori nga kjo gjykatë. Në vendimin e saj nr. 31/2010, që ka deklaruar fajtor kërkuesin, gjykata është shprehur për kualifikimin e veprimeve të tij duke u bazuar në vendimin nr. 39/2009 të dhënë ndaj të pandehurve të tjerë. Kështu në këtë vendim gjykata ka arsyetuar se *“...sipas vendimeve gjyqësore, i gjykuari I.K. këtë veprë penale e ka kryer jo i vetëm, por në bashkëpunim me të pandehurin Fatmir Maliqi dhe për këtë shkak veprimet e tij janë cilësuar sipas paragrafit të dytë të nenit 283/a të KP-së... Megjithatë, gjykata e gjen me vend të theksojë se në rastin në gjykim, për të gjykuarin I.K. dhe të pandehurin Fatmir Maliqi, vendimi penal nr. 39, datë 02.07.2009 i gjykatës së shkallës së parë, që ka marrë formë të prerë... nuk ka zgjodhur rastësisht në çështjen e të parit edhe një fakt që lidhet me çështjen e të dytë, por bëhet fjalë pikërisht për të njëjtin fakt që përbën veprë penale (që është edhe objekti i akuzës) dhe për të njëjtat prova të marra në shqyrtim në të dyja proceset gjyqësore...”* (faqe 6 e vendimit).

12. Siç është përmendur më sipër, në çështjet që janë të ndërlydhura, referencat reciproke në vendimet gjyqësore janë të paevitueshme, por kjo nevojitet që të bëhet vetëm me qëllim të përcaktimit të mekanizmit të ngjarjes, që më pas të saktësohet edhe roli i secilit bashkautor. Në ndryshim nga sa konkludon shumica, nga vendimi gjyqësor nr. 31/2010 nuk rezulton që gjykata të kenë bërë hetim të ri të kësaj çështjeje apo ndonjë vlerësim të ndryshëm mbi rolin e kërkuesit. Gjykata kishte detyrimin që të analizonte në mënyrë tërësore të gjitha rrethanat e çështjes, veprimet ose mosveprimet konkrete të kërkuesit për të arritur në një konkluzion të

bazuar në lidhje me përfshirjen e tij në veprimtarinë kriminale. Përkundrazi, në gjykim nuk ka pasuar asnjë prove të re, të ndryshme nga ato të administruara në gjykimin e parë ndaj të pandehurve të tjerë dhe gjykata ka marrë të mirëqena të gjitha përfundimet dhe analizën e kryer në vendimin nr. 39/2009, jo vetëm në lidhje me rrethanat e çështjes, por edhe me rolin e kërkuesit. Rrjedhimisht, vlera që ky vendim ka pasur në gjykim, mënyra se si gjykata ka analizuar përfundimet e arritura në të në lidhje me kërkuesin dhe veçanërisht gjuha e përdorur nga gjykata në arsyetimin e saj, janë të tilla që mund të konsiderohen si një deklarinim paraprak i fajësisë së tij.

13. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, vlerësojmë se në procesin e zhvilluar në ngarkim të kërkuesit gjykata nuk kanë respektuar të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm, si element përbërës i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, në kushtet kur procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj kërkuesit është i cenueshëm, Gjykata duhet ta pranonte kërkesën.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi.

VENDIM

Nr. 9, datë 26.2.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.09.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 36/8 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Gramoz Yzeiraj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i



vendimeve nr. 255, datë 30.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr. 32, datë 22.01.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2012-1258 (155), datë 30.05.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna në bazë të procedimit penal nr. 457/1997.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/“P” dhe 134/1/“g”, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Shtetasit Gramoz Yzeiraj dhe Ilir Yzeiraj janë vëllezër dhe banorë të fshatit Kreshpan në rrethin e Fierit. Në vitin 1987, për vrasjen e babait të tyre N.Y., është dënuar me burgim shtetasi S.Y., i cili ka dalë nga burgu gjatë trazirave të vitit 1997 dhe është kthyer të banonte në fshatin Kreshpan. Në muajin korrik të vitit 1997, shtetasi S.Y. është qëlluar me armë dhe ka gjetur vdekjen.

2. Në datën 16.09.1997, mbi bazën e kallëzimit të vëllezërve të viktimit S.Y., ka filluar procedimi penal nr. 457, duke u regjistruar në regjistrin e hetimit, si persona ndaj të cilëve zhvillohen hetime, vëllezërit Gramoz dhe Ilir Yzeiraj.

3. Me vendimin e datës 24.12.1998, të prokurorit të rrethit Fier, pas zhvillimit të hetimeve, është vendosur pushimi i çështjes penale në ngarkim të shtetasve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, me arsyetimin se nuk është bërë e mundur të provohet se ata janë autorë të vrasjes së shtetasit S.Y. Ky vendim nuk është ankmuar në gjykatë.

4. Me vendim të po kësaj date (24.12.1998), janë pezulluar hetimet e kësaj çështjeje, për moszbulim të autorëve të veprës penale.

5. Mbi relacionin e datës 19.07.2002, të oficerit të policisë gjyqësore, sipas të cilit shtetasi Agron Yzeiraj ka pohuar se autorë të vrasjes janë ai dhe vëllezërit e tij Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, prokurori i rrethit ka vendosur shfuqizimin e

vendimit të pezullimit dhe rifillimin e hetimeve. Në bazë të këtij vendimi, të tre këta shtetas janë marrë të pandehur dhe çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, me vendimin nr. 17, datë 12.02.2004, ka vendosur të deklarojë fajtorë vëllezërit Gramoz, Ilir dhe Agron Yzeiraj, për vrasjen e viktimit S.Y.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 391, datë 15.12.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 17, datë 12.02.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për rishqyrtim po asaj gjykate, me arsyetimin se janë lejuar shkelje të dispozitave procedurale mbi ushtrimin e ndjekjes penale dhe vlefshmërinë e akteve. Sipas kësaj gjykate, vendimet e datës 27.07.2002 dhe 12.12.2002 të prokurorit, për marrjen të pandehur të shtetasve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, janë akte absolutisht të pavlefshme dhe janë marrë nga prokurori pa e pasur një të drejtë të tillë. Kjo, pasi procedimi penal ndaj tyre, për të njëjtat akuza dhe fakte kriminale, është pushuar më parë dhe ky vendim nuk është shfuqizuar nga prokurori më i lartë apo nga gjykata.

7. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 585, datë 15.07.2005, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit, kundër vendimit nr. 391, datë 15.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

8. Gjatë rigjykimit të çështjes në shkallë të parë, është paraqitur nga ana e prokurorisë vendimi i datës 30.11.2005, i drejtorit të Drejtorisë së Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili ka shfuqizuar vendimin e pushimit të hetimeve ndaj shtetasve Ilir Yzeiraj dhe Gramoz Yzeiraj, të datës 24.12.1998, i marrë gjatë hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 457, të vitit 1997. Në përfundim të gjykimit, prokurori ka tërhequr akuzat ndaj shtetasve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, bazuar në vendimin e gjykatës së apelit, të lartpërmendur, dhe ka kërkuar kalimin e akteve organit të akuzës për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 79, datë 28.03.2006, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Yzeiraj për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim” e kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 78/1, 50/gj dhe 51 të Kodit Penal dënimi i tij me 8 vjet burgim. Kalimin e akteve të procedimit penal në ngarkim*



të të pandeburve Gramoz Yzeiraj dhe Ilir Yzeiraj, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.”

10. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 20, datë 23.01.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 79, datë 28.03.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

11. Në datën 30.01.2007 çështja është dërguar sërish për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për shtetasit Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, me akuzën e kryerjes së veprave penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe “Vrasjes me paramendim”, vepra të parashikuara nga nenet 278/2, 78-25 të Kodit Penal.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 255, datë 30.06.2008, ka vendosur:

“Deklarimin fajtor të të pandeburit Gramoz Yzeiraj për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim” e kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 78 dhe 25 të Kodit Penal e dënon me 22 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandeburit Gramoz Yzeiraj për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”, dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal e dënon me 2 vjet burgim. Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandeburin Gramoz Yzeiraj me 23 vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandeburit Ilir Yzeiraj për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim” e kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të neneve 78 dhe 25 të Kodit Penal e dënon me 21 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandeburit Ilir Yzeiraj për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”, dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal e dënon me 2 vjet burgim. Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandeburin Ilir Yzeiraj me 22 vjet burgim.”

13. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 32, datë 22.01.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 255, datë 30.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs mbrojtësi i të gjykuarve.

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1258 (155), datë 30.05.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimi nr. 32, datë 22.01.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

15. Mbrojtësi i caktuar nga familjarët e të gjykuarve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj i është

drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën e datës 20.12.2013, për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme.

16. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 5, datë 17.01.2014, ka vendosur kthimin e kërkesës për plotësim me aktin e përfaqësimit të lëshuar nga kërkuesit.

17. Brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, kërkesa është paraqitur sërish në Gjykatën Kushtetuese, e plotësuar me autorizimin për mbrojtësin, i firmosur vetëm nga shtetasi Gramoz Yzeiraj, i cili është duke vuajtur dënimin në Institutin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë.

II

18. **Kërkuesi Gramoz Yzeiraj** kërkon shfuqizimin e të gjitha vendimeve gjyqësore sipas objektit të kërkesës, duke paraqitur këto shkaqe:

18.1 Çështja penale në ngarkim të vëllezërve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj është pushuar në datën 24.12.1998 dhe prokurori ka urdhëruar pezullimin e hetimeve. Për rifillimin e çështjes penale prokuroria nuk ka zbatuar nenin 24/5 të KPP-së dhe nuk ka marrë parasysh faktin se vendimi i pushimit nuk është ankimuar në gjykatë, ndaj ka efektet e vendimit përfundimtar të gjykatës.

18.2 Arsyetimi i bërë nga gjykata për vendimin e pushimit dhe urdhrin për shfuqizimin e tij është i gabuar, pasi ky i fundit është dhënë në kundërshtim me procedurën dhe praktikën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Prokurori më i lartë për prokurorin e rrethit është Prokurori i Përgjithshëm, ndaj shfuqizimi i vendimit të pushimit nga një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme është i pavlefshëm

18.3 Vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e veprimeve absolutisht të pavlefshme, në kuptim të nenit 128/“c” të KPP-së, që lidhet me thirrjen e të pandeburit ose praninë e mbrojtësit kur është e detyrueshme. Deklarimi i shtetasit Agron Yzeiraj, i përdorur si provë në gjykim, është marrë nga oficeri i policisë gjyqësore në mungesë të mbrojtësit të tij. Deklarimet dhe përgjimet e këtij shtetasi për ndërtimin e ngjarjes, edhe pse ato janë të pavlefshme, të deklaruara të tilla me vendimin nr. 391, datë 15.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, gjykatat i quajnë bindëse dhe i vlerësojnë si provë.



18.4 Gjykata ka përdorur si provë një dialog mes kërkuesit Gramoz Yzeiraj dhe viktimës, por nuk është evidentuar se cili dëshmitar e dëgjoji atë. Po ashtu, lidhur me vërtetimin e faktit të vdekjes së viktimës, gjykata bazohet në dokumentin e gjendjes civile dhe vendimin për dënimin e shtetasit Agron Yzeiraj, por nuk ka një akt procedural të marrë si provë në gjykim për të vërtetuar këtë.

18.5 Vendimet janë bazuar në analogji. Meqenëse dy të gjykuarit Yzeiraj janë dënuar për veprën penale të vrasjes, gjykata aludon se kjo vrasje duhet të jetë bërë me armë dhe pse nuk ka një të tillë. Po ashtu ajo aludon se meqenëse viktimë është dënuar për vrasjen e babait të tyre, janë ata që e kanë kryer veprën penale.

18.6 Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 585, datë 15.07.2005, ka cenuar parimin e barazisë së armëve në proces, duke mos u shprehur për rekursin e të pandehurve kundër vendimit nr. 391, datë 15.12.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, por vetëm për rekursin e prokurorit.

19. **Prokuroria e Përgjithshme**, në parashtrimet me shkrim, prapëson sa vijon:

19.1 Pretendimi i përgjithshëm i ngritur në kërkesë për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk qëndron, pasi gjatë proceseve gjyqësore janë zbatuar drejt dhe me korrektësi të gjitha detyrimet kushtetuese e procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt. Në tërësinë e saj kërkesa nuk përmban asnjë element që mund të shërbejë si objekt gjykimi në këtë Gjykatë.

19.2 Pretendimi për moszbatimin e nenit 24/5 të KPP-së nuk qëndron. Sipas përcaktimit kushtetues Prokuroria është organ i centralizuar dhe, për pasojë, është e drejtë e Prokurorit të Përgjithshëm të përcaktojë hierarkinë e organit të tij, me qëllim vënien në eficiencë dhe zberthimin në praktikë të përcaktimeve të nenit 24 të KPP-së. Po ashtu, edhe ligji për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ka përcaktuar në mënyrë të qartë shkallën e hierarkisë në këtë organ.

19.3 E drejta e palëve për t'u përfaqësuar në proces nuk është shkelur, madje Gjykata e Lartë e ka shtyrë disa herë seancën për t'u dhënë mundësi palëve për të marrë pjesë në proces.

19.4 Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka analizuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga të gjykuarit në rekurs dhe u ka kthyer atyre përgjigje

të arsyetuar. Ajo u ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve lidhur me pavlefshmërinë e pretenduar të vendimeve gjyqësore.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

20. Përpara se të shprehet për thelbin e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e legjitimitimit të kërkuesit Gramoz Yzeiraj, në kuptim të nenit 131/“P” të Kushtetutës.

21. Gjykata vëren se fillimisht kërkesa është paraqitur në emër të shtetasve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj nga një mbrojtës i zgjedhur nga familjarët e tyre. Pas kthimit të saj për plotësim, kërkesa është riparaqitur në Gjykatë e shoqëruar me aktin e përfaqësimit të lëshuar nga shtetasi Gramoz Yzeiraj. Në këto kushte Gjykata vlerëson se ai legjitimohet *ratione personae*.

22. Gjykata vëren se në kërkesë, mes të tjerash, janë ngritur pretendime edhe në lidhje me vendimin nr. 585, datë 15.07.2005 të Gjykatës së Lartë, i cili, sipas kërkuesit, ka cenuar parimin e barazisë së armëve në proces. Neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” ka parashikuar një afat dyvjeçar për paraqitjen e kërkesës përpara Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për kundërshtimin e këtij vendimi.

23. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se pretendimet e ngritura në kërkesë *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues për sa kohë ato lidhen me cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në disa nga elementet e saj përbërëse.

B. Për pretendimin për dënimin mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

24. Kërkuesi pretendon se për rifillimin e çështjes penale nuk është zbatuar neni 24/5 i KPP-së dhe nuk është marrë parasysh fakti se vendimi i pushimit të çështjes penale në ngarkim të tij nuk është ankimuar në gjykatë dhe për pasojë ka efektet e vendimit përfundimtar. Sipas tij, shfuqizimi i vendimit të pushimit nga një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme, dhe jo



nga vetë Prokurori i Përgjithshëm, si prokurori më i lartë, është i pavlefshëm. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se deklarimi i shtetasit Agron Yzeiraj, i përdorur si provë në gjykim, është marrë nga oficeri i policisë gjyqësore në mungesë të mbrojtësit, çka e bën këtë provë të pavlefshme në kuptim të nenit 128/“c” të KPP-së.

25. Gjykata vlerëson se këto pretendime të kërkuetit duhet të shqyrtohen në këndvështrim të respektimit të standardit të sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës të së Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtimit të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës (*shih vendimin nr. 40, datë 22.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 1, datë 12.01.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete (*shih vendimin nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Bazuar në dispozitat procedurale, në gjykim provat merren me kërkesën e palëve dhe prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkëlqje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata i vlerëson ato

sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal, pasi sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimit i saj nga trupi gjyqësor e bën procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimet nr. 7, datë 27.04.2005 dhe nr. 14, datë 03.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kërkuesi pretendon cenimin e nenit 32 të Kushtetutës në disa aspekte. Sipas tij nuk është zbatuar drejt neni 24/5 i KPP-së dhe se vendimi i pushimit të çështjes ka efektet e vendimit përfundimtar të gjykatës. Për pasojë, sipas kërkuetit, të gjitha aktet dhe veprimet procedurale të kryera pas dhënies së këtij vendimi janë absolutisht të pavlefshme.

29. Gjykata vëren se bazuar në nenin 24/5 të KPP-së, prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët, me ankim ose kryesisht. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 4/2002, kanë interpretuar dispozitën e mësipërme në këtë mënyrë: *“Prokuror më i lartë edhe në rastet e shfuqizimit ose ndryshimit të vendimeve të pushimit të çështjeve penale (jo për rastet kur prokurori i rrethit realizon këtë funksion) është Prokurori i Përgjithshëm. Për pasojë, edhe të drejtën e shfuqizimit apo ndryshimit të vendimeve të pushimit të çështjes penale në zbatim të nenit 24 të KPP-së e ka vetëm Prokurori i Përgjithshëm. Prokurorët e tjerë, pra edhe ata pranë Prokurorisë së Përgjithshme, mund të marrin vendime për ndryshimin apo shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale vetëm me autorizim të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm. Nëse ato vendime merren apo janë marrë pa një autorizim të tillë, nuk mund të sjellin asnjë pasojë, pasi janë marrë në kundërshtim me ligjin. Mënyra se si do të funksionojë dhënia e autorizimeve, është problem që zgjidhet nga Prokurori i Përgjithshëm.”*

30. Nga vendimet gjyqësore rezulton se vendimi i datës 24.12.1998 i prokurorit, për pushimin e procedimit penal nr. 457, është shfuqizuar nga prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme (drejtori i Drejtorisë së Hetimit), në bazë të urdhrin nr. 102, datë 23.03.2004 të Prokurorit të Përgjithshëm. Ky vendim është paraqitur në gjykatë nga ana e organit të akuzës gjatë procesit të rigjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, pas kthimit të akteve nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 391, datë



15.12.2004, dhe në bazë të tij gjykata ka hedhur poshtë pretendimet e mbrojtjes për pavlefshmërinë absolute të disa akteve procedurale. Në këto kushte, Gjkata vlerëson se prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme, në rastin konkret, ka vepruar në përputhje me kompetencat që i janë dhënë nga prokurori më i lartë dhe për pasojë pretendimi për mosrespektimin e nenit 24/5 të KPP-së është i pabazuar. Po ashtu, për sa kohë vendimi i pushimit të çështjes penale ishte shfuqizuar nga prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme, gjykatat nuk kishin asnjë pengesë për rishqyrtimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit.

31. Gjkata ka vlerësuar, gjithashtu, se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke shkuar më tej, Gjkata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*sibih vendimin nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjkata vëren se për sa kohë vendimi i pushimit të çështjes penale ishte në fuqi, gjykatat i kanë deklaruar si absolutisht të pavlefshme vendimet e prokurorit për marrjen të pandehur të shtetasve Gramoz dhe Ilir Yzeiraj. Pasi çështja ka filluar të rigjykohet në shkallë të parë, edhe pse është paraqitur nga ana e prokurorisë vendimi i datës 30.11.2005, i drejtorit të Drejtorisë së Hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili ka shfuqizuar vendimin e pushimit të hetimeve ndaj shtetasve Ilir Yzeiraj dhe Gramoz Yzeiraj, të datës 24.12.1998, i marrë gjatë hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 457, të vitit 1997, prokurori i çështjes ka kërkuar kalimin e akteve organit të akuzës për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata dhe aktet e procedimit penal i janë kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Pas përfundimit të hetimeve, organi i akuzës e ka dërguar sërish çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Fier. Pas shfuqizimit të vendimit për pushimin e çështjes penale dhe vendimit për pezullimin e hetimeve, nuk kishte asnjë pengesë që gjykata, në përfundim të fazës së hetimeve, të merrte në shqyrtim kërkesën e organit të akuzës për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Në këto kushte, edhe pretendimi për pavlefshmërinë absolute të akteve dhe veprimeve procedurale të kryera pas dhënies së vendimit të pushimit të çështjes penale është i pabazuar.

33. Si shkak tjetër, për të mbështetur pretendimin për cenimin e të drejtës së sanksionuar në nenin 32 të Kushtetutës, kërkuesi ka paraqitur faktin se deklarimi i dhënë nga shtetasi Agron Yzeiraj para oficerit të policisë gjyqësore, i datës 25.07.2002, është marrë pa praninë e mbrojtësit, çka, sipas tij, i bën këto deklarime, të përdorura si provë në gjykim, absolutisht të pavlefshme.

34. Gjkata vëren se në bazë të nenit 128/“c” të KPP-së, aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në deklarimet e dhëna para oficerit të policisë gjyqësore në datën 25.07.2002, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi Agron Yzeiraj ka deklaruar se do të flasë pa praninë e avokatit dhe se nuk ka nevojë për avokat mbrojtës, kurse gjatë pyetjes së këtij shtetasi nga organi i akuzës, në cilësinë e të pandehurit, në datën 26.07.2002, ka qenë i pranishëm mbrojtësi i tij. Në këto kushte, Gjkata vëren se gjatë dhënies së deklarimeve të kundërshtuara, shtetasi Agron Yzeiraj nuk kishte marrë cilësinë e të pandehurit në gjykim. Pas njoftimit të akuzës atij i është siguruar dhe garantuar mbrojtja me avokat dhe janë respektuar edhe kërkesat ligjore që lidhen me praninë e mbrojtësit gjatë fazës së hetimeve paraprake. Për pasojë, edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

35. Në lidhje me vlerën që ka pasur kjo provë edhe pse nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove të përdorur në gjykim, Gjkata vëren se deklarimet e kundërshtuara, të dhëna nga shtetasi Agron Yzeiraj, nuk kanë qenë e vetmja provë në gjykim, por ajo është vlerësuar në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre, në



respektim të dispozitave procedurale penale. Bindja e gjykatës që ka shqyrtuar çështjen për fajësinë e kërkuesit është formuar jo vetëm në bazë të kësaj prove të kundërshtuar nga kërkuesi, por duke u mbështetur në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit.

36. Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, parimi i barazisë së armëve përbën një nga elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Ky standard kushtetues nënkupton që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër, në funksion të realizimit të një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes (*shih vendimet nr. 19, datë 18.09.2008; nr. 10, datë 02.04.2009; nr. 23, datë 23.07.2009 dhe nr. 49, datë 29.09.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 23, datë 08.06.2007; nr. 34, datë 25.07.2011 dhe nr. 6, datë 26.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vëren se në të gjitha shkallët e gjykimit kërkuesit, nëpërmjet mbrojtësit të tij, i është dhënë mundësia për t'u njohur dhe për të debatuar mbi të gjitha provat e paraqitura nga akuza, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat e tij në lidhje me çështjen. Kërkuesi i ka ngritur pretendimet e tij për mënyrën e marrjes së provave dhe vlefshmërisë së akteve procedurale përpara gjykatave të zakonshme, çka nënkupton se atij i është dhënë mundësia për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Këto pretendime jo vetëm që janë marrë në shqyrtim dhe atyre u është dhënë përgjigje me vendim të arsyetuar, por gjykatat kanë riparuar edhe shkeljet e konstatuara gjatë këtij gjykimi.

38. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se

pretendimi i kërkuesit për pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe provave të përdorura në gjykim është i pabazuar.

C. Për pretendimet e tjera

39. Kërkuesi pretendon se gjykatat kanë përdorur si provë një dialog mes tij dhe viktimës, por nuk është evidentuar se cili dëshmitar e dëgjoi atë. Lidhur me vërtetimin e faktit të vdekjes së shtetasit S.Y., gjykata bazohet në dokumentin e gjendjes civile dhe vendimin për dënimin e shtetasit Agron Yzeiraj, por nuk ka një akt procedural të marrë si provë në gjykim për ta vërtetuar këtë. Po ashtu, ai pretendon se vendimet janë bazuar në analogji. Meqenëse kërkuesi është dënuar për veprën penale të vrasjes, gjykatat aludojnë se kjo vrasje duhet të jetë bërë me armë dhe pse nuk është gjetur një të tillë. Më tej, gjykatat aludojnë se kërkuesi është fajtor meqenëse viktimja është dënuar për vrasjen e babait të tij.

40. Gjykata në jurisprudencë konstante ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjeve konkrete, si dhe mënyra e interpretimit të ligjit janë çështje që nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Gjykata vlerëson nëse gjykatat e zakonshme kanë respektuar të drejtën e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes, por ajo nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 1, datë 20.01.2014 dhe nr. 22, datë 16.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuesit nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me çështje që i përkasin themelit (vlerësim provash dhe provueshmëri të pretendimeve të palëve) dhe, për pasojë, ato nuk mund të merren në shqyrtim në këtë gjykim kushtetues.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe, për pasojë, kërkesa duhet të rrëzohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo.

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Vladimir Kristo.

MENDIM PAKICE

1. Jam kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

2. Shumica, pasi ka vlerësuar të gjitha pretendimet e kërkuarit Gramoz Yzeiraj, ka arritur në përfundimin se nuk është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës (*shih paragrafin 42 të vendimit*), dhe ka rrëzuar kërkesën e tij. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret, pretendimi i kërkuarit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë është i bazuar dhe, si i tillë, duhej vendosur pranimi pjesërisht i kërkesës.

3. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë, lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/“P” të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet*

nr. 4, datë 28.02.2006 dhe nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë.

4. Gjykata, gjithashtu, në jurisprudencën e saj është shprehur se detyra e saj është të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i drejtë. Në këtë drejtim, ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj (...) (*shih vendimet nr. 7, datë 28.02.2000; nr. 25, datë 28.10.2005 dhe nr.40, datë 22.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjithsesi, jam i mendimit se çështje të kësaj natyre duhen shqyrtuar rast pas rasti duke evidentuar veçoritë e secilës prej tyre. Në rastin në shqyrtim, sikurse konstaton edhe shumica, në vitin 2002 ka filluar procedimi penal ndaj të tre shtetasve: Agron, Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim. Çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila në rigjykimin e çështjes, edhe pse duhet të gjykonte për një vepër penale të kryer në bashkëpunim, me vendimin nr. 79, datë 28.03.2006, ka vendosur të vazhdojë gjykimin për njërin prej tyre (të pandehurin Agron Yzeiraj) dhe t’i kalojë prokurorisë aktet e procedimit penal në ngarkim të të pandehurve të tjerë (Gramoz dhe Ilir Yzeiraj). Pas kryerjes së hetimeve, në datën 30.01.2007 çështja është dërguar sërish për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për shtetasit Gramoz dhe Ilir Yzeiraj, të cilët janë dënuar, me vendimin nr. 255, datë 30.06.2008, ndër të tjera, për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, në vendimin nr. 32, datë 22.01.2010, që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nr. 255, datë 30.06.2008, lidhur me mekanizmin dhe rrethanat e kryerjes në bashkëpunim të veprës penale i referohet edhe vendimit nr. 79, datë 28.03.2006, të lartpërmendur, që i përket të pandehurit Agron Yzeiraj.

7. Në zbatim të parimit të drejtësisë në



caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të sanksionuar nga neni 1/“c” i Kodit Penal (KP), lidhur me veprat penale të kryera në bashkëpunim, në caktimin e dënimit për bashkëpunëtorët, sipas nenit 27 të KP-së, gjykata duhet të mbajë parasysh shkallën e pjesëmarrjes së secilit dhe rolin e luajtur në kryerjen e veprës penale.

8. Pra, në mënyrën e caktimit të dënimit dhe të individualizimit të tij, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të argumentojnë, krahas elementeve të përcaktuara nga neni 47 i KP-së (rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese), në mënyrë të veçantë për veprat penale të kryera në bashkëpunim, edhe rolin që secili prej bashkëpunëtorëve ka pasur në kryerjen e veprës penale dhe shkallën e pjesëmarrjes të tyre në kryerjen e saj.

9. Në gjykimin tim, individualizimi i drejtë i dënimit lidhet drejtpërdrejt me parimin e barazisë së armëve, kontradiktoritetit dhe mbrojtjes së të pandehurit, të cilat, veçanërisht në procesin penal, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Sikurse ka theksuar Gjykata, synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet nr. 19, datë 12.06.2003 dhe nr. 19, datë 18.09.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me parimin e barazisë së armëve, Gjykata mban qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (*shih vendimet nr. 19, datë 18.09.2008 dhe nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Nga sa më lart, në rastin në shqyrtim çmuj se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ishte e detyruar të gjykonte në një çështje të vetme të gjithë të pandehurit e akuzuar për bashkëpunim në kryerjen e veprës penale, duke respektuar kështu parimet themelore kushtetuese të lartpërmendura për procesin e rregullt ligjor, të cilat karakterizojnë procesin penal. Në këtë drejtim Gjykata e Lartë, në funksion të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e juridiksionit

më të ulët, duhej të korigjonte shkeljet e konstatuara në shkallët e tjera të gjykimit.

11. Si përfundim, vlerësoj se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhej të shfuqizohej.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka vlerësuar, ndër të tjera, se pretendimet e kërkuarit, për sa i përket referencës së gjykatës në vendimin e dënimit të shtetasit A.Y. dhe mbështetjes së saj në analogji në vendimet gjyqësore, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues. Sipas saj, këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me çështje që i përkasin themelit (vlerësim provash dhe provueshmëri të pretendimeve të palëve) dhe, për pasojë, ato nuk mund të merren në shqyrtim në këtë gjykim kushtetues (*shih parag. 39 dhe 41 të vendimit*).

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës dhe në këtë çështje u qëndroj të njëjtave argumente të paraqitura në mendimin e pakicës për çështjen me kërkuar Fatmir Maliqin. Duke iu referuar pretendimeve të ngritura në kërkesë dhe akteve të dosjes gjyqësore, çështja paraqet probleme që lidhen me respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe Gjykata duhej të ishte ndalur edhe në vlerësimin nëse është cenuar apo jo kjo e drejtë e kërkuarit.

4. Parimi i prezumimit të pafajësisë, i interpretuar në jurisprudencën e Gjykatës, referuar edhe standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ, kërkon që deklarimi i fajësisë të së pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi, asnjë masë, që barazohet me dënimin, nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.



5. Sipas GJEDNJ-së, parimi i prezumimit të pafajësisë, i parë si një garanci procedurale në kontekstin e një procesi penal, imponon kushte në lidhje me, *inter alia*, deklarimin paraprak nga gjykatat ose zyrtarë të tjerë publikë për fajësinë e të pandehurit. Neni 6 § 2 i Konventës ka qëllim të parandalojë dëmtimin e një gjykimi të drejtë nga deklarimet paragjyquese të lidhura ngushtë me procedimin. Edhe në mungesë të përfundimeve formale mjafton të ketë një arsyetim që sugjeron se gjykatat e konsiderojnë të pandehurin fajtor. Neni 6 § 2 i Konventës mund të zbatohet kur një vendim gjykate, i dhënë në procedime që nuk janë drejtuar kundër kërkuesit në cilësinë e tij si “i akuzuar”, por që, megjithatë, kanë lidhje me procedimet penale që në të njëjtën kohë janë duke u kryer ndaj tij, përfshin një vlerësim të parakohshëm të fajësisë së tij. Parimi i prezumimit të pafajësisë, në teori, mund të cenohet edhe në rast të deklarimeve të parakohshme për fajësinë e një subjekti, të bëra me qëllim të një gjykimi kundër të pandehurve të tjerë, të gjykuar veçmas. Konventa, si një instrument për mbrojtjen e individit, kërkon që dispozitat e saj të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë që ta bëjnë këtë mbrojtje praktike dhe efektive dhe kjo zbatohet edhe në lidhje me nenin 6 § 2 të saj (*shih paragrafët 41- 42 të vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Karaman kundër Gjermanisë*).

6. Në rastin konkret rezulton se tre të pandehur janë akuzuar si bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale dhe ata janë dërguar për gjykim së bashku. Veçimi i çështjes ka ardhur si pasojë e të metave procedurale në gjykim, të cilat kanë bërë që organi i akuzës të kërkonte kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve ndaj dy prej tyre, kërkesë që është pranuar nga gjykata. Kjo e fundit në dispozitivin e vendimit nr. 79/2006 është shprehur për deklarimin fajtor të shtetasit A.Y., kurse për dy të pandehurit e tjerë, Gramoz dhe I.Y., aktet i janë kthyer prokurorisë. Në datën 30.01.2007 çështja është dërguar sërish për shqyrtim në gjykatë dhe në përfundim të gjykimit edhe këta dy shtetas janë deklaruar fajtorë në bazë të të njëjtave provave. Duke qenë se jemi përpara të njëjtës ngjarje dhe veprimtari kriminale, pjesë të vendimit nr. 79/2006, të cilat i referohen përfshirjes së kërkuesit si bashkëpunëtor në këtë veprimtari, kanë qenë

gjithashtu objekt i gjykimit penal që pritej të zhvillohej ndaj tij dhe, për pasojë, kishin një lidhje të drejtpërdrejtë me këtë gjykim. Përfundimet e gjykatës, të shprehura në vendimin nr. 79/2006, kanë pasur një efekt në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, për sa kohë ky vendim ka qenë pjesë e dosjes gjyqësore dhe është vlerësuar si provë nga gjykata. Në këto kushte, bazuar në standardet e jurisprudencës së GJEDNJ, në lidhje me çështje komplekse, me disa të pandehur të gjykuar veçmas, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë mund të ngrihet në çështjen në shqyrtim.

7. Për të vlerësuar nëse kemi cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi, u referohem sërish standardeve të vendosura nga GJEDNJ në çështjen e sipërcituar, *Karaman kundër Gjermanisë*. Në zbatim të nenit 6 § 2 të Konventës, parimi i prezumimit të pafajësisë konsiderohet i cenuar nëse një vendim gjyqësor reflekton një opinion se personi i akuzuar është fajtor përpara se fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin. Gjithsesi, një dallim thelbësor duhet bërë ndërmjet një deklarimi se dikush thjesht dyshohet që ka kryer një vepër penale dhe një deklarimi të qartë, në mungesë të një dënimi përfundimtar, se një individ ka kryer veprën penale në fjalë. GJEDNJ, në vendimin e referuar më sipër, ka theksuar se në procedime penale komplekse që përfshijnë disa persona, të cilët nuk mund të gjykohen së bashku, referencat nga gjykatat lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë, të cilët mund të gjykohen veçmas më vonë, mund të jenë të domosdoshme për vlerësimin e fajësisë së atyre që janë duke u gjykuar. Gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e rëndësishme të çështjes për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur. Kjo zbatohet edhe ndaj fakteve që lidhen me përfshirjen e personave të tretë. Megjithatë, nëse është e nevojshme që fakte të tilla të paraqiten në vendim, gjykata duhet të evitojë të japë më shumë informacion nga sa është e nevojshme për vlerësimin e përgjegjësisë penale vetëm të atyre personave që janë të pandehur në gjykimin që zhvillohet para saj (*shih paragrafët 63-64 të vendimit*).

8. Duke iu rikthyer rastit konkret, vlerësoj se vendimi nr. 79/2006 i Gjykatës së Rrethit



Gjyqësor Fier, pasi ka bërë një vlerësim të rrethanave të çështjes, është shprehur edhe për fajësinë e kërkuesit, pavarësisht se kësaj gjykate i ishte kërkuar kthimi i akteve për vazhdimin e hetimeve në lidhje me kërkuesin. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që referimet nga gjykata, në lidhje me persona të tjerë, që dyshohen të përfshirë në ngjarjen kriminale, duhet të kufizohen në një përshkrim neutral të fakteve dhe të çështjes. Çdo referencë duhet të jetë e kufizuar, pa u ndalur në vlerësime të përgjegjësisë penale të personave që nuk janë të pandehur në gjykimin në fjalë.

9. Në kuptim të nenit 193/5 të KPP referimet në një vendim të formës të prerë mund të bëhen për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, pra për të përcaktuar rrethanat e çështjes, në mënyrë që më tej gjykata të gjykojë mbi kontributin individual të të akuzuarit në kryerjen e veprës penale. Edhe pse kjo është veçanërisht e nevojshme në rast të lidhjeve faktike mes dy procedimeve të realizuara në mënyrë të ndarë, të tilla prova duhen vlerësuar nga gjykata në unitet me provat e tjera të administruara në proces. Për më tepër, kërkuesi, në kushtet kur gjykata i ka kthyer aktet për vazhdimin e hetimeve në lidhje me të nuk ka pasur asnjë mundësi që të debatojë mbi provat apo të kundërshtojë vendimin gjyqësor, në të cilin gjykata është shprehur mbi përfshirjen dhe rolin e tij në kryerjen e veprës penale.

10. Në kundërshtim me standardet e mësipërme, arsyetimi i vendimit nr. 79/2006, i parë në tërësinë e tij, të krijon përshtypjen se kërkuesi është prezumuar fajtor për shkak të rolit të tij të përcaktuar në atë gjykim, si bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale. Konkretisht, gjykata, edhe pse e pranoi kërkesën për kthimin e akteve për kryerje të hetimeve të mëtejshme ndaj kërkuesit, në vendimin nr. 79/2006 shprehet se të gjithë të pandehurit janë fajtorë dhe e kanë kryer së bashku veprën penale. Arsyetimi i gjykatës shkon përtej një përshkrimi të thjeshtë të fakteve dhe nuk kufizohet në një përshkrim neutral të veprimeve ku përfshihet kërkuesi, por me një gjuhë të qartë ndalet në analizën e elementeve objektive dhe subjektive të veprës, duke nënvizuar përfshirjen e tij në këtë veprimtari kriminale. Për pasojë, vlerësimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në vendimin

nr. 79/2006, të analizuara në tërësinë e tyre, e lënë të nënkuptuar deklarinimin e fajësisë të kërkuesit edhe pse formalisht në vendim nuk ka asnjë masë dënimi ndaj tij.

11. Megjithëse vendimi nr. 79/2006 nuk ka pasur ndonjë efekt detyrues për gjykatën që ka shqyrtuar çështjen penale kundër kërkuesit, përfundimet e tij janë marrë të mirëqena apriori nga kjo gjykatë. Siç është përmendur më sipër, në çështjet që janë të ndërlidhura, referencat reciproke në vendimet gjyqësore janë të paevitueshme, por kjo nevojitet që të bëhet vetëm me qëllim të përcaktimit të mekanizmit të ngjarjes, që më pas të saktësohet edhe roli i secilit bashkautor. Në rastin në shqyrtim vihet re se kthimi i akteve të çështjes organit të akuzës ka qenë vetëm formal, për shkak të korigjimit të të metave procedurale të dosjes hetimore, pasi nuk rezulton që organi i akuzës të ketë bërë hetim të ri për çështjen. Dosja ka shkuar në gjykim në gjendjen që ka qenë dhe nuk ka asnjë veprim të ri hetimor të kryer. Për më tepër, gjykata u është referuar deklarinimeve të dhëna nga shtetasi A.Y. dhe vendimit nr. 79/2006 që ka shpallur fajtor këtë të fundit, pa bërë një vlerësim të plotë të çështjes, por duke marrë të mirëqena të gjitha përfundimet dhe analizën e kryer në vendimin nr. 79/2006, jo vetëm në lidhje me rrethanat e çështjes, por edhe me rolin e kërkuesit. Gjykata kishte detyrimin të analizonte në mënyrë tërësore të gjitha rrethanat e çështjes, veprimet ose mosveprimet konkrete të kërkuesit për të arritur në një konkluzion të bazuar në lidhje me përfshirjen e tij në veprimtarinë kriminale. Rrjedhimisht, vlera që vendimi nr. 79/2006 ka pasur në gjykim dhe mënyra se si gjykata ka analizuar përfundimet e arritura në të në lidhje me kërkuesin janë të tilla që mund të konsiderohen si një deklarinim paraprak i fajësisë së tij.

12. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, vlerësoj se në procesin e zhvilluar në ngarkim të kërkuesit gjykatat nuk kanë respektuar të drejtën e tij për t'u prezumuar i pafajshëm, si element përbërës i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, në kushtet kur procesi gjyqësor i zhvilluar ndaj kërkuesit është i cenueshëm, Gjykata duhet ta pranonte kërkesën.

Anëtar: Sokol Berberi



VENDIM
Nr. 10, datë 26.2.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Sokol Berberi	anëtar i	“ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 28.10.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen me nr. 44/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Ledina Mandia, z. Piro Ahmetaj dhe z. Ilia Jolldashi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Alban Brati dhe z. Geldjon Hysolli.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga z. Artur Metani dhe znj. Yllka Lamçe.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 12, 92, 131/“a”, 134/1/“a”, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 45 dhe 49/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

dhe Këshillit të Ministrave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) në datën 26.06.2014 ka miratuar ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 64/2014). Kërkuari, pasi ka vlerësuar se ky ligj cenon Kushtetutën, me dekretin nr. 8633, datë 18.07.2014, e ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend. Kuvendi e ka rrëzuar këtë dekret të kërkuarit dhe ligji nr. 64/2014 ka hyrë në fuqi në datën 14.08.2014.

II

2. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 64/2014 dhe pezullimin e zbatimit të tij. Ai ka pretenduar se ligji nr. 64/2014 ka cenuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, pasi ka shkelur dispozitat kushtetuese që përcaktojnë funksionet dhe kompetencat e Presidentit të Republikës (Presidenti) si Komandant i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (FA). Ligji nr. 64/2014 i heq Presidentit kompetenca që ai i gëzon si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, të cilat burojnë nga Kushtetuta (nenet 86, 168/2 dhe 169) e janë në përputhje me rolin e tij asnjans dhe standardet e përcaktuara për vendet anëtare të NATO-s. Më konkretisht, sipas kërkuarit:

2.1 Në nenin 9, pika 2, parashikohet se Presidenti në kohë lufte i drejton FA-të nëpërmjet Komandantit të FA-ve. Në ndryshim nga ligji i mëparshëm nr. 8671, datë 26.10.2000, i ndryshuar, ligji nr. 64/2014 objekt shqyrtimi parashikon ndërmjetësimin si të vetmen mënyrë drejtimit të FA-ve dhe jo ushtrimin e drejtpërdrejtë të kësaj kompetence nga Presidenti, në tejkallim të Kushtetutës dhe parimit të hierarkisë së normave.

2.2 Neni 12, shkronja “b”, duke parashikuar se “*Kryeministri emëron, liron ose shkarkon nga detyra (...) oficerët me grada madhore (...)*”, anashkalon Presidentin, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, nga procedura e emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të oficerëve me grada



madhore dhe cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

2.3 Neni 12, shkronja “ç” i njeh Kryeministrit kompetencën për të nxjerrë në rezervë ose lirim oficerët me grada madhore, ndërkohë që Kushtetuta në nenin 92, shkronja “d” i jep Presidentit kompetencën e përgjithshme në dhënien e gradave. Duke i dhënë Kryeministrit kompetencën për nxjerrjen në rezervë ose lirim të oficerëve me grada madhore, ky nen bie ndesh edhe me nenin 169, pika 3, të Kushtetutës, që parashikon se Presidenti emëron dhe shkarkon komandantët e forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore.

2.4 Në nenin 12, shkronjat “d” dhe “dh”, përcaktohet Kryeministri si autoriteti që miraton strukturën organizative, planin e vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, çka e bën të pamundur ushtrimin efektiv të kompetencës drejtuese të FA-ve nga ana e Presidentit.

2.5 Neni 13, pika 2, shkronja “n” parashikon se Ministri i Mbrojtjes “*delegon autoritetin e drejtimit operacional, ushtar-grup-skuadër-togë-kompani-batalion dhe të strukturave të njësuara me to në Forcën Ajrore dhe Forcën Detare, të komandat aleate me të cilat Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryejnë misionet të përbashkëta*”. Delegimi i një kompetence të tillë një autoriteti të huaj është një akt që duhet të kryhet nga Presidenti, si autoriteti fuqiptotë më i lartë hierarkik në drejtimin dhe komandimin e FA-ve.

2.6 Ligji nr. 64/2014 nuk parashikon instrumentet thelbësore me të cilat Presidenti ushtron funksionet e tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, konkretisht urdhra e udhëzime, duke e kthyer atë në një autoritet jofunksional.

2.7 Neni 13, pika 2, shkronja “e” i njeh Ministrit të Mbrojtjes kompetencën e emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të përfaqësuesve ushtarakë të Republikës së Shqipërisë në shtabet dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, si dhe atasheve ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në kundërshtim me nenin 92, shkronja “dh”, të Kushtetutës, që parashikon se Presidenti, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare.

2.8 Nenet 22 dhe 23 janë juridikisht të

panevojshme dhe precedente të rrezikshme për përdorimin e FA-ve përtej kornizës së përcaktuar në nenet 170-173, 175 dhe 176 të Kushtetutës. Neni 23/3, duke sanksionuar se gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore Kryeministri është drejtpërdrejt përgjegjës për drejtimin e FA-ve, përmes hierarkisë së drejtimit e të komandimit, shmang Presidentin dhe dublon Kushtetutën.

3. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka parashtruar se:

3.1 Në lidhje me pezullimin e ligjit objekt shqyrtimi nuk jemi përpara kushteve ligjore që përcakton neni 45 i ligjit nr. 8577/2000 dhe vetë kërkuesi nuk ka dhënë arsye ligjore e faktike që mund të justifikonin pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 64/2014.

3.2 Çështja e ngritur nga kërkuesi, pavarësisht se është paraqitur në kuadrin e papajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën, në vlerësimin e Kuvendit ka të bëjë me një mosmarrëveshje kompetencash dhe bie në fushëveprimin e nenit 131, shkronja “ç”, të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata duhet të shprehet mbi legjitimitetin e kërkuesit në kuptim të plotësisht të kushteve të përcaktuara nga ligji organik dhe jurisprudenca e Gjykatës.

3.3 Ligji objekt shqyrtimi është miratuar nga Kuvendi në ushtrim të funksionit të tij legjislativ të parashikuar në nenet 7, 81-85 të Kushtetutës dhe në respekt të plotë të neneve 12, 92/“d”, 168/2 dhe 169 të Kushtetutës. Neni 168/2 i Kushtetutës përbën një dispozitë me karakter deklarativ, që ka si qëllim deklarimin dhe sanksionimin e statusit të Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, ndërsa vetë statusi përcaktohet nga tërësia e kompetencave që Kushtetuta i ka njohur Presidentit në ushtrim të këtij statusi.

3.4 Asnjë prej kompetencave që Kushtetuta i ka njohur Presidentit, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, nuk cenohet nga ligji objekt kërkese. Vetë neni 169/4 i Kushtetutës ia ka nënshtruar rezervës ligjore caktimin e kompetencave të Presidentit të Republikës. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Kompetencat që Kushtetuta i ka parashikuar shprehimisht në nenet 92/d dhe 169, Presidenti i ushtron sipas rregullimit të ligjvënësit



dhe nëpërmjet/me propozim të Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

3.5 Neni 9/2 i ligjit nr. 64/2014 është rrjedhojë logjike e nenit 169/2 të Kushtetutës dhe formulimi i këtij neni nuk e shmang Presidentin nga ushtrimi i rolit të tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve në kohë lufte.

3.6 Në lidhje me cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nga neni 12/“b” i ligjit nr. 64/2014, ky pretendim i kërkuesit nuk qëndron, pasi sipas jurisprudencës së Gjykatës garantimi i këtij parimi arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që sigurojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve. Kuvendi nënvizon se asnjë zgjidhje apo rregullim kushtetues nuk e parashikon Presidentin si hallkë procedurale në procesin e lirit dhe të shkarkimit të oficerëve me grada madhore.

3.7 Për sa i përket pretendimit në lidhje me nenin 13, pika 2, shkronja “n”, të ligjit nr. 64/2014, Kuvendi thekson se ky rregullim gjen zbatim në ligjin nr. 9363, datë 24.03.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, i ndryshuar, ku përcaktohet autoriteti përgjegjës për delegimin dhe autorizimin e kompetencave ndaj FA-ve, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3.8 Pretendimi i kërkuesit se ligji nr. 64/2014 nuk parashikon urdhra dhe udhëzime, si instrumente thelbësore me anë të së cilave Presidenti mund të ushtrojë funksionet e tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, nuk është i bazuar, pasi sipas nenit 93 të Kushtetutës, Presidenti, në zbatim të kompetencave të tij kushtetuese, nxjerr vetëm dekrete.

4. Subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar se:

4.1 Kërkesa e pezullimit të ligjit nr. 64/2014 nuk duhet pranuar, pasi ky ligj nuk cenon asnjë interes shoqëror apo individual dhe nuk sjell pasoja kritike të parikuperueshme të mosushtimit të kompetencave të Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar kriteret

për vendosjen e masës së pezullimit duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe nenit 186 të Traktatit të Komunitetit Europian, kriteret të cilat nuk janë përmbushur në rastin konkret.

4.2 Ligji nr. 64/2014, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, garanton të gjitha kompetencat që Presidentit i janë dhënë nga Kushtetuta dhe ruan balancën e ndarjes e pushteteve dhe të autoriteteve në raport me FA-të.

4.3 Ndarja e pushteteve mbi FA-të është rezultat i sistemit parlamentar, ndaj edhe pushteti i drejtimit qëndron jashtë FA-ve, ndërsa komandimi i tyre është vendosur nga brenda organizimit të tyre. Siç ndodh përgjithësisht në republikat parlamentare, edhe Kushtetuta e Shqipërisë ka parashikuar një kryetar shteti joqeverisës. Në bazë të Kushtetutës, Kuvendi, Presidenti dhe ekzekutivi marrin pjesë në drejtimin e FA-ve në bazë të kompetencave kushtetuese përkatëse të tyre, duke siguruar një sistem kontrollesh dhe ekuilibrash që parandalon ushtrimin e pushtetit të pakufizuar vetëm nga një degë e pushtetit.

4.4 Pretendimi i kërkuesit, në lidhje me nenin 9/2 të ligjit nr. 64/2014, nuk ka bazë kushtetuese, pasi ky nen nuk bën gjë tjetër veçse riafirmon kompetencën që neni 169 i Kushtetutës i ka dhënë Presidentit për drejtimin e FA-ve në kohë lufte.

4.5 Neni 12/“b” i ligjit nr. 64/2014 nuk prek kompetencën që Kushtetuta, në nenin 169, pikat 2 dhe 3, i ka rezervuar Presidentit. Në kuptim të neneve 168 dhe 169 të Kushtetutës, kompetenca e drejtimit civil të FA-ve është kompetencë ekzekutive dhe ushtrohet në kohë paqjeje nga Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes.

4.6 Pretendimi për nenin 12, shkronjat “d” dhe “dh”, është i pabazuar, pasi kërkuesi nuk ka përmendur asnjë dispozitë konkrete kushtetuese, e cila të jetë shkelur nga dispozitat e kundërshtuara. Kalimi i kësaj kompetence te Kryeministri është në linjë me një sërë kompetencash të tjera të ekzekutivit.

4.7 Për sa i përket nenit 12, shkronja “ç”, pretendimi që lidhet me këtë nen është i pambështetur, për arsye se nxjerrja në rezervë ose lirim e ushtarakëve është proces i ndryshëm nga dhënia e gradave. Përderisa Kushtetuta ka një rregullim të posaçëm për mënyrën e



shkarkimit të komandantëve të forcave Ajrore, Tokësore dhe Detare, është e qartë se formula e parashikuar nga ligji konkret për nxjerrjen në lirim ose rezervë të ushtarakëve me grada madhore nuk aplikohet për ta.

4.8 Lidhur me dispozitën e nenit 13, pika 2, shkronja “n”, që përcakton delegimin e autoritetit të drejtimit operacional të FA-ve të komandat aleate me të cilat FA-të e Republikës së Shqipërisë kryejnë misione të përbashkëta, kërkuesi nuk ka përmendur asnjë dispozitë konkrete kushtetuese që të ndalojë dhënien me ligj të këtij delegimi.

4.9 Pretendimi i kërkuesit se ligji nr. 64/2014 nuk parashikon instrumente, si urdhra e udhëzime, për ushtrimin e funksioneve të Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA, është i pabazuar, pasi duke iu referuar nenit 93 të Kushtetutës, Presidenti nxjerr vetëm dekrete në zbatim të kompetencave të tij kushtetuese.

4.10 Nuk është i mbështetur as pretendimi i kërkuesit se neni 13, pika 2, shkronja “e”, bie ndesh me nenin 92/“dh” të Kushtetutës, për shkak se dispozita kushtetuese, të cilës i referohet kërkuesi, nuk mbulon edhe përfaqësuesit ushtarakë. Këta të fundit nuk janë përfaqësues fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë, por funksionarë të FA-ve që kryejnë funksione pranë shteteve aleate dhe organizatave ndërkombëtare me karakter ushtarak.

4.11 Edhe pretendimet për nenet 22 dhe 23 të ligjit konkret, që sipas kërkuesit anashkalojnë Presidentin në situatën e gjendjes së fatkeqësisë dhe asaj të jashtëzakonshme, nuk janë të bazuara. Kërkuesi nuk ka përmendur ndonjë dispozitë konkrete kushtetuese ku i bazon këto pretendime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi

5. Kërkuesi ka kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit objekt kërkesë, duke argumentuar se zbatimi i ligjit dobëson pozitën dhe cenon kompetencat e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë e kombëtarë, si dhe cenon standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare në fushën e drejtimit të FA-ve.

6. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit të paraqitur nga kërkuesi dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Gjykata në datën 09.10.2014 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Sipas nenit 131, shkronja “a”, të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Për sa i përket kërkuesit, bazuar në nenin 134, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ai legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën sipas objektit të kërkesës. Kërkuesi përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si i tillë ka të drejtë të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit objekt shqyrtimi.

C. Për themelin e çështjes

8. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi para kësaj Gjykate i përqendron pretendimet e tij në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë të Presidentit të Republikës, lidhur me kompetencat e tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Gjykata e çmon të nevojshme që në funksion të analizës së pretendimeve të ngritura, të sqarojë fillimisht rregullimet kushtetuese, konkretisht nenet 12, 89, 90, 92, 168 dhe 169 të Kushtetutës, si dhe rolin e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve.

9. Kompetencat e Presidentit, bazuar në teknikën legislative të ndjekur nga hartuesit e Kushtetutës, nuk janë të renditura njëra pas tjetrës, por janë të shpërndara nëpër krerë të ndryshëm të Kushtetutës (*shih Debatë Kushtetues, vëllimi 1, Tiranë 2006, fq. 320-321*). Hartuesit e Kushtetutës e konceptuan rolin e tij si atë të arbitrit, të moderatorit të pushteteve e të rregullatorit, si një figurë neutrale, me një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, në balancimin e pushteteve, si dhe në kryerjen e funksioneve të tyre respektive (*shih Debatë Kushtetues, vëllimi 2, Tiranë 2006, fq. 425; vëllimi 1, fq. 319-320*). Nga



ekspertët kushtetues u vlerësua, gjithashtu, edhe nevoja për ta përshtatur institucionin e Presidentit me regjimin parlamentar dhe vendosjen e një qeverie më të përgjegjshme dhe më të fortë në themel të tij (shih *Debati Kushtetues*, vëllimi 1, fq. 319).

10. Në aspektin e përgjithshëm, Gjykata, për sa i përket pozicionit kushtetues të Presidentit, ka theksuar se kompetencat e tij janë përcaktuar në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore (*shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, prg. 34*). Sipas neneve 89, 90/1 dhe 94 të Kushtetutës, Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private; nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij dhe nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të.

11. Neni 168/2 i Kushtetutës parashikon se Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Në këtë rol neni 169 i Kushtetutës i ka dhënë Presidentit kompetenca për: drejtimin e FA-ve nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes në kohë paqeje; emërimin dhe shkarkimin e Komandantit të FA-ve, me propozim të Kryeministrit; emërimin dhe shkarkimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozim të Kryeministrit, emërimin dhe shkarkimin e komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes. Ndërsa në pikën 4 të po këtij neni është sanksionuar se “*Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura, si dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj*”. Pra, siç shihet qartë,

Kushtetuta, në nenin 169 të saj, ka përcaktuar në mënyrë të shprehur disa kompetenca specifike të Presidentit në lidhje me FA-të, të cilat ai i ushtron nëpërmjet ose me propozim të Kryeministrit dhe/ose Ministrit të Mbrojtjes. Nga ana tjetër, Kushtetuta, referuar pikës 4 të nenit 169, ia ka rezervuar ligjit caktimin e kompetencave të Presidentit, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, duke nënkuptuar se “caktimi me ligj” bëhet për ato kompetenca të cilat nuk parashikohen shprehimisht në Kushtetutë. Hartuesit e Kushtetutës nuk e kanë përjashtuar mundësinë që Presidentit t’i jepen kompetenca në ligje të veçanta, por i rëndësishëm për ta ka qenë fakti që Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca pa ligj (*shih Debati Kushtetues, vëllimi 1, fq. 324-325*). Kushtetutëbërësi në rastin konkret ka zgjedhur t’ia delegojë ligjvënësit caktimin e kompetencave të Presidentit për ushtrimin e rolit të tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve.

12. Gjykata, bazuar në vështrimin sistematik të dispozitave kushtetuese të lartpërmendura, çmon se autoriteti drejtues i Presidentit mbi FA-të është ngushtësisht i lidhur me konceptin e kontrollit civil dhe demokratik të FA-ve. Në këtë kuptim është shprehur edhe Kushtetuta në nenin 12/2 të saj, sipas të cilit FA-të ruajnë asnjëherë në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil. Presidentit i është dhënë roli i Komandantit të Përgjithshëm të FA-ve për shkak të pozitës së tij si organ jopolitik dhe përfaqësues i unitetit të popullit, në funksion të garantimit të parimeve themelore kushtetuese në sferën e mbrojtjes. Ky rol i tij është i një lloji të veçantë, pasi nuk ka karakter thjesht simbolik e, megjithatë, nuk është as një komandë e natyrës së mirëfilltë ushtarake. Për shkak të pozicionit të tij *super partes*, Presidenti nuk mund të jetë komandant efektiv ushtarak i FA-ve, por, nga ana tjetër, Gjykata thekson se roli i tij kushtetues si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve nuk mund të konsiderohet si honorifik. Në këtë kontekst, edhe pse nga pikëpamja hierarkike Presidenti është Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, ai nuk mund të ushtrojë autoritet komandues të llojit tekniko-ushtarak mbi FA-të (*kupto iniciativa/urdhra ushtarake*), pasi në të kundërt ai do të kryente një funksion tjetër publik dhe do të duhej të mbante përgjegjësi për aktet e kryera. Kjo do të binte



ndesh me nenin 89 të Kushtetutës, që parashikon se Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, dhe me nenin 90/1, sipas të cilit Presidenti nuk është përgjegjës për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij.

13. Ndërkohë, Kushtetuta i ka atribuar Presidentit një funksion garantues në fushën e sigurisë kombëtare (neni 168/3) dhe i ka dhënë kompetenca për emërimin/shkarkimin e funksionarëve të lartë komandues të FA-ve, konkretisht: Komandantit të FA-ve, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore (neni 169 i Kushtetutës). Emërimi/shkarkimi i këtyre funksionarëve bëhet nga Presidenti me propozim të ekzekutivit (Kryeministrit apo ministrit të Mbrojtjes), çka nënkupton se Presidenti ushtron një lloj kontrolli mbi propozimin e ekzekutivit, që ka për qëllim të balancojë përzgjedhjen e ushtarakëve të lartë komandues të FA-ve. Padyshim akses në informacionin për sigurinë kombëtare dhe çështjet e politikave të mbrojtjes, nëpërmjet Këshillit të Sigurimit Kombëtar, dhe kontrolli që ushtron në procesin e emërimit/shkarkimit të funksionarëve ushtarakë komandues të FA-ve i janë dhënë Presidentit në kuadër të rolit të tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Në këtë pozicion ai garanton respektimin e standardeve kushtetuese në fushën e mbrojtjes dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Ç. *Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 64/2014*

14. Sipas nenit 9, pika 2 të ligjit nr. 64/2012 “Presidenti i Republikës në kohë paqeje e ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura”. Kërkuesi ka pretenduar se kjo dispozitë, duke parashikuar drejtimin e FA-ve në kohë lufte nga ana e Presidentit nëpërmjet Komandantit të FA-ve, në ndryshim nga ligji i mëparshëm, nr. 8671/2000, i ndryshuar, sanksionon ndërmjetësimin si të vetmen mënyrë drejtimi të FA-ve në tejkallim të Kushtetutës dhe parimit të hierarkisë së normave. Kushtetuta në asnjë rast nuk ka ndaluar që në kohë lufte drejtimi i FA-ve të ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Presidenti.

15. Neni 168/2 i Kushtetutës parashikon se Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i FA-ve. Në kohë paqeje ai ushtron drejtimin e FA-ve nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte emëron dhe shkarkon Komandantin e FA-ve me propozim të Kryeministrit (neni 169, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës). Në vështrim të këtyre dispozitave është e qartë se Kushtetuta në tekstin e saj parashikon në mënyrë të shprehur ushtrimin nga kërkuesi të kompetencës së drejtimit të FA-ve me ndërmjetësim në kohë paqeje, konkretisht nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes. Ndërsa në kohë lufte, Kushtetuta, ndryshe nga dispozita e ligjit objekt shqyrtimi, nuk parashikon shprehimisht drejtimin e FA-ve nga kërkuesi me ndërmjetësim. Jo vetëm kaq, por ajo nuk përcakton asnjë mënyrë specifike të drejtimit të FA-ve nga kërkuesi në kohë lufte.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka nënvizuar se “atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla (...) atje ku nuk është shprehur (shih vendimet nr. 25, datë 15.12.2008; nr. 29, datë 09.11.2005 dhe 212, datë 29.12.2002 të Gjykatës Kushtetuese). Ajo ka ritheksuar se “për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohe duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës” (shih vendimin nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se ligjvënësi nuk është kufizuar vetëm në referimin te normat kushtetuese që parashikojnë kompetencat e Presidentit në lidhje me FA-të. Në vlerësimin e saj, dispozita ligjore e nenit 9, pika 2, të ligjit 64/2014 nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por e tejkallon Kushtetutën, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Për më tepër, ky tejkallim cenon edhe parimin e shtetit të së drejtës, të shprehur me hierarkinë e normave dhe përparësinë e Kushtetutës, në raport me normat e tjera ligjore.

18. Për sa më sipër, Gjykata çmon se shprehja “ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura”. që



përmban neni 9, pika 2, i ligjit nr. 64/2014, tejkalon Kushtetutën dhe cenon parimin e shtetit të së drejtës, ndaj duhet shfuqizuar⁴.

D. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12, shkronja “ç”, të ligjit nr. 64/2014.

19. Neni 12, shkronja “ç”, i ligjit nr. 64/2014 parashikon se “Kryeministri nxjerr në rezervë ose lirim, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore, me përjashtim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”. Kërkuesi pretendon se duke i njohur Kryeministrit kompetencën për të nxjerrë në rezervë ose lirim oficerët me grada madhore, ligji bie ndesh me nenin 92, shkronja “d”, të Kushtetutës, sipas të cilit dhënia e gradave është kompetencë e Presidentit. Ky rregullim ligjor i lë hapësirë të gjerë vlerësimi ekzekutiv në lidhje me sistemin e karrierës së oficerëve madhorë të FA-ve, duke cenuar parimin e asnjësisë politike të FA-ve, të vendosur nga neni 12/2 i Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuesi argumenton se lirimi/nxjerrja në rezervë e oficerëve me grada madhore nga Kryeministri do të passillte automatikisht shkarkimin e tyre nga detyra, çka bie në kundërshtim me nenin 169/3 të Kushtetutës, i cili ia jep Presidentit kompetencën e shkarkimit të komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore.

20. Sipas kuadrit kushtetues, Presidenti ka një rol të rëndësishëm në sistemin e karrierës ushtarake të oficerëve madhorë, pasi jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit (neni 92/“d”), emëron dhe shkarkon, me propozim të Kryeministrit, Komandantin e FA-ve dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe emëron dhe shkarkon, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, komandantët e forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore (neni 169, pika 2 dhe 3). Kushtetutëbërësi, në respektim të parimit të ndarjes e balancimit të pushteteve, si dhe parimit të asnjësisë politike të FA-ve, ka përfshirë në procesin e karrierës ushtarake Presidentin dhe ekzekutivin, për të shmangur kontrollin e këtij të fundit mbi këtë sistem karriere. Në bazë të nenit 17, të ligjit nr. 59/2014, datë 12.06.2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës

së Shqipërisë”, (ligji nr. 59/2014) “Gradat madhore u jepen oficerëve me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozim të Ministrit të Mbrojtjes; Gradat e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe Grada e Komandantit të Forcave të Armatosura në kohë lufte jepen me dekret të Presidentit të Republikës dhe me propozim të Kryeministrit”. Gradat madhore, sipas klasifikimit në forcat Tokësore, Detare dhe Ajrore, janë: gjeneral lejtnant admiral, gjeneral major nënadmiralet dhe gjeneral brigade kundëradmiral (neni 12 i ligjit nr. 59/2014).

21. “Dalja në rezervë/lirim” përbën një fazë të sistemit të karrierës ushtarake të përcaktuar në ligjin nr. 59/2014, që parashikon ndër të tjera se “oficeri me gradë madhore (...) nxirret në rezervë apo lirim, kur plotëson njërin nga këto kriterë: a) kur pas kalimit të kohës së qëndrimit në një gradë sipas pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji, nuk ka marrë gradën e radhës; b) kur nuk ka kuota të lira për konkurrim për gradën e radhës, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve” (neni 14). Efekti i menjëhershëm që prodhohet nga “dalja në rezervë/lirim” është ndërprerja e karrierës ushtarake aktive, sanksionuar në nenin 5, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 59/2014. Megjithatë çështja e “daljes në rezervë/lirim” nuk është e rregulluar nga Kushtetuta si procedurë ligjore, Gjykata vëren se ajo ndikon në karrierën ushtarake të komandantëve të forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, aspekte të së cilës, siç janë emërimi dhe shkarkimi, rregullohen nga Kushtetuta. Gjykata thekson se është pikërisht Presidenti që gëzon kompetenca kushtetuese për emërimin dhe shkarkimin, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, të komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, si oficerë me grada madhore. Dispozita ligjore objekt shqyrtimi i jep Kryeministrit kompetenca për nxjerrjen në rezervë/lirim të oficerëve me grada madhore, duke mos përjashtuar komandantët e forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore. Gjykata konstaton se Kushtetuta në nenin 169/3 ka përcaktuar Presidentin si organin përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, ndërsa ligji konkret në nenin 12/ç i ka dhënë kompetenca Kryeministrit për nxjerrjen në rezervë/lirim të së njëjtës kategori të oficerëve madhorë. Në vlerësimin e Gjykatës kjo krijon një situatë paqartësie, e cila mund të rezultojë në keqkuptime për sa u përket autoriteteve

⁴ Votuan kundër pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: S. Berberi, A.Xhoxhaj dhe B.Imeraj



shtetërore përgjegjëse të përfshira në procesin e karrierës ushtarake të oficerëve me grada madhore dhe kompetencat e tyre përkatëse në këtë proces. Gjithashtu, Gjykata vëren se neni 12/ç e lejon Kryeministrin të nxjerrë në rezervë/lirim oficerët me grada madhore, pra edhe komandantët e forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, me përjashtim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, ndërsa neni 12/b e ndalon Kryeministrin të lirojë komandantët e forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore.

22. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Gjykata sjell në vëmendje dhe rëndësinë e respektimit të parimit të sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se *“vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme”* (vendimi nr. 9, datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (vendimi nr. 36, datë 15.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese).

23. Nisur nga arsyetimi dhe standardet e mësipërme, Gjykata çmon se neni 12/“ç” i ligjit nr. 64/2014 nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe për këtë arsye duhet të shfuqizohet.

DH. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12/“d” të ligjit nr. 64/2014

24. Neni 12/“d” i ligjit nr. 64/2014 parashikon se Kryeministri miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, planin e vendosjes dhe të përhapjes së Forcave të Armatosura në kohë paqeje. Kërkuesi ka pretenduar se kjo dispozitë kufizon funksionin e tij, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, tejkalon Kushtetutën, për sa i takon funksionimit dhe drejtimit të FA-ve, si dhe cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve.

25. Sipas nenit 169/1 të Kushtetutës, Presidenti në kohë paqeje ushtron drejtimin e FA-ve nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes. Në mënyrë të qartë Kushtetuta ka përcaktuar se është kërkuesi, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, ai që ushtron drejtimin e FA-ve, në përputhje me pushtetin që vetë Kushtetuta i ka dhënë. Drejtimi i FA-ve ndërthur shumë aspekte që mund të jenë të natyrës politike, strategjike, ushtarake, operative, teknike ose thjesht administrative. Për këto arsye dhe nisur nga karakteristikat e veçanta që mbart pozicioni i Presidentit, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, kushtetutëbërësi ka përfshirë edhe ekzekutivin në procesin e drejtimit të FA-ve. Kjo i shërben koordinimit dhe konsultimit që Presidenti duhet të zhvillojë me ekzekutivin, si hallkë e domosdoshme për ushtrimin e kompetencës drejtuese të FA-ve. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, kërkuesi drejton FA-të, duke respektuar hierarkinë e autoriteteve të drejtimit e të komandimit të FA-ve, sipas kuadrit kushtetues. Autoriteti i tij drejtues shtrihet në disa plane, si: planifikimi strategjik, në funksion të zhvillimit të planeve ushtarake strategjike dhe planeve të veprimit, çështjet dhe objektivat e sigurisë kombëtare, programet dhe nevojat ushtarake të FA-ve, buxheti që i takon FA-ve, vendosja e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë ushtarake, vendosja për mobilizimin dhe për provat e gatishmërisë luftarake të njëjësive rezervë, regjimi dhe rregullat e gatishmërisë luftarake, si dhe rekomandimi i masave që duhet të marrë ekzekutivi në varësi të nevojave që kanë FA-të (*shih për më tepër nenin 9 të ligjit nr. 64/2014*).

26. Plani i vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, që u referohet dispozita ligjore konkrete, është aspekt organizativ i drejtimit të FA-ve me karakter strategjik. Gjykata vlerëson se Kushtetuta në nenin 169/1 është e qartë në rolin drejtues që i ka caktuar Presidentit, rol nga i cili ai nuk mund të përjashtohet, sidomos kur bëhet fjalë për aspekte të rëndësishme të drejtimit strategjik. Neni 12/“d” i ligjit nr. 64/2014 ia ka atribuuar Kryeministrit kompetencën për të miratuar, në bazë të propozimit të ministrit të Mbrojtjes, planin e vendosjes dhe të përhapjes së FA-ve në kohë paqeje, duke mos e përfshirë Presidentin në këtë aspekt. Në vlerësimin e Gjykatës, ky përjashtim tejkalon Kushtetutën, e



cila shprehimisht ka përcaktuar se autoriteti drejtues i FA-ve i takon Presidentit, i cili në kohë paqeje e ushtron nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

27. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se neni 12/d i ligjit nr. 64/2014 nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe, për rrjedhojë, duhet shfuqizuar⁵.

E. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 22/3 dhe 23/3 të ligjit nr. 64/2014.

28. Nenet 22/3 dhe 23/3 të ligjit nr. 64/2014 parashikojnë se gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Kryeministri është drejtpërdrejt përgjegjës për drejtimin e Forcave të Armatosura përmes hierarkisë së drejtimit e të komandimit. Kërkuesi ka argumentuar se nenet 22/3 dhe 23/3 i japin Kryeministrit kompetencë fuqiplotë dhe të drejtpërdrejtë në drejtimin e FA-ve në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përtej kornizës kushtetuese.

29. Kushtetuta në nenet 170, 173, 174 dhe 175 përcakton kompetencat dhe rregullat e ndërveprimit të organeve qendrore publike në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Këto kompetenca kanë të bëjnë kryesisht me vendosjen dhe zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme, vendosjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, si dhe me masat që merren dhe liritë e të drejtat, të cilat mund të kufizohen gjatë këtyre situatave të veçanta që prekin sigurinë kombëtare.

30. Presidenti, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve (neni 168/2 i Kushtetutës), gëzon, gjithashtu, një rol të veçantë garantues në fushën e sigurisë kombëtare. Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i Presidentit të Republikës (neni 168/3 i Kushtetutës), i cili kryesohet nga Presidenti i Republikës dhe thirret prej tij sa herë që e gjykon të nevojshme e sipas një rendi dite të përcaktuar (neni 10/2 i ligjit nr. 64/2014). Në kuptim të këtyre dispozitave kushtetuese, Presidenti nuk mund të shmanget nga ushtrimi i rolit të tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve në rastet e situatave të

jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë përfshirjen e FA-ve. Dispozita ligjore konkrete, duke ia ngarkuar Kryeministrit përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për drejtimin e FA-ve në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe gjendjes së fatkeqësisë natyrore, tejkalon Kushtetutën, e cila nuk parashikon në asnjë dispozitë të saj kompetencën e “drejtimit të drejtpërdrejtë” të FA-ve nga Kryeministri.

31. Nisur nga arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nenet 22/3 dhe 23/3 të ligjit nr. 64/2014 nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe si të tilla duhet të shfuqizohen.

Ë. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12, shkronja “b”, të ligjit nr. 64/2014

32. Neni 12, shkronja “b” parashikon se “Kryeministri emëron, liron ose shkarkon nga detyra, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, oficerët me grada madhore përveç atyre të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 9 të këtij ligji”. Kërkuesi pretendon se kjo dispozitë anashkalon Presidentin, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, nga procedura e emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të oficerëve me grada madhore dhe cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve.

33. Gjykata thekson se neni 169 i Kushtetutës parashikon kompetenca kushtetuese ekskluzive të Presidentit për emërimin dhe shkarkimin e: a) Komandantit të FA-ve, me propozim të Kryeministrit; b) Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozim të Kryeministrit; c) komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore, me propozim të ministrit të Mbrojtjes. Dispozita ligjore objekt shqyrtimi në mënyrë të shprehur, në përputhje me gjuhën e Kushtetutës (nenin 169), përjashton kompetencën e Kryeministrit për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të Komandantit të FA-ve, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të forcave Tokësore, Detare dhe Ajrore. Ky parashikim përjashtues, që përmban neni 12/b i ligjit 64/2014, në vlerësimin e Gjykatës është në harmoni të plotë me nenin 169 të Kushtetutës, duke mos cenuar kompetencat kushtetuese të Presidentit në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e kërkuesit për sa i përket papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12, shkronja “b”, të ligjit nr. 64/2014.

⁵ Votuan kundër pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: B. Dedja, S. Berberi, V. Tusha dhe B. Imeraj



F. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12, shkronja “dh”, të ligjit nr. 64/2014

34. Sipas nenit 12, shkronja “dh”, “Kryeministri miraton, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, strukturën organizative të Forcave të Armatosura”. Kërkuesi pretendon se ky parashikim ligjor e bën të pamundur ushtrimin efektiv të kompetencës drejtuese të FA-ve nga ana e Presidentit.

35. Në vlerësimin e Gjykatës, miratimi i strukturës organizative të FA-ve është një çështje e një natyre të mirëfilltë teknike, e rregulluar me ligj. Duke qenë një aspekt organizativ ushtarako-teknik, ligji ka përcaktuar ekzekutivin dhe jo Presidentin si autoritet përgjegjës për miratimin e kësaj strukture. Nisur nga ky këndvështrim dhe roli kushtetues i Presidentit, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, referuar *supra* në pikën “C”, Gjykata e çmon të pambështetur pretendimin e kërkuesit lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 12, shkronja “dh”, të ligjit nr. 64/2014⁶.

G. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 13, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 64/2014

36. Neni 13, pika 2, shkronja “e” i njeh Ministrit të Mbrojtjes kompetencën e emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të përfaqësuesve ushtarakë të Republikës së Shqipërisë në shtabet dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, si dhe atasheve ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë. Kërkuesi pretendon se ky nen bie në kundërshtim me nenin 92, shkronja “dh”, të Kushtetutës, që parashikon se Presidenti, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare.

37. Sipas nenit 92/“dh” të Kushtetutës, Presidenti, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare. Misionet diplomatike, bazuar në ligjin nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm” (ligji nr. 9095/2003), janë përfaqësi diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, që

drejtohen nga ambasadorët, si përfaqësues të plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera. Ambasadorët emërohen dhe lirohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Kryeministrit (neni 21/2 i ligjit 9095/2003). Ndërsa, për sa u përket atasheve ushtarakë, ata janë nëpunës të shërbimit të jashtëm, të cilët gëzojnë statusin e diplomatit me të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr. 9095/2003 (*shih për më tepër nenin 7 të Konventës së Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike të 18 prillit të vitit 1961*). Nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se Kushtetuta nuk i ka dhënë Presidentit kompetenca për emërimin, lirimin ose shkarkimin e përfaqësuesve ushtarakë/atasheve ushtarakë, por vetëm për emërimin dhe lirimin e përfaqësuesve të plotfuqishëm. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës pretendimi i kërkuesit se neni 13, pika 2, shkronja “e”, i ligjit nr. 64/2014, bie ndesh me Kushtetutën, është i pabazuar⁷.

GJ. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 13, pika 2, shkronja “n”, të ligjit nr. 64/2014

38. Sipas nenit 13, pika 2, shkronja “n”, Ministri i Mbrojtjes “delegon autoritetin e drejtimit operacional, ushtar-grup-skuadër-togë-kompani-batalion dhe të strukturave të njësuara me to në Forcën Ajrore dhe Forcën Detare, te komandat aleate me të cilat Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryejnë misione të përbashkëta”. Kërkuesi ka argumentuar se delegimi i një kompetence të tillë një autoriteti të huaj është një akt që duhet të kryhet nga Presidenti, si autoriteti fuqiplotë më i lartë hierarkik në drejtimin dhe komandimin e FA-ve.

39. Drejtimi operacional i FA-ve është një kompetencë e cila ka karakter ushtarako-teknik dhe është e rregulluar me ligj. Në nenin 6 të ligjit 64/2014 drejtimi operacional përkufizohet si “pushteti dhe përgjegjësia që ushtrohet nga një autoritet ushtarak për drejtimin dhe kontrollin e forcave të dhëna, për përmbushjen e misioneve dhe detyrave të veçanta”. Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë të shprehur se kompetenca e drejtimit operacional të FA-ve i takon Presidentit, çka është në përputhje me konceptin e kushtetutëbërësit, për sa i përket rolit dhe funksionit të Presidentit në fushën e FA-ve. Ligji konkret ka përcaktuar

⁶ Votuan pro pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: V.Kristo, A.Xhoxhaj, F.Hoxha dhe G.Dizdari
Faqe | 1556

⁷ Votoi pro pranimit të këtij pretendimi gjyqtari G.Dizdari



Ministrin e Mbrojtjes si autoritet përgjegjës për delegimin e autoritetit operacional të FA-ve të komandat aleate me të cilat FA-të kryejnë misione të përbashkëta. Për më tepër, në këto raste Ministri i Mbrojtjes ushtron kompetencën deleguese mbi bazën e marrëveshjeve e traktateve ndërkombëtare, dypalëshe ose shumëpalëshe, në fushën ushtarake, të cilat janë të miratuara me ligj nga Kuvendi. Në këto kushte, nisur nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e kërkuarit se neni 13, pika 2, shkronja “n”, i ligjit nr. 64/2014 është i papajtuësëm me Kushtetutën⁸.

H. Për pretendimin e papajtuësëmrisë me Kushtetutën të ligjit nr. 64/2014, për shkak të ometimit legjislativ

40. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, se ligji nr. 64/2014 nuk parashikon instrumentet thelbësore me të cilat Presidenti ushtron funksionet e tij si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, konkretisht urdhra e udhëzime, duke e kthyer atë në një autoritet jofunksional.

41. Gjykata nënvizon se Kushtetuta nuk shprehet në asnjë dispozitë të saj për nxjerrjen e urdhrave apo udhëzimeve nga ana e Presidentit. Përkundrazi, i vetmi instrument, i parashikuar qartazi nga Kushtetuta, nëpërmjet të cilit Presidenti ushtron funksionet e tij kushtetuese, është dekreti. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuari nuk e ka ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues.

42. Si përfundim, duke iu referuar konkluzioneve të arritura më lart, Gjykata vlerëson se shprehja “*ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura*” e pikës 2, të nenit 9, si dhe nenet 12/“ç”, 12/“d”, 22/3 dhe 23/3 të ligjit nr. 64/2014, bien ndesh me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a dhe 134/1/“a”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e shprehjes “*ndërsa në kohë lufte i drejton Forcat e Armatosura nëpërmjet Komandantit të Forcave të Armatosura*” të pikës 2, të nenit 9, si dhe të neneve 12/“ç”, 12/“d”, 22/3 dhe 23/3 të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me papajtuësëmërinë me Kushtetutën të neneve 9/2 dhe 12/d të ligjit nr. 64/2014, si dhe me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

a) Në lidhje me nenin 9/2 të ligjit nr. 64/2014

2. Shumica, pasi ka vlerësuar se dispozita ligjore e nenit 9, pika 2, të ligjit 64/2014 nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por e tejkalon Kushtetutën, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, e ka shfuqizuar këtë dispozitë. Në arsyetimin e saj ajo ka theksuar se Kushtetuta nuk përcakton asnjë mënyrë specifike të drejtimit të FA-ve nga kërkuari në kohë lufte. Shumica duke iu referuar jurisprudencës së saj sipas të cilës “*atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji*”, ka konstatuar se ligjvënësi në rastin konkret nuk është kufizuar vetëm në referimin të normat kushtetuese që parashikojnë kompetencat e Presidentit në lidhje me FA-të, por i ka tejkalar ato (shih parag 15-18 të vendimit).

3. Nuk pajtohem me këtë arsyetim të shumicës për arsye në vijim.

4. Kërkuari ka pretenduar se neni 9/2 i ligjit nr. 64/2014 parashikon ndërmjetësimin si të vetmen mënyrë drejtimit të FA-ve në kohë lufte dhe jo ushtrimin e drejtpërdrejtë të kësaj kompetence nga Presidenti, në tejkallim të

⁸ Votoi pro pranimi të këtij pretendimi gjyqtari G.Dizdari



Kushtetutës dhe parimit të hierarkisë së normave.

5. Nëse i referohemi Kushtetutës në tekstin e saj nuk parashikohet në mënyrë të shprehur ushtrimi i drejtpërdrejtë nga kërkuesi i kompetencës së drejtimit të FA-ve në kohë lufte. Sipas nenit 169/2: “Presidenti i Republikës në kohë lufte emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të Kryeministrit”. Natyrshëm lind pyetja: a është kërkesë e Kushtetutës që Presidenti në kohë lufte të drejtojë FA-të në mënyrë të drejtpërdrejtë?

6. Kushtetuta nuk i ka atribuar Presidentit kompetenca në fushën e FA-ve që ushtrohen prej tij në mënyrë të drejtpërdrejtë; përkundrazi, kompetencat kushtetuese që ai gëzon, bazuar në nenin 169, për sa i përket drejtimit të FA-ve, ose emërimit e shkarkimit të funksionarëve të lartë ushtarakë, i ushtron nëpërmjet ose me propozim të Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

7. Duke iu kthyer çështjes konkrete, në kushtet kur nuk parashikohet në mënyrë eksplicite një kompetencë kushtetuese e kërkuesit për drejtimin e FA-ve në mënyrë të drejtpërdrejtë në kohë lufte, nuk mund të argumentohet për një cenim të kësaj kompetence. Ligji i mëparshëm (nr. 8671/2000, i ndryshuar) e parashikonte këtë lloj kompetence të drejtpërdrejtë, krahas asaj me ndërmjetësim, si një nga mënyrat e drejtimit nga kërkuesi të FA-ve në kohë lufte. Ligjvënësi me ligjin e ri nr. 64/2014 ka ndryshuar kuadrin ligjor ekzistues, duke rregulluar drejtimin e FA-ve nga kërkuesi në kohë lufte me njërin nga mënyrat që parashikonte ligji i mëparshëm, konkretisht atë me ndërmjetësim. Kjo zgjedhje e ligjvënësit në nenin 9/2 të ligjit 64/2014 nuk bie në kundërshtim me rolin dhe pozitën e veçantë që ka Presidenti kundrejt FA-ve, siç është elaboruar edhe nga shumica në paragrafët 8-13 të vendimit. Kështu, Presidenti, si organ jopolitik dhe *super partes*, garanton respektimin e parimeve themelore kushtetuese në sferën e mbrojtjes. Megjithatë, roli i tij si Komandant i FA-ve nuk nënkupton ushtrimin e një komande efektive të natyrës së mirëfilltë ushtarake, ose dhënien e urdhrave të llojit ushtarak, pasi në të kundërt, siç ka arsyetuar edhe shumica, ai do të kryente një funksion tjetër publik dhe do të duhej të mbante përgjegjësi për aktet e kryera. Prandaj edhe ligjvënësi, në nenin 9/2 të ligjit nr. 64/2014, ka

parashikuar drejtimin e FA-ve nga kërkuesi nëpërmjet Komandantit të FA-ve, i cili përfaqëson autoritetin që ushtron efektivisht kompetenca ushtarake të domosdoshme në kohë lufte.

8. Për arsyet e mësipërme, ndryshe nga shumica, vlerësoj se neni 9/2 i ligjit nr. 64/2014 nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën.

b) Në lidhje me nenin 12/“d” të ligjit nr. 64/2014

9. Shumica, në lidhje me pretendimin e kërkuesit se neni 12/“d” kufizon funksionin e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve dhe tejkalon Kushtetutën, është shprehur se plani i vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, që u referohet dispozita ligjore konkrete, është aspekt organizativ i drejtimit të FA-ve me karakter strategjik. Ajo ka nënvizuar se kërkuesi nuk mund të përjashtohet nga roli i tij drejtues, sidomos kur bëhet fjalë për aspekte të rëndësishme të drejtimit strategjik të FA-ve. Në vlerësimin e shumicës, duke përjashtuar Presidentin nga miratimi i planit të vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, dispozita konkrete tejkalon Kushtetutën (*shih prg. 26 të vendimit*).

10. Nuk jam dakord me këtë qëndrim të shumicës për arsyet e mëposhtme.

11. Sipas tekstit të Kushtetutës Presidenti në kohë paqeje ushtron drejtimin e FA-ve nëpërmjet Kryeministrit dhe ministrit të Mbrojtjes (neni 169/1). Kompetencat e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve caktohen me ligj (neni 169/4). Në vështrim të këtyre dispozitave nuk rezulton t’i jetë dhënë Presidentit një kompetencë kushtetuese në lidhje me miratimin e planit të vendosjes dhe përhapjes së FA-ve. Ky aspekt, ashtu siç argumenton shumica, ka natyrë strategjike, por, nga ana tjetër, është një vendimmarrje e cila përfshin vlerësime politiko – ushtarake dhe tekniko - ushtarake, ndaj është rregulluar me ligj. Ligji nr. 64/2014 nuk ia ka dhënë këtë kompetencë ekskluzivisht Kryeministrit, por ashtu si ligji i mëparshëm ka përfshirë Ministrin e Mbrojtjes si autoritet propozues në procesin e miratimit. Pikërisht për shkak se plani i vendosjes dhe përhapjes së FA-ve është një aspekt organizativ që ka karakter politik dhe strategjik, ligji nr. 64/2014 ka përcaktuar ekzekutivin si autoritet miratues të këtij plani. Ekzekutivi dhe ministri i Mbrojtjes si pjesë e ekzekutivit janë përgjegjës përpara



Kuvendit në lidhje me politikat ushtarake e strategjike që ndiqen gjatë qeverisjes. Presidenti, për arsye të rolit të tij jopolitik dhe llojit të autoritetit drejtues që ushtron mbi FA-të, nuk mund të marrë vendime që mbartin vlerësime politike dhe ushtarake. Për rrjedhojë, çmuj se dispozita konkrete, duke përjashtuar Presidentin nga vendimmarrje që kanë të bëjnë me politikat e ndjekura nga ekzekutivi në fushën e mbrojtjes, si dhe çështje ushtarake të nivelit teknik dhe operativ, siç është plani i vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën, por respekton rolin dhe pozitën e veçantë që gëzon Presidenti si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve.

12. Bazuar në arsyet e mësipërme, ndryshe nga shumica, vlerësoj se nenet 9/2 dhe 12/“d” të ligjit nr. 64/2014 nuk e tejkalojnë Kushtetutën dhe si të tilla nuk duhej të shfuqizoheshin.

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2015-381/160, datë 3.2.2015, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Arben Koti, i biri i Ndonit dhe i Aristes, i datëlindjes 3.6.1991, lindur në Seman, Fier, duke përcaktuar si datë të vdekjes së tij datën 27.1.1994, në Seman, Fier.

KËRKESË

Shtetasi Demir Kacabumi, i biri i Mustafait dhe i Miles, i datëlindjes 1934, lindur dhe banues në Kryekuq, Lushnje, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje, shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Ismet Kacabumi, në fshatin Kryekuq.

KËRKUESI
Demir Kacabumi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 665 lekë